Metin Izeti

# TARIKATI BEKTASHIAN

Tetovë, 2001

Lektor:
Mr. Elez Ismaili

Shtypi:
Shtypshkronja „ÇABEJ"
Tetovë

„Veprat e bëjnë të pavdekshëm njeriun"
Libri i kushtohet rahmetli Nazmi Gamgamit

## PARATHËNIE

Tarikati bektashian është paraqitur në shekullin XIII në Anadoli, është zhvilluar në periudhën e Shtetit Osman dhe është përhapur në shumë vise të botës.

Proçesi zhvillimor i këtij tarikati dita- ditës shumë e më shumë është duke u hulumtuar. Duke filluar prej shekullit të XIX ky subjekt u ka tërhequr vëmendjen, në veçanti hulumtuesve perëndimorë. Hulumtimi i jetës, botëkuptimit dhe sjelljeve bektashiane në mjedise të ndryshme ka rëndësi të madhe në përcaktimin e veprimtarisë së mëtutjeshme si në aspektin fetar ashtu edhe në atë kombëtar.

Studimi,i cili gjendet pranë jush, subjekt studimi e ka tarikatin bektashian, botëkuptimet, ritualet dhe sjelljet e bektashinjve, kurse në veçanti janë analizuar bektashinjtë e Maqedonisë.

Jemi të vetëdijshëm se ky studim nuk mëton të hulumtojë çdo gjë në lidhje me bektashinjtë e këtyre viseve por paraqet një shkallë të konsiderueshme në studimin më të thellë të kësaj dhe çështjeve identike.

Falënderimet e mia të posaçme ia kushtoj mentorit tim të nderuar Prof. Dr. Avni Ilhanit si dhe baballarëve bektashi Baba Tahir Eminit dhe Baba Ejup Rakipit, të cilët nuk e kursyen ndihmën e tyre.

Metin Izeti
Prill, 1998

# PJESA E PARË

## TARIKATI[1] BEKTASHIAN DHE REFLEKTIMI I TIJ NË VISET TONA

Tarikati bektashian u paraqit në shekullin e XIII në Anadoli, por gjatë periudhës disa shekullore osmane është përhapur në shumë vise të botës. Ky tarikat ka lozur rol të rëndësishëm në strukurën pasosmane të popujve ballkanas. Ndikimi i tij në sferën e islamizimit, zhvillimit të arteve të ndryshme e posaçërisht në mbajtjen e barazpeshës mes konfesioneve dhe etnikumeve të ndryshme ka qenë më se i dukshëm.

Fenomeni "bektashi" dita-ditës më tepër është duke u hulumtuar nga ana e shkencëtarëve të resorëve të ndryshme. Duke filluar prej viteve të para të shekullit XIX kjo temë posaçërisht ua ka tërhequr vëmendjen hulumtuesve perëndimorë. Pjesa dërmuese e hulumtimeve të bëra rreth tarikatit bektashian – si në Turqi ashtu edhe jashtë - kanë karakter publicistik. Por megjithatë në literaturën e shkruar në këtë lëmi gjithësesi ka edhe shkrime të tilla, të cilat duke iu përmbajtur të gjitha normave shkencore, në mënyrë sistematike kanë prezentuar vazhdën historike të bektashinjve, besimet dhe mënyrën e jetesës së tyre në mjedise të ndryshme.[2]

1 Tarikat- rrugë, rend, vëllazëri në misticizmën islame. Në tekstin e mëtutjeshëm do të përdoret në formën e saj origjinale " tarikat".

2 Literatura e botuar në Turqi rreth tarikatit bektashian, përveç asaj që ka karakter publicistik, është përplotë edhe me motive ideologjike që aspak nuk përputhen me esencën e tarikatit gjegjës. Për fat të keq, një qasje e tillë problemit bën që pa mos u thelluar në thelbin e

Studimi[3] i cili gjendet para jush është i bazuar në metodat e hulumtimit të frakcioneve islame si dhe të sociologjisë fetare dhe ka për qëllim prezentimin e besimeve, botëkuptimeve bektashiane si dhe reflektimin e tyre në viset tona. Gjithashtu edhe reflektimin e këtyre botëkuptimeve në praktikë, respektivisht në marrëdhëniet e bektashinjve me grupet tjera islame në rajon.

problemit të nxirren konkluza joreale.Në lidhje me këtë çështje sa për ilustrim do të përmendi disa tituj të botuar në Turqi dhe jashtë saj: Cemal Bardakçi, "Kizilbaslik Nedir", Istanbul 1945; Kemal Samancigil, "Bektasilik Tarihi", Istanbul 1945; Riza Çavdarli, "Bektasi Sirri Çozuldu", Istanbul 1947; Hasan Basri Erk, "Tari Boyunca Alevilik" Istanbul 1954; M. Tevfik Oytan,"Bektasiligin Içyuzu", Istanbul 1970; Murat Sutoglu, "Bektasilik", Istanbul 1969; Atilla Ozkirimli,"Alevilik-Bektasilik ve Edebiyati", Istanbul 1985; Adil Gulvahaboglu, "Haci Bektas Veli"; Ismet Zeki Eyyuboglu, "Butun Yonleriye Bektasilik", Istanbul 1993; Riza Zelyut, "Oz Kaynaklarina Gore Alevilik", Istanbul 1990 etj.

Megjithatë në mesin e botimeve ka edhe të tilla që janë thelluar mirë dhe kanë nxjerrë konkluza shkencore, si p.sh. Prof . Dr. Ethem Ruhi Figlali, „Turkiyede Alevilik Bektasilik"; Mehmet Eroz, "Turkiyede Alevilik ve Bektasilik"; Fuad Koprulu, "Turk Edebiyarinda Ilk Mutasavviflar"; Abdulbaki Golpinarli "Vilayet-Name"; Esat Cosan, "Makalat"; Ahmet Yasar Ocak, "Kalenderiler" dhe "Babailer Isyani" etj. Posaçërisht duhet përmendur edhe Joseph Von Hammerin, "Geschichte Des Osmanichen Reiches"; John P. Brown, "The Darviches or Oriental Spiritualism"; FQ.W. Hasluck, "Christianity And Islam Under the Sultans"; John K. Birge "The Bektashi Order of Derviches" etj. Edhe në gjuhën shqipe kemi disa tituj të botuar në lidhje me tarikatin bektashian: Baba Rexhepi, "Mistiçizma Islame dhe Bektashizma"; Naim Frashëri, "Fletore e Bektashinjët" ; A. Prishta, "Bektashinjët e Shqipërisë" etj.

3 "Makedonyada Bektasilik" është temë e magjistraturës e mbrojtur me 04.04. 1998 në Universitetin 9. Eylul të Izmirit në Turqi para këtij komisioni:
- Prof. Dr. Avni Ilhan - mentor
- Prof. Dr. Ethem Ruhi Figlali - kryetar i komisionit dhe
- Doc. Dr. Bulent Unal - anëtar

Në një numër të madh të punimeve rreth Tarikatit Bektashian, studjuesit kryesisht janë ndalur në anën folklorike, gjegjësisht traditën, letërsinë, muzikën bektashiane, por një studim dhe qasje folklorike pa mos e vendosur atë botëkuptim në binaret ku ai meriton të jetë dhe duke e ndarë atë prej burimit amëgjegjësisht tasavvufit (misticizmës) islame gjithësesi do të jetë i mëngët.

Para se të sqarojmë paraqitjen e tarikatit bektashian, themeluesin e tij dhe mësimet bektashiane do të ndalemi në pika të shkurtëra rreth tre momenteve me rëndësi të madhe paraprake në këtë lëmi:

1. Ngjarjet e para me karakter politik në Islam dhe shkaqet e paraqitjes së frakcioneve të ndryshme.
2. Zhvillimi i botëkuptimit mistik në Islam.
3. Vendi i Tarikatit Bektashian në zinxhirin e tarikateve Islame.

## NGJARJET E PARA ME KARAKTER POLITIK NË ISLAM DHE SHKAQET E PARAQITJES SË FRAKCIONEVE TË NDRYSHME

Derisa ishte në jetë Muhammedi a.s., në mesin e muslimanëve nuk pati asfarë mosmarrëveshjeje, pasi prania e Pejgamberit mundësonte afrimin e mendimeve të ndryshme drejt burimit hyjnor ose mënjanimin e atyre të cilët ishin në kundërshtim me te.

Muslimant kryesisht pas vdekjes së Pejgamberit a.s. filluan të ballafaqohen me disa probleme për të cilat nuk mundën të gjejnë përnjëherë përgjigje, e cila do t'i kënaqte të gjithë.Që në shekullin e parë pas Hixhretit, kur ende ishin gjallë një numër i madh i shokëve të afërm të

Pejgamberit a.s., disa njerëz të cilët sadopak ishin ballafaquar me shkencën e kohës, apo vinin prej popujve ku ishin prezente filozofi e ideologji të ndryshme jo identike me besimin islam, filluan të plasojnë mendime të ndryshme në lëminë e besimit islam.

Ky fenomen nuk paraqitej për herë të parë pas Muhammedit a.s. , por një dukuri e tillë ishte – dhe është- prezente edhe në fetë tjera teknikisht "më të vjetra" se Islami, qofshin ato të shpallura ose jo. Me një situatë të tillë është ballafaquar Judaizmi, ku ithtarët e të njëjtit libër të shenjtë për shkak të mendimeve të ndryshme, janë ndarë në disa grupe, si: Hasidijtë ( Chasidim, Hasideans), Ferisijtë (Perushim) , Sadukijtë (Sadukim) etj.[4]

Nga ky fat nuk shpëtoi as Krishterimi. Pas vdekjes së shokëve të pandarë (Havarijjun) të Isait a.s. (Jezu Krishtit) ithtarët e tyre u ndanë në shumë frakcione, si p.sh.: Kishat Monofizite (Ermeniane, Asiriane, Etiopiane, Kopte), Kisha Katolike, Orthodokse, më vonë Protestane etj.[5]

Një gjë e tillë ndodh edhe me muslimanët pas vdekjes së Pejgamberit a.s.. Ky realitet njerëzor shihet edhe nga hadithi[6] i Pejgamberit a.s. ku ai potencon se jahudijtë janë ndarë në 71, krishterët në 72 , kurse muslimanët do të ndahen në 73 grupe.

Në fillim këto çështje ishin vetëm mendime individuale të plasuara nga individë të ndryshëm – posaçërisht në problematikën e Kader-it dhe Hilafet-it- , por më vonë këto

4 Flusser, David, ,The Spiritual History of the Dead Sea Sect, translated into English by Carol Glucker, Tel Aviv 1989, f. 8.

5 Davies, Harton, The Christian Deviations, Gr. Britain 1972, fq. 85.

6 Këtë hadith e hasim në shumë burime themelore të Hadith-it: Ebu Davud, Sunen, Kitabus-Sunne, 1\4596; Tirmidhi, Sunen, Kitabul Iman 18\2640; Nisaburi, El-Mustedrek, Kitabul Ilm, hadithi No. 441.

mendime sistematizohen dhe shndërrohen në shkolla të pavarura.

Mosmarrëveshjet të cilat paraqiten pas vdekjes së Pejgamberit a.s. e masovikisht pas katër halifëve të drejtë( Hulefai Rashidin) përgatitën terenin për paraqitjen e dallimeve në pikpamje të besimit në mesin e muslimanëve. Kjo si dhe përzierja e muslimanëve – gjatë çlirimeve- me popujt e kulturave dhe ideologjive të ndryshme bënë që muslimanët të hyjnë në diskutime kelamike (apologjetike) në mes vete. Në këtë mënyrë, nga ndikimi i madh edhe i iniciativave me prapavijë politike paraqiten disa frakcione dhe sisteme kelamike.[7]

Faktorët që dhanë shkas për paraqitjen e mendimeve e më vonë të frakcioneve të ndryshme, kryesisht mund të tubohen në dy grupe:

1. Faktori fetaro-shoqëror dhe
2. Faktori politik[8]

Faktori Fetaro-Shoqëror

7 Në njërën anë Ehli Sunneti i prezentuar nga Selefijtë, Maturidijtë dhe Esharijtë, në anën tjetër- në fillim të paraqitura me shpresa politike por më vonë duke formuar sistemin e vet kelamik, bëhen kelamike- Shiat dhe Harixhijtë, si dhe shumë drejtime të cilat në mendime partikulare janë ndarë nga rruga e përbashkët: Xhebrijtë , Kaderijtë etj. Në të shumtën e rasteve dallimet politike, fetare dhe shoqërore të drejtimeve të lartëpërmendura kanë bërë që këto drejtime të bëhen armiq të njëri tjetrit.

8 Kjo ndarje në literaturën e lëndës gjegjëse është bërë në mënyra të ndryshme. Më gjerë shih: Ethem Ruhi Figlali, Çagimizda Itikadi Islam Mezhepleri, Ist. 1993, fq. 15-53,; Turkiyede Alevilik Bektasilik, Ankara 1991,fq. 19-69; Ahmet Turan, Islam Mezhepleri Tarihi, Samsun 1993, fq. 14-30; Ahmet Akbulut , Sahabe Devri Siyasi Hadiselerin Kelami Problemlere Etkenleri, Ist. 1992, fq. 14; Henri Laoust, Raskoli u Islamu, përktheu prej frengjishtes Tarik Haveriç, Zagreb, fq. 13-63; Fazlur-Rahman, Duh Islama, përkth. Andrija Grosbenger, Beograd 1983, fq. 127-147; W.Montgomery ëat, The formative Period of Islamic Thought, përkth. në turq. E.R. Figlali, fq. 11-42.

Pejgamberi a.s. në moshën katërdhjetë vjeçare, në vitin 610, për së pari herë në shpellën Hira, në rrethinën e Mekkës e pranoi shpalljen.[9] Kjo shpallje e cila filloi me ajetet e para të sures "Alek" brenda 23 viteve u plotësua , dhe me përfundimin e saj mori fund shpallja prej anës së All-llahut xh.sh. dedikuar njeriut.

Në momentet kur Pejgamberi a.s. filloi të pranojë shpalljen, gjegjësisht kur filluan të lindin principet islame, në Gadishullin Arabik nuk ekzistonte një shtet i cili do të gëzonte autoritet politik mbi tërë Gadishullin. Një numër i madh i popullatës udhëhiqej sipas traditave fisnore. Religjioni i tyre ishte idhujtaria me mjaft elemente të huazuara prej kulturës fetare mesopotameze, siriane, greke dhe egjiptase.

Pjesa dërmuese e popullatës merrej me blegtori-deve, kuaj,dele-kurse një pjesë elite merrej me tregti. Udhëtimet tregtare të arabëve të vjetër në viset e ndryshme të botës dhe kulturës së vjetër kanë ndikuar dukshëm në individët e shoqërisë së atëhershme arabe. Prej kulturave lindore kanë huazuar në veçanti astrologjinë dhe magjinë, kurse prej të parëve të vet kanë trashëguar një traditë fascinante poetike.

Në periudhën e lindjes së principeve islame, në Hixhaz banonin edhe fise hebreje dhe krishtere.[10] Një numër i

---

9 Definicioni më decid I shpalljes do të ishte: Kontakti i All-llahut xh.sh. në mënyrë të caktuar me njerëz të zgjedhur.

10 Për këtë flet edhe Kur'ani Famëlartë në shumë ajete: "Atyre që u kemi dhënë librin, e njohin (Muhammedin) ashtu si i njohin fëmijët e tyre. E nuk do të besojnë ata që e kanë shkatërruar veten" (En'am 20). "Ne e dimë që ata thonë: Atë e mëson një njeri! Gjuha e tij që po ia mveshin- se po e mëson atë- është gjuhë e të huajve (të cilën nuk e dijnë arabët) kurse ky Kur'ani është në gjuhën e qartë arabe" (Nahl 103).

konsiderueshëm i ajeteve kur'anore ka zbritur pas pyetjeve të parashtruara nga ana e tyre.

Individët të cilët i takonin ose jetonin në rrethana të tilla shoqëroro-fetare edhe pas pranimit të Islamit, gjithësesi me vete do të bartnin elemente të kulturës së tyre të vjetër, posaçërisht me zgjerimin e shtetit islam në djepin e këtyre botëkuptimeve dhe depërtimin e banorëve të tyre në Islam, kjo trashëgimi e vjetër është bërë evidente. Muslimani i ri problemeve të cilave nuk kishte mund të ju gjejë përgjigje në fenë e vjetër, do të orvatej t'i zgjidhë në fenë e re.[11]

Përveç faktorëve shoqërorë dhe fetarë në popullatën para ardhjes së Islamit, rol të rëndësishëm do të luajë edhe elasticiteti dhe dinamizmi i fesë islame. Thellimi i tepërt i muslimanëve në problemet sekondare (furuat), fanatizmi dhe këmbëngulja e tepërt në mendimet individuale dhe botëkuptimet parciale nuk ishte element i fesë së zbritur nëpërmjet të Muhammedit a.s..

Imam Gazaliu[12] shumë bukur i cek tri themelet kryesore sipas të cilave do të përcaktohej kush është musliman e kush jo. Ai thotë: " Që të thuhet për një individ ose grup se është ose nuk është brenda kornizave të Islamit, duhet të shikohet relacioni i tyre me tre bazat e Islamit, edhe atë:

1. Tevhidi, njësimi- besimi në ekzistencën, njësinë dhe cilësitë e All-llahut xh.sh.
2. Nubuvveti – besimi në atë se All-llahu xh.sh. që prej fillimit të jetës në këtë botë ka dërguar pej-

11 Problemi i ardhjes së Mesih'ut shpëtimtar, te krishterët, Ahrimazda-burim I të mirës- dhe Ahrimani- burim I të keqes-, nga një iranian gjithësesi do të identifikohej me All-llahun dhe Shejtanin. Këto dhe problemet e ngjashme filluan me të madhe të paraqiten në botën Islame kah gjysma e dytë e shekullit të parë hixhri.

12 Imam Gazali, Fejsalu't-Tefrika Bejne'l-Islam ve'z-Zendeka, Kairo 1325\1907, fq.15.

gamberë; i fundit prej tyre është Muhammedi a.s.. Pejgamberët shpalljen hyjnore të pranuar nëpërmjet Xhibrilit ose në mënyrë direkte ua kanë transmetuar njerëzve.

3. Mead - besimi në ahiretin, respektivisht në jetën pas kësaj bote, ku njeriu do të ballafaqohet me pasojat e veprave të tija- të mira ose të këqia- të bëra në këtë botë.

Këto tri themele janë rrënjët e Besimit Islam të zbritur me Kur'anin Famëlartë. Personi ose grupi i cili haptazi mohon këto tre principe ose njërën prej tyre nuk është musliman. Ndërsa, kuptimi dhe komentimi i ndryshëm, ndarja jo identike e sifateve (cilësive) të All-llahut xh.sh.; a janë ata një me Dhat-in (Qenien) e All-llahut xh.sh. ose jo; kuptimi i ndryshëm i veprave të njeriut, janë ata të krijuara ose jo; kuptimi i Isra'së dhe Miraxh'it; esenca e shefaatit, mizanit, Xhennetit, Xhehennemit etj. janë probleme që nuk kanë të bëjnë me rrënjët e besimit islam. Besimi në to është i domosdoshëm, por kuptimi dhe komentimi i ndryshëm i tyre nuk nxjerr prej besimit.

Njëri prej faktorëve të cilët ndikuan në përçarjen ideore të muslimanëve nga aspekti i kontaktit të tyre me Kur'anin është edhe afrimi parcial i dijetarëve drejt fjalës hyjnore. Kur'ani është një tërësi, ku çdo ajet e plotëson tjetrin . Nxjerrja e ajeteve të posaçme prej kontekstit të Kur'anit sjell rezultate jokur'anore.

Mosnjohja decide e problemeve dhe shkaqeve të zbritjes së ajeteve kur'anore nga gjeneratat e mëvonshme dhe ekzistimi i ajeteve muteshabih[13] në Kur'an gjithashtu bëjnë pjesë në faktorët e paraqitjes së botëkuptimeve të

13 Er-Ragib el-Isfahani (1502\1108) thotë që ajetet muteshabih mund të konsiderohen në tre grupe:

ndryshme në popullatën muslimane. Kur themi ajetet muteshabih kemi për qëllim atë se të gjitha frakcionet e paraqitura idetë e tyre i kanë bazuar në këto ajete kur'anore dhe këto ajete i kanë komentuar në bazë të botëkuptimeve të veta.

Faktori Politik

Njëri prej faktorëve kryesorë në paraqitjen e frakcioneve të ndryshme në mesin e popullatës muslimane padyshim është faktori politik. Dëshira e flaktë e njerëzve për udhëheqje në disa momente të historisë pa vetëdije, i ka nxitur njerëzit që të keqpërdorin idealet e larta për interesin e tyre personal, fisnor ose më gjerë.

Çështja e Vasijjetit (Testamentit) - Çështja e parë politike, e cila paraqitet në bashkinë e muslimanëve pas Muhammedit a.s., është çështja e vasijjetit. Në momentet kur Muhammedi a.s. ishte në shtrat sëmurë, sipas një hadithi që transmetohet prej Ibni Abbasit, ai iu drejtua shokëve të pranishëm me këto fjalë: Më jepni mua një laps dhe një copë letër, të ju shkruaj një testament që të mos devijoni pas meje.[14]

---

1. Ajete muteshabih që i din vetëm All-llahu xh.sh. , si p.sh. çasti i Kijametit.
2. Ajete muteshabih të cilat me analizë të thellë mund t'i kuptojë edhe njeriu, si p.sh. fjalët e panjohura kur'anore.
3. Ajete muteshabih të cilat mund të dijnë vetëm dijetarët e thellë ( er-Rasihune fi'l-ilm) si p.sh. Ibëni Abbasi r.a. për të cilin Pejgamberi a.s. ka thënë: "O zot bëre të kuptueshëm në çështjet fetare dhe mësoja te'vilin (komentin e Kur'anit)".

14 Buhari, Sahih, 7\9; Muslim, Sahih, 3\125; Taberi, Tarih, (Leiden 1879-81) 1\1806; Ibën Ebi'l-Hadid, Sherhu Nehxhi'l- Belaga, Bejrut 1938, 2\863.

Pas këtyre fjalëve të Pejgamberit a.s. në mesin e muslimanëve fillon një diskutim i zëshëm, ku një grup kërkonte që t'i plotësohet dëshira Muhammedit a.s. , kurse grupi tjetër thoshte se Pejgamberi është kalon çastet e fundit të jetës, prandaj nuk ka nevojë që ta lodhim me gjëra të tilla.

Ky hadith dhe disa transmetime tjera të bëra nga Ibni Abbasi[15] më vonë kanë qenë shkak i mosmarrëveshje të shumta mes Ehl-i Sunnetit, Shia-së dhe frakcioneve tjera. Ehl-i Sunneti në këtë çështje i përmbahet mendimit të Omerit r.a., i cili thotë që pas zbritjes së ajetit " Sot e plotësova fenë tuaj"[16] Kur'ani është plotësuar dhe nuk ka nevojë më për asgjë tjetër, kurse Shia thotë që sikur Muhammedit a.s. t'i mundësohej që të shkruajë këtë testament pas vetes do të emërtonte Hazreti Aliun për halif. Pa mos u thelluar në detajet e problemit , një gjë është më se e qartë: kjo ngjarje dukshëm ka ndikuar në paraqitjen e mosmarrëveshjeve mes frakcioneve të ndryshme gjatë historisë. Por, sipas mendimit tim, problemi kryesor fle në atë se një numër i madh i komenteve është bërë duke mos u thelluar në praktikën , fenomenet psikologjike, rrethanat shoqëroro-politike të kohës së ngjarjes. Koha kur janë shkruar këto çështje është periudha e abasidëve, pothuajse një shekull pas kësaj ndodhie. Prandaj, afrimi i cekët në këto çështje lindën vetëm polemika të panevojshme. Momenti të cilin duhet ta kemi parasysh është se edhe individët e shoqërisë së Pejgamberit a.s. duhet të konsiderohen njerëz e jo diçka më tepër, të cilët kanë pasë mundësi të mendojnë kështu ose ashtu, të gabojnë ose të jenë në të drejtë.

15 Më gjerë shih: Buhari 1\37; Ibënu'l-Esir, 2\320; Ibëni Sad, Tabakat, 2\242; Taberi, 1\1806 .

16 Maide 4.

Çështja e Hilafetit (Udhëheqësisë).- Mosmarrëveshja e parë e cila u paraqit pas vdekjes së Muhammedit a.s.[17] ishte çështja e udhëheqësisë së shtetit islam. I dërguari i Zotit kaloi në ahiret pa mos emërtuar dikend, i cili pas tij do të udhëhiqte shtetin dhe muslimanët.

Menjëherë pas vdekjes së Pejgamberit a.s., derisa të afërmit e tij në krye me Hazreti Aliun ishin të zënë me përgatitjen e xhenazes së Pejgamberit, ensarët tubohen në vendin e quajtur Thekife Beni Saide dhe vendosin që në vend të Muhammedit a.s. të kalojë Sa'd ibën Ubadeja. Sa'di mbajti një fjalim të shkurtër, ku përmendi meritat e medinasve dhe u tha që udhëheqësia ishte e drejtë vetëm e vendasve të Medines.

Omeri dhe Ebu Bekri r.a. në momentin kur dëgjojnë për këtë tubim, me vrap nisen drejtë Thekifes. Ebu Bekri me të arritur, mban një fjalim në të cilin potencon vleftën e muhaxhirëve mekas, kohën e gjatë në Islam, afërsinë e tyre me Pejgamberin a.s. dhe thotë që kryetari i shtetit do të jetë prej mekasve kurse ministrat do të jenë prej medinasve. Edhe pse Hubbab ibën Mundhiri thotë që të caktohen dy kryetarë, mendimi i tij nuk pranohet, kurse Omeri r.a. ia tërheq vëmendjen auditorit se fiset arabe në Gadishullin Arabik assesi nuk do të pranonin udhëheqjen e dikujt tjetër përveç kurejshëve. Ky përfundim i Omerit r.a. është një analizë fascinante e botëkuptimit arab të asaj kohe dhe nën ndikimin e këtyre fjalëve Beshir ibën Sa'di ngrihet dhe e zgjatë dorën që të pranojë udhëheqësinë e njërit prej mekasve. Atëherë duke marrë parasysh meritat e Ebu

17 Sipas Shia-së Pejgamberi a.s. ndërroi jetë në 28 Safer të vitit 11 hixhrijj, kurse sipas shumicës së dijetarëve në 12 Rebiul Evvel të të njëjtit vit.

Bekrit r.a. i zgjatet dora atij dhe të gjithë të pranishmit me rend e pranojnë Ebu Bekrin për halif.[18]

Siç thamë edhe më lartë, derisa kjo çështje diskutohej në Thekife, Hazreti Aliu me të afërmit e vet ishte i preokupuar me përgaditjen e xhenazes së Pejgamberit a.s.. Në ditët e para Hazreti Aliu nuk e pranon halifatin e Ebu Bekrit, pasi që atë e sheh si të drejtë të veten, mirëpo më vonë duke menduar se mund të përçahet ummeti e pranon Ebu Bekrin për halif.

Edhe pse çështja e hilafetit u zgjodh në këtë mënyrë, më vonë disa grupe atë do ta keqpërdorin si mjet politik dhe si pasojë e këtij keqpërdorimi do të lindin një serë frakcionesh brenda popullatës muslimane.

Gjatë periudhës së Omerit r.a. dhe dhe në periudhën e parë gjashtëvjeçare të Othmanit r.a., në shtetin Islam nuk ka pasur vështirësi të rëndësishme, mirëpo në periudhën e dytë gjashtëvjeçare të Othmanit r.a., nën ndikimin e disa lëshimeve në udhëheqjen e shtetit të bëra nga ana e Othmanit r.a. disa grupe kryengritëse prej Egjipti, Kufe dhe Basre drejtohen drejtë Medines dhe kjo kryengritje e tyre përfundon me rrënien shehid të Othmanit r.a., problem i cili më vonë do të shtyjë muslimanët të luftojnë mes vete.

Hazreti Aliu u dëshprua tepër për vrasjen e Othmanit r.a. dhe i qortoi bijtë e tij Hazreti Hasanin dhe Huseinin, të cilët më parë i kishte vendosur si roje pranë shtëpisë së Othmanit r.a.. Pas kësaj ngjarjeje as'habët tubohen në

18 Në këtë problematikë ka një moment i cili na e tërheq vëmendjen. Pse medinasit aq shpejt kthyen dhe pranuan halifatin e Ebu Bekrit? Dihet qartë se para ardhjes së Muhammedit a.s. në Medine dy fiset kryesore Evs dhe Hazrexh ishin në luftë qindvjeçare "luftërat Buath" . Duke u frikësuar që mos po përsëriten ato luftëra pranuan udhëheqësinë e mekasve, përndryshe ata kryesinë e shtetit e shihnin si të drejtë të veten.

xhaminë e Pejgamberit a.s. për të zgjedhë halifin e muslimanëve. Nga ana e Talha ibën Ubejdullahut dhe Zubejr ibën Avvamit u propozua Hazreti Aliu, dhe u zgjodh.[19]

Problemi kryesor i cili qëndronte para Hazreti Aliut si halife ishte burgosja dhe dënimi i vrasësve të Othmanit r.a.. Mirëpo, Othmanin r.a. nuk e kishte vrarë një njeri, një grup i tërë i kryengritësve prej afro 10.000 vetësh pohonte se të gjithë ishin vrasësit e tij.[20] Për shkak të situatës së tillë Hazreti Aliu dënimin e këtyre vrasësve e la për më vonë, mirëpo të afërmit e Othmanit r.a. në krye me Mervan ibën Hakemin dhe Muavije ibën Ebi Sufjanin këtë moment e shfrytëzuan për kryengritje dhe mosrespekt ndaj halifatit të Aliut r.a..

Lufta e Xhemel'it[21]- Qëndrimi i këtillë i familjes Beni Umejje ndaj halifatit të Hazreti Aliut, mosmarrëveshjet individuale ndërmjet disa as'habëve të Pejgamberit a.s. do të jenë shkak që për herë të parë pas Muhammedit a.s. muslimanët të derdhin gjakun e njëri tjetrit.[22]

Lufta e Xhemelit është bërë në afërsi të Basrës ku njëra palë e udhëhequr nga halifeja, Hazreti Aliu, konfrontohet me palën tjetër të udhëhequr nga Aisheja r.a.. Që të dy palët në fushëbetejë kishin ardhë me qëllim që piksëpari të merren vesht, mirëpo intrigat e disa personave në krye me Mervan ibën Hakemin, bëjnë që të fillojë përleshja, në të

---

19 Më vonë Talha dhe Zubejri e kundërshtojnë Hazreti Aliun dhe në luftën e Xhemelit do të luftojnë kundër tij.

20 Kutluay Y, Islam ve Yahudi Mezhepleri, Ankara, 1965, fq.41.

21 Xhemel do të thotë deve. Kjo luftë ka marrë këtë emër për shkak se Aisheja r.a. ka qenë e hypur në një deve të bukur në këtë luftë.

22 Në lidhje me çështjen e Aishes, Talhës dhe Zubejrit më gjerë shih: Ibën Kutejbe, Mearif, 208-9; Dineveri, 144-154, Taberi 1\3111-3233etj.

cilën Hazreti Aliu e fiton luftën, por vdesin shumë musliman e me to edhe Talha dhe Zubejri.

Pas përfundimit të luftës Hazreti Aliu vetë i varrosi të vrarët dhe nuk lejoi që pasuria e tyre të konsiderohet si ganimet (plaçkë) lufte.

Lufta e Siffin'it - Pas përfundimit të luftës së Xhemel'it, Hazreti Aliu fillon përgaditjet për nënshtrimin e plotë të Sirisë, gjegjësisht Muaviut. Hazreti Aliu disa herë i kishte dërguar mesazhe Muaviut që të pranojë halifatin e Medines. Këtë e bën edhe njëherë pas betejës së Xhemel'it, por më kot. Muaviu duke u bazuar në rekomandimet e Amër ibën As'it nuk i merr aspak parasysh ofertat e Aliut r.a. për marrëveshje. Kjo sjellje e Muaviut bëhet shkak që muslimanët edhe njëherë në fund të vitit 36\656 të konfrontohen mes vete.

Meqë pas ndërhyrjeve të shumta nuk arrihet marrëveshje për kompromis fillon, lufta. Në momentet e para ushtria e Hazreti Aliut korri suksese evidente dhe përparoi sa që pas një lufte të rreptë në natën e nëntë të muajit Safer të vitit 37, ushtria e Muaviut nën direktivën plotë intriga të Amër ibën As'it i vunë kur'anat mbi shtiza dhe thanë që libri i All-llahut le të gjykojë mes nesh. Edhe pse Hazreti Aliu mundohet që të bindë ushtrinë e tij se kjo është një intrigë dhe se ai disa muaj e kishte lutur Muaviun për këtë, kurse ai nuk kishte pranuar, prapseprapë një grup në mesin e ushtrisë së Aliut r.a. e ndërpret luftën dhe Hazreti Aliut nuk i mbetet asgjë veç se të pranojë propozimin e Muaviut. Vendoset që të përcaktohet nga një person nga të dy anët për të dhënë konkluzën përfundimtare. Muaviu dërgon Amër ibën As'in, strateg dhe politikan i shquar, ndërsa Hazreti Aliu nën ndikimin e atyre ushtarëve që e

ndërprenë luftën e dërgon Ebu Musa el-Eshariun, njeri modest dhe i butë.

Dy përfaqësuesit takohen në vitin 38\659 në muajin Shaban dhe përsëri me anën e një intrige të Amër ibën As'it çështja kryhet në favor të Muaviut.[23]

Qerbelaja.- Çështja e fundit, të cilën do ta përmendi brenda faktorit politik, është vrasja e Husejnit r.a., nipit të Pejgamberit a.s., në vendin e quajtur Qerbela. Kjo çështje është me rëndësi të veçantë edhe në aspektin e paraqitjes së frakcioneve dhahirijje (egzoterike) por edhe të atyre batinijje (ezoterike) respektivisht mistike në popullatën muslimane.

Në vitin 41\662 Hasani r.a., me marrëveshje halifatin ia dorëzon Muaviut dhe deri në fund të jetës orvatet që të qëndrojë larg skenës politike. Mirëpo, kur Muaviu kërkon që pas tij halif të bëhet djali i tij Jezidi, atëherë, si e tërë bota islame ashtu edhe Huseini r.a. preket tepër dhe dëshpërohet.

Muaviu me këtë gjest për herë të parë do të futë botëkuptimin e dinastisë në udhëheqjen e shtetit Islam, respektivisht kalimin e fronit prej babës në djalin dhe do të jetë shkaku kryesor për të cilin do të akuzohet nga shumë dijetarë të mëvonshëm.

Në mesin e një numri të madh të njerëzve me renome të asaj kohe që nuk e pranojnë këtë gjest të Muaviut është

23 Dy përfaqësuesit vendosin që të suspendojnë që të dy udhëheqësit, e pas kësaj delegatët e zgjedhur prej të gjitha vendeve islame të përcaktojnë halifin e ri. Para ushtarëve i pari del Ebu Musa el-Eshariu dhe thotë se e suspendon Aliun r.a.prej halifatit. Amëri i cili del pas tij thotë kështu: Pasi që Ebu Musa e suspendoi halifin e vet atëherë nuk mbetet tjetër pos unë të vendos për halif Muaviun.

edhe Huseini r.a.. Ai i nxitur nga banorët e Kufës me një grup të konsiderueshëm të ithtarëve niset prej Medines drejt Kufës. Rrugës kupton se banorët e Kufës do ta tradhtojnë, prandaj të pranishëmve u mban një fjalim dhe u thotë që ata të cilët kanë dëshirë mund të largohen. Një numër i madh i tyre largohen, kurse me te mbeten familja e tij e ngushtë gjegjësisht 70 veta. Huseini r.a. me këto 70 veta vin dhe ndalet në Qerbela. Jezidi kundër tij e dërgon Omer b. Sa'din i cili në fillim edhe pse nuk don të pranojë, pas kërcënimeve të shumta pranon dhe më 10 Muharrem të viti 61\680 fillon beteja mes ushtrisë së madhe të Jezidit dhe 70 vetëve të Huseinit r.a.. Kah fundi i betejës bie shehid edhe Huseini r.a., i vrarë në mënyrë mizore, nga ana e Shemir ibën Dhul-Xhevshenit. Ndërsa koka e tij i pritet dhe i dërgohet Jezidit në Damask.

Vrasja mizore e Huseinit r.a. në Qerbela ka çelë një plagë të madhe në zemrat e muslimanëve dhe do të kollojë deri në ditën e kijametit, njëkohësisht është bë edhe shkak për paraqitjen e shumë frakcioneve.

Nëse merren parasysh faktorët e sipërpërmendur për paraqitjen e frakcioneve të ndryshme brenda popullatës muslimane shihet qartë se: muslimanët, të cilët në kohën e pejgamberit a.s.,të bazuar në autoritetin e tij ishin të një mendimi, më vonë me ndikimin e rrethanave shoqërore dhe politike të ndryshme dhe për shkak të egoizmit të personave të caktuar janë përçarë dhe kanë ndjekur rrugë të ndryshme.

Por është shumë rëndë të jepet një konkluzë në lidhje me çfarëdo frakcioni pa mos u bërë një analizë të hollësishme e ngjarjeve politike, sociale, ekonomike në të cilat janë paraqitur ato. Shumica e klasikëve tonë në përshkrimin e frakcioneve kanë pasë për qëllim mposhtjen e të

gjitha mendimeve tjera dhe mbrojtjen e Ehl-i Sunnetit. Një veprim i tillë mund të jetë "i dobishëm" por asnjëherë s'është objektiv dhe shkencor. Pikërisht për këtë, posaçërisht në shekullin e XXI kur bota përjeton një përparim të gjithanshëm, kur paralajmërohet një objektivizëm absolut - edhe pse në disa raste mbetet vetëm fjalë boshe muslimanët e në veçanti dijetarët muslimanë duhet të jenë të parët që do të sillen në këtë mënyrë dhe çdo diciplinë shkencore islame do ta bazojnë në objektivizëm dhe vijë shkencore gjegjëse.

Pasi që të bëhet një analizë e hollësishme e frakcioneve dhe të dalin në pah në mënyrë objektive mendimet e ndryshme gjatë historisë dhe sot do të jetë shumë lehtë që sipas peshojës balancës së Kur'anit dhe hadithit të arihen konkluza reale, gjë që do të shërbente për të mirën e të gjithë atyre që veten e ndiejnë si musliman, pa marrë parasysh cilës rrymë i takojnë.

## PARAQITJA DHE ZHVILLIMI I BOTËKUPTIMIT SUFIT (MISTIK)[24] NË ISLAM

Misticizmi është një fenomen njerëzor që ka qenë dhe është prezent në të gjitha fetë dhe popujt qysh prej njeriut të parë në fytyrë të tokës.[25]Kjo disiplinë shkencore ka anën e saj filozofike, historike, sociologjike, psikologjike etj. Nuk ka dyshim se çdo diciplinë shkencore dhe institucion në shoqëri paraqitet për shkak të një nevoje të caktuar. Nevoja e ushqimit shpirtëror, e qetësisë së lartë, lumturisë

24 Në tekstin e mëtutjeshëm do të përdoren termet origjinale "tesavvuf" – misticizma Islame dhe "sufi – mistik.

25 Mevlana Husamoglu Mustafa në veprën e tij "Risaletu'dh-Dhevkijje" thotë se tasavvufi fillon me Ademin a.s.

ezoterike ka qenë shkak për prezencën e botëkuptimit mistik në të gjitha shoqëritë njerëzore.

Misticizmi është karakteristikë e natyrës njerëzore. Në periudhat e ndryshme historike kjo karakteristikë është paraqitur në mënyra jo të ngjashme me njëra tjetrën në kornizat e jetës religjioze të popujve të ndryshëm.[26] Ky botëkuptim i cili në Islam është përjetuar nga ana e sufive në fetë dhe shoqëritë tjera është reflektuar në emërtime të ndryshme si p.sh. Në Indi Brahmanët, në Egjipt Hermesi, në Greqi Pitagora, në hebreizëm kabalistët dhe në krishtërim mistikët etj.

Të motivuar prej këtij realiteti njerëzor, një numër i madh i orientalistëve perëndimorë kanë pohuar se tesavvufi është ide e huaj e futur në Islam dhe se ai i ka rrënjët në krishterizëm, në filozofinë e vjetër indiane ose greke.[27] Mirëpo një vlerësim i këtillë që në fillim e gjykon në humbje çështjen e cila ka vend të posaçëm në shoqëritë muslimane.

Edhe pse filozofia e vjetër indiane, ajo neoplatonike dhe pitagoriane, misticizmi dhe kabalizmi përmbajnë tematika të ngjashme me ato të tesavvufit, ata prapseprapë dukshëm dallohen prej tesavvufit islam.

Nëse diskutojmë konceptin ezoterik për Zotin, shpirtin, natyrën dhe jetën gjithësesi se në pikëvërejtjen e problematikës së njëjtë mes shqyrtimeve të ndryshme filozofiko-religjioze do të ketë ngjashmëri. Për arsye se njeriu është një tërësi. Të gjitha institucionet njerëzore i ngjajnë njëri- tjetrit, pasi realiteti është i njëjtë. Dhe njeriu- edhe pse në disa raste në mënyrë të gabuar- mundohet ta rrokë këtë realitet. Afrimi mistik ndaj Fuqisë Krijuese është identik

26 Më gjerë shih: Eraydin Selçuk, Tasavvuf ve Tarikatlar, Ist. 1990, fq.50.
27 Masignoni, Gardeti, Harkani etj.

pa marrë parasysh kohën, vendin dhe mënyrën e prezentimit.

Koncepti mistik i hakikatit (realitetit) nuk është horizontal, por vertikal. Në të vërtetë nuk është shqyrtim laboratorik ose eksperimental i çështjes së caktuar, por në të bazë është inspirimi dhe drita e brendshme (iluminacioni). Pikërisht për këtë koncepti mistik nuk ka mundësi që historikisht të prezentohet si dhe kërkimi i themeleve të tija në mënyrë kronologjike është metodë e gabuar.

Më lartë thamë se koncepti mistik mbi realitetin është jashtë kohës dhe vendit, por në momente të ndryshme gjatë historisë ky realitet është prezentuar me nuansa jo identike. Herë herë persona të caktuar duke u orvatur që ndjenjat e larta të përjetuara në përvojën mistike t'i prezentojnë në pikpamje egzoterike kanë thënë fjalë për shkak të të cilave edhe janë varrë nga vetë përfaqësuesit e fesë të cilës i kanë takuar.

Para se të prezentoj disa definicione për tesavvufin, të bëra nga ana e sufive të ndryshëm gjatë historisë, do të them disa fjalë për dallimin e tesavvufit islam prej botëkuptimeve tjera mistike. Tesavvufi islam dallohet prej botëkuptimeve tjera mistike në shumë pika por më të rëndësishmet janë:

1. Tesavvufi gradualisht personit i mundëson ngritje shpirtërore, përderisa misticizmi i jep pasione momentale.
2. Në misticizëm torturimi i vetvetes ka vend të posaçëm, ndërsa në tesavvuf nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm.
3. Në tesavvuf metodat edukative dallohen në bazë të individëve, ndërsa në misticizëm ky dallim dhe kjo llojllojshmëri nuk ekziston.

4. Në tesavvuf gjatë ngritjes shpirtërore bazë është orvatja individuale, përderisa në misticizëm nuk ka nevojë për te.
5. Mistiku është i okupuar vetëm me meditim, ndërsa sufiu përveç meditimit bën edhe ibadet, merret me shkencë si dhe me punë tjera në shoqëri.[28]

Definicionet e Tesavvufit.- Tesavvufi është një disiplinë e cila e transferon fjalën në punë, gjegjësisht e transferon sistemin shkencor islamik prej gjendjes potenciale në atë funksionale, ose prej teorisë në praktikë.

Shumica e definicioneve të tesavvufit janë bërë sipas gjendjes shpirtërore të sufiut kur i ka thënë ato fjalë. Prandaj lirisht mund të themi se të gjitha definicionet e bëra përmbajnë të vërteta sufite, ndërsa të gjitha së bashku prezentojnë konceptin e tesavvufit Islam.

Në periudhën e parë të tesavvufit një numër i madh i sufive kanë dhënë mendimet e veta në lidhje me atë se çka është tesavvufi. Ja disa prej tyre.[29]

– Xhunejd el-Bagdadi (298\907) thotë: Tesavvufi është ndërprerja e kontaktit me çdokënd pos All-llahut xh.sh.

– Ebul Husejn Nuri (295\907): Tesavvufi është braktisja e krejt pasioneve trupore (nefsit).

– Ma'ruf el-Kerhi (200\815): Tesavvufi është pranimi i hakikateve dhe pashpresa në atë që është në duar të njerëzve.

---

28 Tahrali, Mustafa, Tasavvuf Mistisizm Farki, Akademi Mecmuasi, Ekim 1981, fq. 21-36.

29 Më gjerë shih: "Prof. Nicholsonun Kronolojik Esasli Tasavvuf Tarifleri", Ethem Cebecioglu, A.U.I.Fq.D. XXIX, fq. 287-405; Yasar Nuri Ozturk, "Kur'an ve Sunnete Gore Tasavvuf , Ist. 1997, fq. 20-36; Selçuk Eraydin, Po aty fq. 37-46; Kushejri, Risale 2\255, 2\552.

– Bishr el Hafi (227\841): Sufi është ai njeri i cili e kristalizon zemrën për hirë të All-llahut.

– Ebu Turab Nahshebi (245\859): Sufi është ai person cili nuk ndotet prej asgjëje kurse çdo gjë me të pastrohet.

– Ebu muhammed el Xhuvejri: Tesavvufi është edukatë dhe kontroll i veprave.

– Ebul Husejn el Muzejjin: Tesavvufi është nënshtrim para të vërtetës.

– Imam Rabbani (1031\1621): Tesavvufi është ndihmës i sheriatit dhe është i dobishëm për ngritjen e sinqeritetit.

– Imam Gazali (505\1111): Tesavvufi është lidhja e zemrës me All-llahun dhe largimi i saj prej çdo gjëje tjetër.

Më lartë përmendëm disa prej definicioneve të tesavvufit, të cilat mund të shtohen edhe më, mirëpo në ato pika të përbashkëta janë:

1. Nënshtrimi i plotë ndaj urdhërave dhe ndalesave të All-llahut xh.sh.
2. Zbukurimi me ahlakun ( moralin) e All-llahut dhe të Pejgamberit.
3. Largimi i zemrës prej çdo gjëje pos All-llahut xh.sh..

Gjeneza e Fjalës Tesavvuf.- Në lidhje me prejardhjen e fjalës "tesavvuf" janë dhënë mendime të ndryshme prej njëra tjetrës. Ja disa prej tyre:

– As'habu's-Suffa.- As'habu's-suffa ishin muslimanët e varfër të emigruar prej Mekkës në Medine të cilët banonin në xhaminë e Pejgamberit a.s. Numri i tyre ka qenë përafërsisht 400 vetë. Sipas disa dijetarëve termi "tesavvuf" rrjedh prej tyre.[30]

30 Kushejri, Risale, fq.550; Kelabazi, et-Tearruf li medhhebi ehli't-tesavvuf, fq.5; Suhreverdi, Avarifu'l-Mearif, I,233.

– Saffu'l-evvel.- Sipas këtij mendimi sufijtë do të jenë në rradhët e para në ahiret për shkak të devotshmërisë së tyre, prandaj edhe e kanë marrë këtë emër.[31]

Benu's-Sufe - Benu Sufe është një familje prej fisit Mudar. Transmetohet se kjo familje i ka bërë tërë shërbimet në Qabe, madje për hirë të All-llahut i kanë shërbyer popullit. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe sufijtë, prandaj edhe e kanë marrë këtë emër.

– Safa dhe Safvet. – Një grup i dijetarëve thonë se fjala "tesavvuf" rrjedh prej fjalës "safvet" që do të thotë pastërti. Meqë sufijtë i kushtojnë rëndësi të posaçme pastrimit të zemrës dhe shpirtit . Ky grup thotë se prej këtu e kanë marrë edhe emrin.

– Savf. – Fjala "savf" do të thotë qëndrim anësh, kthyerje e shpinës. Duke marrë parasysh kuptimin e kësaj fjale dhe ndejtjen anësh të sufive për çdo gjë përveç All-llahut, disa dijetarë kanë pohuar se sufitë emrin e kanë marrë prej kësaj fjale.

– Sophia. – Një grup i dijetarëve në krye të të cilëve qëndron shkencëtari i mirënjohur musliman Biruni (443\1051) pohojnë se fjala "tesavvuf" rrjedh prej fjalës greke "sophos" që do të thotë "urti".[32]

– Suf. – Mendimi i cili më së tepërmi është i pranuar në mesin e dijetarëve për gjenezën e fjalëve "tesavvuf" dhe "sufi" është se fjala "tesavvuf" rrjedh prej fjalës arabe "suf"

31 Kushejri, Po aty.66.

32 Edhe Sami Frashëri ( 1850-1905) në Kamus-i Turki thotë se fjala "tesavvuf" rrjedh prej fjalës greke "sophos". Shih: Sh. Sami, Kamus-i Turki , "Tesavvuf".

që do të thotë "lesh". Në shekujt e parë pas Muhammedit a.s. veshja e rrobeve të leshta ishte simbol i pendimit prej gjynaheve të bëra. Sufitë kanë veshur rrobe të leshta prandaj edhe janë emërtuar me këtë emër.[33]

Pa marrë parasysh se prej cilës fjalë rrjedh fjala "tesavvuf", tematika e tij është pastrimi i egos (nefsit), kristalizimi i ahlakut (moralit), ndriçimi i anës së brendshme dhe të jashtme të njeriut. Në literaturën klasike ky realitet është shpreh me dy fjalë: "tehalluk "- ngritje morale dhe "tehakkuk" – zbatimi i tij në jetën e përditshme.

Qëllimi i diciplinës së tesavvufit është që të vendosë kontaktin e njeriut me Krijuesin dhe me esencën dhe tërësinë e tij që në këtë botë. Botëkuptimi i këtillë sufik rrënjët i ka në Kur'anin a.sh. dhe në jetën e praktikën e Muhammedit a.s.

Jeta modeste e Pejgamberit a.s. ka qenë modeli më i mirë për sufitë të cilët do të vijnë më vonë. Në një hadith i cili transmetohet prej Omerit r.a. thuhet kështu: Hyra në dhomën e Pejgamberit a.s. dhe e pash atë të veshur me ihrame[34]. Në njërën anë të dhomës kishte një hasër mbi dhe, mbi te një jastëk prej lëkure. Në skajin tjetër kishte një lëkurë, pak elb dhe një shtambë të zbrazët. Kur e pashë këtë fotografi, thotë Omeri r.a., fillova të qajë . Atëherë Pejgamberi a.s. më pyeti se pse qaja. Si mos të qajë, i thash, hasra mbi të cilën keni fjetur ka lënë gjurmë në trupin tuaj. Përderisa mbretërit dhe perandorët tjerë i shijojnë të gjitha begatitë e kësaj bote, ju e kaloni jetën në këtë

33 Emërtimi i njerëzve në bazë të rrobeve të cilat veshin është një traditë e vjetër. P.sh. shokët e Isait a.s. për shkak se veshnin rrobe të bardha u emërtuan "havarijjun" që do të thotë: "njerëz në të bardha". Shih: Ebu Nasr Serraxh, el-Luma, fq. 45.

34 Veshje e cila përbëhet prej dy pjesëve , të cilën e veshin haxhinjtë gjatë haxhit.

mënyrë. Atëherë Pejgamberi a.s. tha: O biri i Hattabit, a nuk dëshiron që kjo botë të jetë e tyre, kurse ahireti yni.[35]

Siç u cek edhe më lartë, elementet e jetës sufite ekzistonin që në kohën e Muhammedit a.s. dhe as'habëve të tij, mirëpo zhvillimi i kësaj tradite ezoterike është bërë në tre periudha, edhe atë[36]:

1. Periudha e Zuhdit
2. Periudha e Tesavvufit dhe
3. Periudha e Tarikateve.

Periudha e Zuhdit.-Fjala "zuhd" është fjalë arabe që do të thotë, kthyerje e shpinës, mosinteresim, moslakmi ndaj gjërave të kësaj bote etj. Në Kur'an përmendet në ajetin e 20 të sures Jusuf. Në terminologjinë e tesavvufit termi zuhd, do të thotë, asketizëm, gjegjësisht largim prej pasioneve të epshit dhe ngritje drejtë vlerave shpirtërore.[37]

Periudha e parë e prezentimit të jetës sufite në historinë islame e mban këtë emër kurse fillestarët e tesavvufit janë quajtur zahidë. Kjo periudhë fillon prej kohës së Pejgamberit a.s. dhe zgjatë deri kah fundi i shekullit II hixhrijj.

Një numër i madh i haditheve të transmetuara prej Pejgamberit a.s. qartë tregojnë se Pejgamberi a.s. jetoi një jetë modeste, larg epsheve dhe kënaqësive të kësaj bote.Në një hadith të transmetuar prej Ebu Hurejres dhe Aishes r.a., thuhet që kalonin muaj e në shtëpinë e Pejgamberit a.s. nuk zihej gjellë, zakonisht ushqimi i tij ishin hurmat dhe uji.[38]

35 Muslim, Kitabu't-Talak.
36 Yilmaz, Kamil, Anahatlariyla Tasavvuf ve Tarikatlar, Istanbul, 1994, fq.87.
37 Tasavvuf Terimleri ve Deyimleri Sozlugu, Ethem Cebecioglu, Ankara1997, fq. 787.
38 Ibën Sa'd, Tabakatu'l-Kubra, I, 401.

Aisheja r.a. thotë se barku i Pejgamberit a.s. asnjëherë nuk ishte i ngopur, mirëpo ai asnjëherë nuk ankohej. Ndonjëherë mua më dhimbsej dhe i thosha: Ah, sikur të furnizoje sa duhet vetveten, kurse ai më përgjigjej: Pejgamberët ulu'l-adhm[39] në këtë mënyrë e kanë kaluar jetën.[40]

Karakteristikë e jetës së Pejgamberit a.s. dhe as'habëve të tij- që konsiderohen si themele të tesavvufit- kryesisht ishte veshja, ngrënia dhe jetesa modeste në njërën anë kurse ibadeti dhe përmendja permanente e All-llahut xh.sh. në anën tjetër, respektivisht jeta e tyre ishte nënshtrim i plotë në All-llahun xh.sh.

Fotografi të këtillë shohim në personalitetet e katër halifëve të drejtë- Ebu Bekrit, Omerit, Othmanit dhe Aliut r.a.m- në personat të cilët qëndronin në xhaminë e Pejgamberit a.s. të emërtuar si as'habu's-suffa, në mesin e tyre Ebu Hurejreja, Selman el-Farisiu, Suhejb Rumi, Ebu Musa el-Eshari, Ebu Dherri etj. Gjithashtu edhe epoka e pasardhësve të as'habëve të Pejgamberit a.s. (Tabiinëve) është përplot me përfaqësues të jetës zuhdiane (asketike) edhe atë: Uvejs el Karani, Herim ibën Hajjani, Hasan el-Basriu, Seleme ibën Dinari, Said ibën Musejjebi etj.

Njeriu i parë i cili është emërtuar si sufi është Ebu Hashim Sufi (150\767) . Pas tij, deri në fund të shekullit të dytë në botën islame jetojnë mjaft sufi me renome, si: Davud et-Tai (161\777), Rabiatu'l-Adevijje (185\801), Fudajl ibën Ijadi (187\802) Shakik Belhi (194\809) etj.

Në shekullin II\VII në botën islame ka katër shkolla të tesavvufit: Shkolla e Medines, e Kufës, e Basrës dhe e Horasanit.

---

39 Ulu'l-adhm janë pesë pejgamberët durimin e të cilëve e lëvdon Kur'ani a.sh., ata janë: Nuhi, Ibrahimi, Musai, Isai dhe Muhammedi a.s. Shih: Ahkaf 35.

40 Hejsemi, Mexhmeu'z-Zevaid, IX,192.

Periudha e Tesavvufit.- Periudha e dytë e botëkuptimit sufit në Islam fillon në shekullin e III\IX dhe vazhdon deri në shekullin e V\XI. Kjo periudhë e cila mban emrin , "periudha e tesavvufit", është epoka e paraqitjes së sufive të mëdhenj në historinë islame.

Shekulli III hixhrij , jo vetëm nga aspekti i tesavvufit, por edhe nga aspekti i shkencave tjera islame, është me rëndësi të veçantë. Medhhebet fikhijje (juridike) dhe ato itikadijje (apologjetike) janë paraqitur në këtë shekull.

Nga aspekti i disiplinës së tesavvufit, ky shekull ka rëndësi të veçantë për shkak se tesavvufi në këtë periudhë ndahet prej fikhut, kelamit dhe hadithit.Termet dhe librat e para sufite janë shkruar në këtë shekull.

Sufitë e kësaj periudhe rëndësi të veçantë i kanë kushtuar analizave spirituale, makameve (pozitave) të ngritjes spirituale, pastrimit dhe kristalizimit të zemrës. Për herë të parë në këtë periudhë paraqitet botëkuptimi i vahdetit, fena-së dhe beka-së në tesavvuf.[41]

Sufijtë dhe zahidët e shekullit II\VIII kryesisht vinin prej katër qendrave të njohura: Medine, Kufe, Basra dhe

41 Vahdet- Njësim, të qenët një. Në tesavvuf ka vetëm një hakikat (realitet), ai është All-llahu xh.sh. Çdo gjë pos Tij nuk ka ekzistencë reale dhe absolute, por ekzistenca e tyre është relative. Në literaturën e tesavvufit ekzistenca e tyre shprehet me termin "mevxhudu'l-idhafi" ose "mevxhudu'dh-dhil-li". Vahdeti ndahet në tre grupe: kusudi, shuhudi, vuxhudi.
Fena - kaluese, mosekzistencë, shkrirje, të qenët hiç. Në terminologjinë e tesavvufit përdoret për shkrirjen e sufiut në Hakikatin absolut.
Beka - i përhershëm. Në terminologjinë e tesavvufit termi "Beka" është një makam i cili vjen pas Fena-së dhe ka kuptomin e përhershmërisë së sufiut në Hakikatin pas shkrirjes në të. Në mënyrë analoge këto terme përdoren edhe në praktikën e urdhërave dhe ndalesave. Fena do të thotë shkrirje e punëve të liga, kurse Beka përhershmëri e të mirave.

Horasan, kurse në këtë periudhë ata paraqiten në të katër anët e botës islame.

Sufijtë më të shquar të kësaj periudhe janë: Sehl ibën Abdullah Tusteri (283\851), Ibën Semmak (283\799), Ahmed ibën Hadravejh (240\854), Ahmed ibën Harb (234\848), Ebu Turab Nahshebi (245\859), Hakim Tirmidhi (320\932).

Në shekullin III dhe IV hixhrijj në botën islame paraqiten edhe disa shkolla të reja të tesavvufit, si p.sh.: shkolla e Nishapurit, e Egjiptit, e Sirisë, e Bagdadit. Paraqitja e shkollave të ndryshme do të inicojë edhe paraqitjen e tarikateve (rrugëve mistike) të përkohshme të tesavvufit, siç janë: Muhasibijje, Kassarijje, Tajfunijje, Xhunejdijje, Nurijje etj.[42]

Shekulli i V\Xi është epoka kur jetojnë Ebu Abdurrahman Sulemiu (412\1021) dhe Imam Gazaliu. i pari konsiderohet themeluesi i fjalës sistematike të shkruar në diciplinën e tesavvufit , kurse i dyti enciklopediku numër një në historinë islame.

Periudha e tesavvufit është koha kur sufijtë botëkuptimin e tyre orvaten ta mbrojnë nëpërmjet të librave, mundohen të mbizotërojë tesavvufin i cili do të ecë në binarët e Ehl-i Sunnetit dhe qëndrojnë larg prej të gjitha mosmarrëveshjeve mes frakcioneve itikadijje (apologjetike).

Periudha e Tarikatit.- Shekulli i VI\XII është periudha e sistematizimit të mendimeve të ndryshme sufike rreth një tarikati të veçantë.Tesavvufi i Ehl-i Sunnetit i kultivuar dhe zhvilluar nga ana e Imam Gazaliut, pas kësaj kohe më do të sistematizohet në tarikate të posaçme. Periudha e tarikatit fillon në shekullin XII dhe vazhdon deri në ditët e

42 Më gjerë shih: Yilmaz, Kamil, Po aty, fq. 116-130.

sodit. Shekulli i XII është koha e dobësimit total të shtetit Abasid dhe depërtimit mongol prej Lindjes. Shtetet e vogla të formuara brenda kufijve të shtetit abasid nuk do të kenë mundësi që t'i kundërvihen okupatorit të fuqishëm mongol, prandaj popullata kryesisht do të tubohet rreth liderëve shpirtërorë, sufive.

Në këtë periudhë kanë jetuar sufitë më të shquar të historisë Islame, edhe atë: Abdulkadir Gejlani ( 420\1026), Ahmed Rifai ( 528\1183), në Azinë e Mesme Ahmed Jesevi (562\1166), Ebu'l Hasan Ali ibën Abdullah Shazili (606\1209), Shejh Nexhmeddin Kubra (618\1221), Ibn Arebi (638\1240), Mevlana Xhelalud-din Rumi (628\1231) etj.

Çdonjëri prej këtyre sufive ka edhe tarikatin e vet i cili është themeluar në bazë të mësimeve të tij, siç: Kadirijtë, Rifaijtë, Halvetijtë, Shazelijtë, Ekberijtë, Mevlevijtë etj. Në shekujt e mëvonshëm paraqiten edhe disa tarikate tjera, por një numër i madh i tyre janë degë të këtyre tarikateve të mëdha, posaçërisht halvetijtë kanë një numër të madh të nëndegëve.

Me rrënien e shtetit osman dhe ngritjen e halifatit, veprimtaria e tarikateve në Turqi ndalohet në përgjithësi. Edhe pse veprimtaria e tyre do të vazhdojë ilegalisht, lidhjet e tarikateve në mbarë botën Islame fillojnë të ndërpriten. Situatë identike, ndoshta edhe më e rëndë është edhe në vendet arabe, të cilat në atë kohë janë koloni të shteteve evropiane. Për shkak të kësaj ndërprerjeje të lidhjes tarikatet në Ballkan do të përjetojnë disfata të mëdha si në pikpamje të mësimeve tesavvufiane ashtu edhe në zbatimin e vlerave sufike.

Mirëpo, përderisa në njërën anë në lindje botëkuptimi sufik përjetonte krizë të madhe, në anën tjetër në Perëndim do të paraqiten një numër i konsiderueshëm i

shkencëtarëve dhe poetëve perëndimorë të cilët të motivuar prej xhezbes (tërhjekshmërisë) tesavvufiane do të përqafojnë Islamin dhe do të shkruajnë vepra me rëndësi në lidhje me Idenë e Lartë. Si p.sh. Rene Guenoni, Titus Bruckhardi, Nicholsoni, Eva de Vitrey Meyerovitchi etj.

## THEMELIMI I TARIKATIT BEKTASHIAN DHE VENDI I TIJ NË ZINXHIRIN E TARIKATEVE ISLAME

Në gjysmën e dytë të shekullit XIII në Anadoli bëhen trazira të mëdha. Autoriteti politik i shtetit abasid ishte luhatur në tërësi. Sulltani i Selçukëve Këllëçasllani II kishte probleme të mëdha për mbrojtjen e shtetit të madh të lulëzuar në kohën e gjyshit të tij Alaeddin Kejkubadit. Në lindje mongolët ishin në përgaditje e sipër për të sulmuar vendet Islame.[43]

Në këtë periudhë mjaft të rëndë bota islame përjetonte krizë pothuajse në të gjitha sferat e jetës, si në atë politike, ushtarake, shoqërore, fetare etj. Një numër i madh i dijetarëve , posaçërisht i sufive, është vendosur në Anadoli. Në këto momente kur sistemi shoqëror ishte shkatërruar në tërësi, popullata e gjerë të vetmin shpëtim e gjeti në mbështetjen në liderët shpirtërorë të cilët në Anadoli kishin ardhur prej viseve të ndryshme të botës islame. Kështu që jeta sufite dhe tarikatet u përhapën me të madhe në të gjitha viset e Anadolisë. Filozofia e tesavvufit e udhëhequr me moton që njerëzve të cilët përjetojnë krizë në cilëndo sferë të jetës t'u mundësohet kthimi drejtë Kur'anit dhe Sunnetit si dhe të prezentohen

43 Turan, Refik, XIII Yuzyil Anadolu Buhrani ve Ayakta Kalan Güçler, Erdem derg., Turklerde Hosgoru ozel sayisi II,535.

vlerat e larta shpirtërore si cak i fundit në jetën e kësaj bote, do të gjejë tokë mjaft të plleshme në shoqërinë e Anadolisë së shekullit XIII dhe XIV. Popullata e cila ishte e rraskapitur prej përleshjeve mes dinastive të ndryshme, prej luftës së kryqzatave, okupimit mongol, qetësinë shpirtërore do ta gjejë në tarikatet dhe sufijtë e asaj kohe.

Sufijtë dhe shejhët e ardhur prej qyteteve të ndryshme të vendeve islame u vendosën kryesisht nëpër qytetet e mëdha të Anadolisë, përderisa vendet më periferike përsëri mbetën të zbrazëta.Në qytet do të zhvillohet botëkuptimi i vahdet-i vuxhud'it nëpërmjet të Ibën Arebiut dhe Sadreddin Koneviut; toleranca, arti dhe estetika nën udhëheqjen e Nexhmuddin Dajes, Bahauddin Veledit, Burhaneddin Muhakkikit, Evhaduddin Kirmanit; Mevlana Xhelaluddin Rumi në sistemin e vet sufit do t'i bashkojë këto botëkuptime të prezentuara nga të parët e vet dhe do të zërë vend të veçantë në zemrat e popullatës, duke u bazuar në tri vlera estetike: poezinë, muzikën dhe sema'në.[44]

Mevlana Xhelaluddin Rumi ka lozur rol vendimtar në themelimin dhe kultivimin e tesavvufit sunnit në vende të ndryshme të Anadolisë. Themi tesavvufit sunnit për shkak se

---

44 Sema - dëgjim. Tesavvuf: dëgjim i ilahive dhe muzikës fetare, dëgjim i teksteve fetare të komponuara.Vallëzim, rrotullim nën motivacionin e muzikës fetare. Sipas Mevlanës Sema'ja vjen prej Hak-ut dhe njerëzit i thërret drejt Hakk-ut. Të gjithë personat të cilët marrin pjesë në grupin e Sema-së janë simbole të trupave qiellorë. Veshja e tyre e bardhë simbolizon qefinin, kurse kapuçët e posaçëm të gjatë (sikke) simbolizojnë gurrët e varrezave. Rrotullimi i tyre rreth vetes dhe rreth shejhit simbolizon rrotullimin e tokës rreth boshtit të vet dhe rreth diellit. Më gjerë shih: Sulejman Uludag, Islam Açisindan Musiki ve Sema, Istanbul 1999.

në anën tjetër thirrësit batinijj[45] mundoheshin që në këto vise të prezentojnë besimet dhe botëkuptimet e tyre batinijje, të cilat shumë pak gjëra kishin të përbashkëta me mësimet islame.

Përderisa në qytetet dhe qendrat e mëdha situata ishte e këtillë, jeta fetare gjegjësisht tesavvufi në viset malore periferike (banorë të të cilëve ishin kryesisht turkmenët) udhëhiqej nga ana e shejhëve dhe baballarëve, të cilët shumë pak e njihnin Islamin e mos të flasim për tesavvufin. Në këto vise ende nuk ishin çrrënjosur në tërësi botëkuptimet e vjetra pagane dhe dalëngadalë merrnin trajtën e elementeve të fesë së re të pranuar. Edhe pse në bazë ishin sunni-hanefi, elementet e besimeve të tyre të mëparshme i largonin dalëngadalë prej kësaj vije. Të tillë ishin kalenderijtë, babaijtë, hajdarijtë etj.[46]

Rol të posaçëm në strukturën e jetës fetare në Anadoli do të luajë edhe tarikati jesevi[47], i cili në fillim të shekullit XIII me të madhe do të përhapet në viset periferike turkmene.

---

45 Batinijtë janë disa frakcione të cilat janë paraqitur në botën islame me moton se vendimet e Sheriatit nuk mund të kuptohen ashtu si duken në anën e jashtme(egzoterike), por nëpërmjet të sqarimeve të Imamit duhet të koncentrohemi në brendinë (ezoterikën) e tyre. Kështu që nuk kanë falë namaz, nuk kanë agjëruar etj.dhe këto vendime decide të Kur'anit i kanë komentuar sipas botëkuptive të veta. Të tillë kanë qenë : karmatijtë, ibahijtë, ismailijtë etj. Më gjerë shih: Imam Gazali, Fedaihu'l-Batinijje, në turq. Batiniligin Içyuzu, përkth. Avni Ilhan, Ankara 1993.

46 Më gjerë shih: Osmanli Imparatorlugunda Marjinal Sufilik, Kalenderiler, AHMET Yashar Ocak, Ankara 1992; Babailer Isyani , Tarihsel Altyapisi Zahut Anadoluda Islam-Turk Heteredoksinin Tesekkulu,Istanbul 1996.

47 Tarikati jesevi është një tarikat i themeluar nga ana e Hoxha Ahmed Jeseviut (562\1167) në Azinë e Mesme dhe kryesisht është përhapur në mesin e turqve. Ndikim të posaçëm ka pasë edhe në themeluesin e tarikatit bektashian, Haxhi Bektash Velinë.

Në një epokë e cila kishte karakteristika të këtilla- të cilat ne u munduam t'i prezentojmë në pika të shkurtëra – në Anadoli paraqitet tarikati bektashian. Në momentet kur në njërën anë me të madhe depërtojnë idetë e devijuara të batinive e në anën tjetër popullata periferike kishte mbetur në duart e shejhëve dhe baballarëve kalenderi e hajdari paraqitet Haxhi Bektash Veliu dhe me një metodë tolerante sintetizuese do të mundohet që këto grupe të njerëzve t'i mbajë nën ombrelën e Islamit.

Haxhi Bektash Veliu është një pir[48]i madh, njohës bukur i mirë i mendimit sufit në Islam, por në të njëjtën kohë njohës bukur i mirë edhe i rrethanave kohore në të cilat ka jetuar. Por një gjë është shumë me rëndësi që ai ka qenë musliman, i rritur dhe edukuar në kulturën sufite islame, i shoqëruar me liderët sufit të asaj kohe, Mevlana Xhelaleddin Rumin, Sadreddin Koneviun, Kirmanin etj. Njëkohësisht aktiviteti i tij ka qenë kundër propagandës batinijje të thirësve safevid. Duke u bazuar në disa praktikime më liberale dhe tolerante të bektashinjve të mëvonshëm, një grup i dijetarëve, nën ndikimin e disa orientalistëve, bektashinjtë do t'i emërtojnë si tarikat heterodoks, kurse grupi tjetër ata i quan si tarikat i cili ka dalë jashtë binarëve të Islamit, madje një grup tejet ekstrem orvatet që tarikatin bektashian ta konsiderojë si fe të veçantë. Secili prej vlerësimeve të lartëpërmendura është i gabuar dhe aspak nuk pajtohet me argumentet historike të paraqitjes së tarikatit bektashian. Pikë së pari përdorimi i termit heterodoks, i cili në Perëndim përdoret përkundër termit ortodoks është i gabuar, për arsye se këto dy terme janë krishtere dhe kanë këtë kuptim:

48 Pir- i vjetër, plak. Tesavvuf: Shejh, udhërëfyes, themelues i një tarikati të posaçëm.

Orthodoks - grup i cili jetën fetare e rregullon sipas botëkuptimit zyrtar të kishës dhe

Heterodoks - grup i cili në praktikën fetare del jashtë vijës kishtare.

Përdorimi i këtyre dy termeve për Islamin, në të cilin nuk ka një rregullim dhe botëkuptim zyrtar të praktikës fetare, që në fillim është i gabuar.Prandaj nëse në mesin e muslimanëve paraqiten momente dhe nuansa të ndryshme prej njëri tjetrit dhe ata nuk dalin jashtë Kur'anit dhe Hadithit, sipas vlerësimit të Pejgamberit a.s. janë rahmet (mëshirë).

Gjithashtu edhe vlerësimi i cili kryesisht bëhet prej dijetarëve tradicionalistë muslimanë se bektashinjtë janë tarikat joislam është ekstrem dhe jo i përshtatshëm me sistemin e vlerave në Islam.Pejgamberi a.s. nuk lejon që askujt t'i themi pabesimtarë, zemrat e njerëzve i din vetëm All-llahu xh.sh,kurse prej nesh kërkon që njerëzve të cilët bëjnë devijime në praktikën fetare me sjelljet dhe mendimet tona progresive të ëmbla dhe të matura t'ua tregojmë rrugën e vërtetë islame.

Kurse, përsa i përket mendimit se tarikati bektashian është një fe e veçantë, mendoj se është një gabim trashanik i cili nuk mund të argumentohet me asfarë faktesh, as historike, as bibliografike e as apologjetike.

Tarikati bektashian dhe themeluesi i tij Haxhi Bektash Veliu janë një hallkë e zinxhirit të tesavvufit Islam. Veprimtaria e tyre disashekullore ka qenë për përhapjen e fesë Islame dhe askush nuk ka të drejtë që si Bektashi vehten ta konsiderojë jashtë Islamit , e as që dikush ka të drejtë që bektashive –për këtë ose atë arsye-t'u thotë se nuk janë muslimanë.

## HAXHI BEKTASH VELIU DHE TARIKATI BEKTASHIAN

Pas themelimit të tarikateve në botën islame, duke filluar prej shekullit XI e më tej, ato si institucione shoqërore do të luajnë rol të rëndësishëm në strukturën e popujve të cilët do ta pranojnë Islamin nëpërmjet të tyre.

Tarikatet, përpos rolit të tyre në edukimin e individëve, kanë vepruar dukshëm edhe në platformën shoqërore. Në të shumtën e rasteve përhapja dhe jetësimi i vlerave fetare në shtresat e gjera të popullatës është bërë nëpërmjet të tarikateve të lidhura ngushtë me Kur'anin dhe Sunnetin.

Në historinë islame jetësimi i Islamit, prezentimi i tij dhe thirrja në Islam është bërë nëpërmjet të tre institucioneve, edhe atë:

- intelektualëve
- sufive dhe
- ushtrisë muslimane.

Në të shumtën e rasteve një numër i konsiderueshëm i ushtarëve, posaçërisht në periudhën osmane kanë qenë sufi dhe dervish të një tarikati të caktuar.[49]Një pjesë e sufive gjithmonë kanë shkuar para ushtrive osmane, që së pari të përfitojnë zemrat e popullatës e pas tyre ushtria osmane ka ardhë në teren të përgatitur. Shembuj të tillë ka pothuajse në të gjitha viset ballkanike. Thënë shkurt edukimi dhe arsimimi i popullatës së gjerë në periudhën osmane është

49 Kryesisht kanë qenë bektashi, nakshibendi dhe halveti. Duke prezentuar këto funkcione të tarikateve të ndryshme dëshiroj që njeriut tonë t'i sqaroj se tarikati si nocion nuk është diçka e keqe, por veprimtaria e gabuar dhe jashtë binarëve të urdhërave dhe ndalesave kur'anore –e cila gjë për fat të keq paraqitet në një pjesë të tarikateve- është e dëmshme dhe e kobshne edhe për vet institucionin e tarikatit edhe për vlerat shpirtërore të njeriut, njëkohësisht edhe për strukturën e gjerë shoqërore.

bërë në teqetë kurse edukimi dhe arsimimi i veçantë, sistematik në institucionet e shkollimit të lartë, në medresetë.

Fukcionet shoqërore të sufive dhe tarikateve të ndryshme mund t'i rrumbullaksojmë në disa pika:

1. Afrimi i zemrave të popullatës së vendeve të posaçliruara në Islam.
2. Përhapja e Islamit në vendet e jomuslimanëve nëpërmjet të dervishëve udhëtues.
3. Organizimi i kryengritjeve kundër fuqive okupuese nga ana e teqeve të ndryshme.
4. Inkuadrimi i drejtëpërdrejtë i dervishëve të teqeve të ndryshme në ushtrinë osmane.
5. Përhapja e Islamit në vendet më të largëta të civilizimit të atëhershëm, në Indi, te tatarët, në Afrikë etj.
6. Ndërmjetësimi i sufive të mëdhenj në përfundimin e përleshjeve mes fiseve dhe shtresave të ndryshme në shoqëritë ku kanë vepruar.[50]

Të gjitha këto vlerësime të lartëpërmendura janë valide edhe për tarikatin bektashian, posaçërisht në epokën e parë të saj. Tarikati bektashian ka treguar sukses të posaçëm në mbajtjen nën ombrelën islame turkmenët e vendeve më periferike të Anadolisë: në kundërshtimin e ideve batinijje, si dhe në veçanti në depërtimin e Islamit në viset ballkanike,njëkohësisht edhe në ngritjen e vlerave arsimore, estetike dhe fetare te popullata e re në Islam.[51]

50 Yilmaz, Kamil Po aty, fq. 254.
51 Më gjerë shih: Popoviç Alexandar, L'islam balkanique, përkth. Në turq. Balkanlarda Islam, Istanbul 1995; Melikoff, Irenne, Uyur idik Uyardilar, Istanbul 1994;Koprulu Fuad, Turk Edebiyatinda ilk mutasavviflar, Ankara 1993.

Për të kuptuar më mirë esencën, strukturën dhe historinë e tarikatit bektashian është e domosdoshme që historikun e tij ta shkoqisim në dy periudha. Periudha e parë është Periudha e Haxhi Bektash Veliut- duke filluar prej shekullit XII e deri në shekullin XV- ndërsa periudha e dytë është Periudha e Ballim Sulltanit, e cila fillon prej shekullit XVI dhe vazhdon deri në ditët e sotit.

## PERIUDHA E HAXHI BEKTASH VELIUT

Historia e tarikatit bektashian fillon me jetën dhe veprën e themeluesit të tij Haxhi Bektash Veliut. Haxhi Bektash Veliu është një sufi i madh i ritur dhe i edukuar prej shejhëve dhe baballarëve të tarikatit jesevi. Edhe pse ky person i lartë do të lërë gjurmë të thella në shoqëritë islame pas shekullit XIII, shumë pak dijmë për jetën e tij. E tërë ajo që transmetohet në lidhje me jetën e Haxhi Bektash Veliut është nxjerrë prej legjendave të shumta të cilat ekzistojnë në lidhje me këtë person të lartë.

Burimet më të vjetra të cilat japin njohuri për jetën e Haxhi Bektash Veliut janë Vilajetnamet[52] e shkruara dy shekuj pas vdekjes së Haxhi Bektash Veliut nga ana e myridëve (ithtarëve) të tij, njëkohësisht edhe Eflaki (1360) në veprën e tij "Menakibu'l-Arifin" dhe Ashëkpashazadeja (1481) në veprën "Tevarih-i Al-i Osman" jep disa njohuri të shkurta në lidhje me Haxhi Bektash Veliun.[53]

52 Vilajetname- vepër e cila përmban njohuri për jetën , veprimtarinë( kerametet), dhe legjendat që bëjnë fjalë për ndonjë sufi të lartë. Vilajetnameja ose Menakib-i Haxhi Bektash-i Veli është botuar në Stanboll në vitin 1958 nga Abdulbaki Golpinarliu.

53 Figlali, E.R., Po aty, 137.

Sipas Vilajetnames, Haxhi Bektash Veliu është i biri i kryetarit të Horasanit Ibrahim es-Sani Sejjid Muhammedit dhe Hatmes, bijës së një dijetari të madh prej Nisaburi Shejh Ahmedit. Emri i tij i vërtetë është Bektash.[54] Në burimet e ndryshme para emrit të tij përdoret edhe fjala Hynkar.[55]Ndërsa llagapin Haxhi e merr pas një kerameti[56] të prezentuar , për të cilin flet Vilajetnameja. Në të thuhet: Mësuesi i Haxhi Bektash Veliut, Llokman Perende'ja,[57] prej Horasani me të afërmit e tij ka shkuar në haxhxh. Në momentet kur qëndronin në Arafat ai u drejtohet shokëve të vet: "Sot është ditë arifeje, tash në shtëpinë tonë ziejnë gjellë". Këtë fjalë e dëgjon Haxhi Bektash Veliu i cili gjindej larg në Horasan. Menjëherë shkon në shtëpinë e Llokman Perendes, merr një pjatë me gjellë dhe sa çel e mshel sytë ia çon në Arafat. Kur kthehen prej haxhxhit Lokman Perende'ja thotë se haxhi i vërtetë është Bektash Veliu e jo ne. Dhe prej këtij momenti i ngel edhe nofka Haxhi.

Në lidhje me lindjen, edukimin dhe jetën e tij në Horasan mësojmë vetëm nga legjendat e Vilajetnames.

54 A. Rifkija në librin e tij "Bektashi Sirri" pohon se emri i vërtetë i tij është Muhammed kurse llagapin e ka pasur Bektash. Fjala "bektash" rrjedh prej persishtes dhe ka këtë kuptim: shok, mik, i ngjashëm, i njjëjtë.

55 Hynkar- është fjalë persiane cila ka kuptim të sulltanit, perandorit. Këtu përdoret për Haxhi Bektash Veliun për shkak se sipas bektashive ai është sulltan i evlijasë. Shih Haxhi Bektash-i Veli, Makalat, punuar nga Esad Xhoshani, Istanbul fq. XX-XXI.

56 Keramet- prezentimi i gjendjeve dhe rasteve të jashtëzakonshme nga ana e personave të ngritur por që nuk janë pejgamber. Te pejgamberët këto situata të jashtëzakonshme emërtohen muxhize. Përderisa kusht i muxhizes është që të shfaqet dhe të argumentohet pejgamberllëku me te , kerameti duhet të fshihet.

57 Llokman Perende'ja është murid i Ahmed Jeseviut dhe bartës i tarikatit jesevi në Anadoli. Ai vetë është kujdesur për edukimin dhe arsimimin e Haxhi Bektash Veliut. Shih: Eroz Mehmet, Turkiyede Alevilik ve Bektasilik, Ankara 1990, fq.53.

Pikërisht për këtë, viti i lindjes dhe vdekjes së tij në shumicën e veprave të shkruara rreth Haxhi Bektash Veliut nuk është i njëjtë. Orientalisti i njohur John Kingsley Birge, duke u bazuar në një dorëshkrim të gjetur në Bibliotekën e Universitetit të Stambollit dhe në bazë të llogaritjes sipas Ebxhed-it[58], pohon se Haxhi Bektash Veliu është lindur në vitin 645 ose 646\1248; në vitin 680\1281 ka ardhur prej Horasani në Anadoli, ka jetuar 92 vjet dhe ka ndruar jetë në vitin 738\1337.[59]Duke u bazuar në një risale (traktat) i cili

58 Vlerësimi numerik i shkronjave të gjuhës arabe. Në të shumtën e rasteve në shkrimet e vjetra datat me rëndësi nuk jepen me numra por prezentohen nëpërmjet të fjalëve, vlerat e numerike të shkronjave të të cilës japin vitin e kërkuar. Shkronjat sipas vlerave numerike janë të rradhitura në tetë fjalë edhe atë: ebxhed-hevvez-hutti-kelemen-sa'fes-kareshet-thehadh-dadhig. Secila prej shkronjave ka vlerën e saj numerike siç vijon:

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| elifi-1 | ba-2 | xhim-3 | dal-4 | he-5 | vav-6 |
| ze-7 | ha-8 | ta-9 | je-10 | kef-20 | lam-30 |
| mim-40 | nun-50 | sin-60 | ajn-70 | fe-80 | sad-90 |
| kaf-100 | ra-200 | shin-300 | te-400 | the-500 | ha-600 |
| dhal-700 | dad-800 | gajn-1000 | | | |

59 Katërvargëshi i cili prezenton vitin e lindjes së Haxhi Bektash Veliut është:

- Hazreti Pirin Veladet Muruvvet

Mim-40 re-200 ve-6 te-400 = 646 viti I lindjes.

- Horasandan Ruma Tesrif eder reft

Re-200 fe-80 te-400= 680 viti i ardhjes në Anadoli (1281)

- Muddeti omru Muhammeddir cemali

mim-40 ha-8 mim-40 dal-4= 92 sa vjet ka jetuar.

- Bektashijje tarih asvabi rihlet

ba-2 kef-20 te-400 elif-1 shin-300 je-10 he-5=738 viti i vdekjes (1337).

Me gjerë shih: Birge, John Kingsley, The Bectashi Order of Dervishes, 34-35; Noyan Bedri, Bektashilik Alevilik Nedir? Istanbul 1995, fq. 23.

gjendet në Bibliotekën e Ankarës viti i lindjes së tij duhet të jetë 606\1209-1210, kurse i vdekjes 669\1270-1271.[60]

Haxhi Bektash Veliu mësimet e para i merr në Nishapur, ku e mëson bukur mirë arabishten dhe persishten. Për edukimin e tij shpirtëror , siç u tha edhe më lartë, është kujdesur halifeja e Ahmed Jeseviut, Llokman Perende'ja.

Kjo shihet edhe nga silsileja[61] e Haxhi Bektash Veliut: es-Sejjid Bektash el-Horasani - Llokman Perende - Ahmed Jesevi- Abdul Halik Guxhduvani- Jusuf el-Hamedani - Ebu Ali el-Farmedi- Ebul-Hasan el-Harkani- Ebu Jezid Bistami- Ebu Osman Magribi - Ebu Ali el-Katib - Ebu Ali er-Ruzbari - Xhunejd el-Bagdadi dhe në fund kjo silsile arrin në Hazreti Aliun dhe Pejgamberin a.s. [62]

Haxhi Bektash Veliu ka ardhur në Anadoli në vitet 20-30 të shekullit XIII kur në këto vise ishin vendosur shumë familje të ikura prej okupimit mongol. Ky emigrim i gjerë i popullatës gjithësesi me vete kishte sjellë edhe probleme të shumta socio-ekonomike. Veprimtaria e Haxhi Bektash Veliut në Anadoli kryesisht do të jetë e koncentruar në këto mjedise në periferi dhe në mesin e atyre familjeve të cilat kishin ikur prej Azisë së Mesme .

Me të ardhur në Anadoli ai së bashku me vëllaun e tij Menteshin shkon të takohet me bashkëvendasin e tij Baba

60 Noyan, Bedri, po aty, 24; Zeljut Riza, Oz kaynaklarina gore Alevilik, Istanbul 1990, fq. 208-10.

61 Zinxhiri i shejhëve prej të cilëve ka marrë mësim ezoterik një sufi i caktuar. Të gjitha tarikatet kanë silsilen e vete dhe në fund ata arrijnë te Pejgamberi a.s. nga dy rrugë , nga rruga e Ebu bekrit r.a. dhe Aliut r.a.. Tarikatet të cilat arrijnë te Pejgamberi a.s. nëpërmjet të Ebu Bekrit r.a. quhen "Bekrijje", kurse ata që arrijnë nëpërmjet të Aliut r.a. quhen "Alijje" .

62 Figlali, Ethem, Po aty, fq.143; Noyan, Bedri, Po aty,fq. 27-28.

Iljasin.[63]Pasi që ka marrë dorë prej Baba Iljasit ka shkuar në Konja, ku është takuar me Mevlana Xhelaluddin Rumiun dhe pa mos u ndalur shumë është kthyer në Suluxha Karahojuk (Haxhi Bektashi i sotshëm).[64]

Ashëk Pashazadeja ardhjen e tij në Anadoli e sqaron me këto fjalë: …"Ky Haxhi Bektashi u nis prej Horasani. Kishte një vëlla që quhej Mentesh. U nisën që të dy së bashku për në Anadoli. Piksëpari u ndalën në Sivas. Para tyre në Anadoli ishte vendosur Baba Iljasi. Ata deshtën të takohen me te. Rrëfimet rreth Baba Iljasit janë të shumta. Ky Haxhi Bektashi me vëllaun e tij prej Sivasit shkuan te Baba Iljasi. Menteshi prej aty u kthye përsëri në vendlindje, Haxhi Bektashi e përcolli prej Kajserisë. Mirëpo ende pa arritur në Sivas gjatë kthimit ai ra dëshmorë. Rrëfimet e tyre janë të

63 Pjesa dërmuese e burimeve pranon se Haxhi Bektash Veliu është takuar me Baba Iljasin, i cili është një Baba i tarikatit babai. Mirëpo burimet historike nuk konfirmojnë këtë pohim që ka të bëjë me inkuadrimin e tij në kryengritjen babaijje e cila bëhet në vitin 637\1240. Në një pjesë të burimeve thuhet se Haxhi Bektash Veliu pasi që është takuar dhe ka marrë dorë prej Baba Iljasit, është tërhequr në qytetin Suluxha Karahojuk (sot Haxhi Bektash) dhe ka vazhduar veprimtarinë e tij me metodat e veta themelore e që janë: Paqa dhe dashuria.Ndërsa pjesa tjetër e burimeve thotë se Haxhi Bektash Veliu edhe pse në mënyrë direkte nuk ka marrë pjesë në kryengritjen babaijje, ai në teqen e tij i ka edukuar myridët Hajdari, Kalenderi dhe Jesevi dhe i ka dërguar në vise të ndryshme të Anadolisë dhe Rumelisë. Krahasoni: Figlali, Ethem, Po aty, fq. 148-9; Ahmet Yashar Ocak , Kalenderiler, fq.207-9; Bedri Noyan, Po aty, fq. 28-29; Riza Zelyut, Po aty fq.213.
Në lidhje me kryengritjen Babaijje në Anadoli më gjerë shih: Ahmet Yashar Ocak, Babailer Isyani, Aleviligin Tarihsel Altyapisi, Yahut Anadoluda Islam Turk Heterodoksinin Tesekulu, Istanbul 1996.

64 Noyan, Bedri, Po aty, fq. 29.

shumta, të gjitha i di saktësisht. Haxhi Bektashi prej Kajserisë erdhi në Suluxha Karahojuk dhe varrin e ka aty.[65]

Ai arriti në Anadoli në momente të rënda të krizës politike, prandaj u desht të tërhiqet në një qytet të qetë.Ai e dinte, që më vonë do të shihet edhe në veprimtarinë e tij, se derisa njeriu nuk shpëton dot prej lakmive dhe dobësive të nefsit (egos), asnjëherë nuk mund të fitojë lirinë. Prandaj Haxhi Bektash Veliu nuk i bashkangjitet kryengritjes së Baba Iljasit, por duke zgjedhur rrugën e urtisë, gnosës dhe dashurisë vazhdon veprimtarinë e tij për hirë të All-llahut xh.sh.

Suluxha Karahojuk'u në kohën kur aty vendoset Haxhi Bektash Veliu ishte një qytezë e vogël dhe e qetë. Jeta, martesa ose mosmartesa e tij në këtë vend të vogël, për shkak të mosekzistimit të argumenteve decide, ende nuk është e sqaruar si duhet. Problemi se Haxhi Bektash Veliu është martuar ose jo ka bërë që edhe sot e kësaj dite bektashijtë të jenë të ndarë në dy grupe. Sipas Vilajet-names, ai në Suluxha Karahojuk piksëpari vendoset në shtëpinë e Idris Hoxhës. Pas qëndrimit të shkurtër në shtëpinë e tij, ai ndërton një dhomë të vogël që sot mban emrin Këzëlxha halvet (Halveti kuq).[66]Kjo dhomë gjendet në kopshtin e tretë të Dergahit[67] të Madh në anën e djathtë

---

65 Asikpasaoglu Ahmed, Tevarih-I Al-I Osman, duzenleyen: N. Atsiz, Istanbul 1949.

66 Halvet-largim prej popullatës, prej njerëzve dhe qëndrim në një vend të izoluar vetë. Tesavvuf: Qëndrim vetë dhe meditim rreth krijimtarisë së të Gjithfuqishmit. Në tarikatet e ndryshme koha e qëndrimit në halvet ndryshon: 40 ditë, 1001 ditë, 3 ditë etj.

67 Dergah-prag i derës. Tesavvuf: teqe e madhe.

të hyrjes së Kërklar Mejdanit.[68] Vilajetnameja thotë që Haxhi Bektash Veliu nuk është martuar deri në fund të jetës së tij.[69]

Çështja e ardhjes së Haxhi Bektash Veliut në Anadoli është një moment me rëndësi, si dhe vendimtar në themelimin e tariaktit Bektashian, prandaj edhe është bërë temë e legjendave të ndryshme. Në një legjendë thuhet kështu: Evlijatë e Rumit (Anadolisë) janë ulur rreth Karaxha Ahmetit dhe bisedojnë. Përnjëherë vajza e Sejjid Nureddinit

68 Kërklar- katërdhjetë veta. Tesavvuf: Në literaturën e tesavvufit e veçanërisht te Bektashijtë përdoret për 40 evlijatë që kanë qenë me Aliun r.a.. Rreth këtij termi më vonë janë paraqitur edhe terme tjera, si p.sh.. Kërklar Mexhlisi, Kërklar Sohbeti, Kërkllar Sherbeti etj. Ndërsa Kërklar Mejdani është një vend i rrethuar në teqenë e Haxhi Bektash Veliut.

69 Dallimi kryesor në mes dy grupeve kryesore bektashijje, grupit Babagan (Myxhered) dhe Çelebijje ka të bëjë me çështjen e martesës së Haxhi Bektash Veliut.
Sipas Vilajetnames një ditë Haxhi Bektash Veliu duke marrë abdest prej hundës i rrjedh gjak, atëherë i drejtohet Kadënxhëk Anës (Fatma Nurijje) bijës së Idris Hoxhës dhe i thotë që këtë ujë ta derdhë në një vend të largët ku nuk do ta shkelë këmba e njeriut. Kadënxhëk Ana largohet pak e pin ujin prej legenit dhe ia kthen legenin Haxhi Bektash Veliut. Ai e kupton se e ka pi ujin, mirëpo Kadinxhëk Ana i përgjigjet me këto fjalë: "Nuk munda të gjejë asnjë vend ku do ta derdhja atë që ka mbetë prej erenlerve (të ndriturve) , e gjeta vetëm barkun tim". Atëherë Hynkar Haxhi Bektash Veliu i thotë:" Ti e more nasibin tënd prej nesh. Ti do të lindësh dy djem, ata do të jenë të ngritur. Shtatëdhjetvjeçarët e popullatës do tua puthin dorën atyre kur ata do të kenë vetëm shtatë vjet." Pas kësaj Kadënxhëk Ana lind tre djem, njëri prej tyre vdes qysh duke qenë gjallë Haxhi Bektash Veliu, kurse dy të tjerët jetojnë edhe më vonë.
Grupi Babagan, duke u bazuar në këtë transmetim, pohon se Haxhi Bektash Veliu nuk është martuar kurrë. Sipas tyre ka ndruar jetë i pamartuar, kurse bijtë e Kadënxhëk Anës janë djem shpirtëror, ose më konkretisht djem të rrugës.Ndërsa çelebinjët e kundërshtojnë këtë mendim dhe thonë se Haxhi Bektash Veliu në Suluxha Karahojuk është martuar me vajzën e Idris Hoxhës Fatma Nurijjen dhe prej tyre ka lind Ibrahim Sejdi, gjegjësisht Sejjid Ali Sulltani.

u drejtua dhe tha. Alejkumu's-selam ja Veli Benan. E pyetën, çfarë u bë, me kë u përshëndete? Sot në Anadoli erdhi një evlija i vërtetë, selamin e tij e mora, u përgjigj ai. Haxhi Bektash Veliu shndërrohet në pëllumb dhe shkon e ulet mbi një gur në Suluxha Karahojuk. Sulltani i evlijave të Anadolisë Karaxha Ahmedi kontrollon tërë Anadolinë por nuk sheh asnjë të ardhur tjetër pos këtij pëllumbi. Atëherë Karaxha Ahmedi e dërgon Haxhi Tugrullin në formë të shqiponjës që ta zërë këtë pëllumb, mirëpo sa i afrohet Haxhi Bektash Veliu kthehet në formën e tij dhe e kapën për fyti shqiponjën dhe thotë: Evlijaja evlijasë nuk i vjen në këtë mënyrë, unë ju erdha në formë të një shpeze të butë kurse ju m'u vërsulët si egërsirë. Atëherë Haxhi Tugrulli i përgjigjet.: Sikur të kishim gjetur formë më të butë se pëllumbi ashtu do të kishim ardhë, mirëpo nuk gjetëm dot."

Edhe pse legjenda nuk është ndonjë dokument me rëndësi të madhe historike, prapseprapë në mënyrë simbolike prezenton vendin e Haxhi Bektash Veliut në zinxhirin e tesavvufit islam si dhe burimin e lartësisë shpirtërore të tij.

Haxhi Bektash Veliu deri në fund të jetës së vet qëndron në Suluxha Karahojuk ku edhe e ka varrin dhe tyrben. Disa burime flasin edhe për takimin e tij me Orhan Gaziun, sulltanin e dytë të shtetit Osman dhe themelimin e arradhave jeniçere nga ana e Haxhi Bektash Veliut, mirëpo kjo historikisht nuk është e mundshme për shkak se kanë jetuar në periudha të ndryshme kohore.[70]

Këtë pjesë të jetës së Haxhi Bektash Veliut do ta mbaroj me fjalët e Sami Frashërit, i cili pohon se Haxhi Bektash Veliu është takuar me Orhan Gaziun dhe ka marrë pjesë në themelimin e rendit të jeniçerëve:

70 Shih: Ashikpashaoglu Tarihi fq. 273338.

"Haxhi Bektash Veliu është një prej evlijave të lartë, me prejardhje prej qytetit Nishapur të Horasanit. Pasi që në Horasan mësoi dituritë shpirtërore prej shejh Llokmanit në shekullin e 8 hixhri u shpërngul në Anadoli. Gjatë veprimtarisë së tij në Anadoli atë e viziton Orhan Gaziu dhe merr bekimin e tij. Madje edhe në formimin e jeniçerëve ai i është lutur All-llahut për suksesin e tyre. Sipas një transmetimi edhe emrin "jeniçer" ua ka dhënë vetë Haxhi Bektash Veliu. Madje ka nxjerrë njërin krah të hërkës (mantelit) të tij dhe ia ka lidhur në krye të parit të jeniçerëve. Pjesa e kuqe e varrur në kapuçët e jeniçerëve ka mbetur prej kësaj dite. Haxhi Bektash Veliu ka qenë evlija me grada dhe qeramete të larta. Ka ndëruar jetë në kohën e Sulltan Muradit të Parë (Hudavendigarit) dhe është varrosur në Haxhi Bektash rreth Kërshehirit. Tyrbeja e tij është vend vizite për tërë popullatën. Rreth tyrbes së tij ka edhe ndërtesa tjera. Edhe pse konsiderohet pir i tarikatit bektashian ai nuk i ka vendosur principet e këtij terikati, por një dervish tjetër me emrin Ballëm Sulltan, i cili njëkohësisht ka ndërtuar edhe kompleksin e Teqesë së Haxhi Bektashit.[71]

Veprat e Haxhi Bektash Veliut

Haxhi Bektash Veliu ka disa vepra me rëndësi të cilat na e bëjnë të mundur që qartë të shohim dhe kuptojmë botëkuptimin e tij, rrugën dhe karakteristikat e saja të trasuara nga ana e themeluesit të këtij tarikati.[72]

Veprat më kryesore të tija janë:

71 Kamusu'l-Alam. Shemsettin Sami, Istanbul 1306\1889, II,1332.

72 Viteve të fundit janë bërë vështrime kritike dhe vlerësime të disa veprave të Haxhi Bektash Veliut, p.sh.: Makalat, botimi i Esad Cosanit; Noyan Bedri, Bektasilik Alevilik Nedir? dhe Haxhi Bektash-i Veli nin Manzum Vilayetnamesi etj.

1. MAKALAT- Padyshim është vepra më voluminoze dhe më e njohur e Haxhi Bektash Veliut. Vepra është shkruar në gjuhën arabe. Prof. Dr. Esad Xhoshani dorëshkrimin arab e ka krahasuar me përkthimin në turqisht dhe në vitin 1971 e ka botuar një vështrim kritik (tahkik) të kësaj vepre. Makalat'i ka shumë përkthime në turqisht. Në vitin812\1409 Makalatin në formë poezie e ka përkthyer Muhammed Hatiboglu, kurse në prozë Molla Sadeddini.[73] Paskësaj është përkthyer dhe botuar edhe disa herë.

Sa për të ilustruar çështjet e përpunuara në Makalat dhe botëkuptimin e Haxhi Bektash Veliut do të prezentoj disa pjesë prej këtij libri pa ndërhyrë në komentin e tyre:
Në kapitullin e parë të Makalat'it Haxhi Bektash Veliu bën fjalë për proçesin e krijimit të njeriut. Sipas tij All-llahu njerëzit i ka krijuar prej katër elementeve, pastaj i ka shpërndarë në katër grupe të posaçme (abid, zahid, arif dhe muhip). Secili grup prej tyre ka ibadetet, dëshirat dhe gjendjet e veta të posaçme.

Kapitulli i dytë: Ky kapitull sqaron origjinën e marifetit (njohjes). Ai, më i ngrituri (Haxhi Bektashi Veliu) thotë:

Robi i afrohet Zotit të Lartmadhëruar nëpërmjet të 40 makamave (pozitave). Dhjetë prej tyre janë sheriat, dhjetë tarikat, dhjetë marifet dhe dhjetë hakikat.

Makami i parë i sheriatit, thotë Haxhi Bektash Veliu, është imani (besimi). Kushtet e besimit janë gjashtë: besimi në All-llahun, melekët e tij, librat e tij, pejgamberët e tij, ditën e ahiretit dhe caktimin e All-llahut xh.sh.

Kapitulli i tretë: Ky kapitull sqaron makamet e sheriatit.

Makami i parë i sheriatit është Imani (besimi). Në Kur'an thuhet: "O ju që besuat ( Kur'an 5\9)

73 Shih: Makalat, Esad Cosan, fq.XLII-LII.

Makami i dytë është mësimi dijes: "Bëhuni rob të Zotit ( Kur'an 3\79)

Makami i tretë është falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i Ramazanit, ai që ka mundësi të shkojë në haxhxh, në momentet e luftës të shkohet në luftë dhe pastrimi prej papastërtisë".

1. KITABU'L-FEVAID.- është një përmbledhje e fjalëve të urta dhe mësimeve të transmetuara nga Haxhi Bektash Veliu. Është shkruar në persisht. Dorëshkrimi i cili është gjetur në Bibliotekën Universitare të Stambollit është përkthyer në turqisht në vitin 1959 me titull: "Hazreti Hunkar Haxhi Bektash-i Velinin Vasiyetnamesi (Kitabu'l-Fevaid). Istanbul 1959.

2. SHATHIJJE.-[74] Ky traktat, i cili përbëhet prej dy faqeve, në vitin 1680 është komentuar nga ana e një shkrimtari prej tarikatit nakshibendi me pseudonim Enveriu me titull: "Tuhfetu's-Salikin".[75]

3. SHERH-I BESMELE.- Një numër i madh i sufijve ka bërë komentin dhe ka prezentuar urtitë e motos: "Bismil-lahirrahmanirrahim". Edhe Haxhi Bektash Veliu ka një koment të besmeles. Dorëshkrimi gjendet në bibliotekën e Manisës në numrin rendor 3536. Ky traktat i cili ka 57 faqe është botuar nga ana e Ryshty Shardagit.Në këtë vepër të vogël Haxhi Bektash Veliu flet për vlerën e përmendjes së fjalëve All-llah, Rrahman dhe Rrahim në fillim të çdo pune. Sa për ilustrim do të prezentoj disa fjali prej këtij traktati:

"All-llahu Xhel-leshanuhu i thotë Pejgamberit: O Muhammed, nëse besimtarët më ftojnë Mua në shtëpitë

---

74 Shath ose Shathijjat- janë fjalët të cilat i thonë sufijtë në momentet e ekstazës. Si p.sh. thënia e Hal-laxhit.

75 Golpinarli, "Bektash", Enciklopedia Turke, fq.33; Makalat, Esad Cosan, XL-XLI.

e tyre, nëse më gostitin edhe unë do t'i gostis ata. Nëse ata mua ma tregojnë pasqyrën e zemrës së tyre edhe unë e ngre perden dhe ua tregoj xhemalin-bukurinë Time. Pejgamberi a.s. i thotë: O Zot, Ti as han e as pin, në çfarë mënyre të të gostisin. Zoti i Madhërishëm i përgjigjet: O i dashuri im, thuaju besimtarëve që zemrën e tyre ta mbushin me modesti dhe dashuri. Lakmia, kopracia, fëlliqësia, tradhtia, zilia dhe mrrolja le të mos ketë vend në zemrën e tyre…"[76]

Përveç veprave të sipërpërmendura ka edhe disa vepra për të cilat me siguri nuk dihet se janë të Haxhi Bektash Veliut ose të ndonjë dervishi bektashian të mëvonshëm. Bëhet fjalë për veprat: Komenti i Sures Fatiha, Makalat-i Gajbijje ve Kelimat-i Ajnijje, Hurde-Name dhe Ussu'l-Hakika.

### Botëkuptimet e Haxhi Bektash Veliut

Një numër i konsiderueshëm i hulumtuesve të vonshëm të tarikatit bektashian, posaçërisht orientalistët perëndimorë janë munduar që Haxhi Bektash Veliun ta prezentojnë si një sufi i cili ka qenë i lidhur ngushtë me babaijtë, batinijtë dhe shiitët. Njëkohësisht, duke u bazuar në literaturën e vonshme bektashiane ose për shkak të keqkuptimit të simboleve të poezisë klasike apo është bërë me ndonjë prapavijë, është plasuar teza se në tarikatin bektashian namazi, agjërimi, zeqati refuzohet, kurse bazë janë dashuria dhe mirësia.

Një vlerësim i tillë , kur të merren parasysh veprat kryesore të Haxhi Bektash Veliut, është i pamundshëm. Veprat dhe mendimet e tija tregojnë qartë se ai është një

76 Noyan Bedri, Po aty, fq. 41.

sufi me karakteristika të shekullit të XIII në Anadoli, i cili ka qenë i inspiruar prej të njëjtit burim si edhe Nexhmuddin Daje, Mevlana Xhelaluddin Rumiu, Evhaduddin Kirmani, Junus Emre etj. Për dallim nga të sipërpërmendurit Haxhi Bektash Veliu si edhe Junus Emreja kanë shkruar dhe folur në gjuhën e popullit dhe gjithnjë kanë pasur parasysh rrethanat socio-politike të banorëve të vendeve periferike. Por është fakt se ky person i lartë-për jetën e të cilit ka shumë pak argumente decide- është keqpërdorur edhe nga fuqitë destabilizuese të kohës së vet por edhe nga rrymat armiqësisht të disponuara ndaj shoqërisë islame prej fillimit të shekullit XIX e këndej.

Propagandistët batini të shekullit XIV, për të shpëtuar prej ndjekjeve të Shtetit Osman, janë inkuadruar në teqetë bektashiane dhe vende-vende që prej atëherë kanë arritur që të devijojnë në çështje me rëndësi prej mësimeve të pastra të Haxhi Bektash Veliut.

Ndërsa Haxhi Bektash Veliu dhe ithtatët e vërtetë të tij kanë qenë njerëz me besim të sinqertë, të cilët për udhërrëfyes e kanë pranuar Muhammedin a.s., kurse jetën e tyre e kanë formësuar në bazë të kallëpeve të devotshmërisë së Hazreti Aliut r.a.

Themeluesi i një tarikati të madh, ithtarët e të cilit kanë pasur mbështetjen e plotë të Shtetit Osman deri në shekullin e XIX assesi nuk mund të paramendohet se kanë qenë larg themeleve të Fesë Islame.

Më lartë prezentuam disa fragmente prej veprës kryesore të tij dhe pamë se ai në mënyrë mjaft të qartë këshillon se rruga e tarikatit doemos kalon nëpër fushat e sheriatit. Jo vetëm në tarikatin bektashian por edhe në të gjitha tarikatet tjera, në poezinë sufite sheriati dhe tarikati janë prezentuar krahas njëri-tjetrit dhe asnjëherë nuk janë

ndarë. Personi i cili dëshiron të lidhet për një tarikat- pa marrë parasysh cilin- piksëpari duhet të ketë njohuri për ibadetet, gjegjësisht për praktikën fetare; të praktikojë ato plotësisht  në jetën e tij, kështu që të plotësohet pozita e parë e tij sheriati, e pastaj të kalojë në pozitën e dytë tarikatin, që është një pozitë të cilës nuk i bëhet propagandë, por hyhet me prezencën e ndjenjave shpirtërore të larta, inspirimin, ëndërrën etj. Pozita e tretë është marifeti, gjegjësisht njohja e disa vlerave të larta metafizike, në të cilat nuk mund të arrijë çdo njeri. Kjo pozitë arrihet vetëm me shtimin e ibadeteve dhe përmendjen e pandërprerë të All-llahut xh.sh. Hakikati është pozita e fundit ku njeriu ndjen një kënaqësi të jashtëzakonshme dhe në horizont nuk sheh asfarë ekzistence absolute tjetër përveç All-llahut xh.sh.. Kalimi prej një pozite në tjetrën nuk e çliron njeriun prej obligimeve të pozitës së mëparshme, prandaj edhe ai i cili është në pozitën më të lartë është i obliguar të falë namazin, të agjërojë Ramazanin, të japë zeqatin e kështu me rradhë.

Ja pra, këto janë katër momentet të cilat Haxhi Bektash Veliu në Makalatin e tij i prezenton si katër dyer : sheriati-tarikati-hakikati-marifeti.

E njëjta filozofi është prezente edhe në rregullat dhe kondítat bektashiane të mëvonshme. P.sh. personi i cili përgatitet për të hyrë në tarikatin bektashian (talib) gjatë ceremonialit të pranimit (Ikrar Ajini) merret prej qendrës së dhomës (dar) dhe në çdo katër hapa drejt myrshidit[77] me rend i thotë këto fjalë:

– Es-Selamu Alejkum, o të ndritur të sheriatit!

– Es-Selamu Alejkum, o udhëheqës të tarikatit!

– Es-Selamu Alejkum, o të përsosur të marifetit!

77 Udhëheqës shpirtëror, i pari një tarikati ose i një teqeje.

– Es-Selamu Alejkum, o sulltanë të hakikatit![78]

Haxhi Bektash Veliu është njëri prej tre gjigantëve të cilët në shekullin XIII kanë arritur të stabilizojnë Anadolinë e atëhershme të rraskapitur në të katër anët.Ai së bashku me Junus Emre'n dhe Mevlana Xhelaluddin Rumi'un kanë gjetur pikat e përbashkëta të mendimeve kundërshtare mes popullatës multietnike dhe me botëkuptime të ndryshme. Mevlana në një dyvargësh thotë:

"Jeta është e mundshme me pajtimin e kontrasteve
Ndërsa me përleshjen e tyre vjen vdekja".

Domethënë, në momentin kur përleshen kontrastet, ballafaqohen fuqitë dhe paraqitet lufta. Në këtë përleshje shoqëria shkatërrohet në tërësi dhe nuk ka asfarë progresi. Por, nëse këto kontraste bashkohen dhe nëse kundërshtimet jetësohen në paqë, atëherë del në pah një jetë e lumtur dhe e harmonishme.

Haxhi Bektash Veliu është një person i lartë i cili ka qenë kundër konfrontimeve në mendime. Ai duke mos e shikuar mendimin e njerëzve, ka depërtuar në zemrat e tyre , e ka përfituar dhe e ka pastruar shpirtin e tyre.

Siç përmendëm edhe më lartë, Haxhi Bektash Veliu në "Makalat"-in e tij thotë që sheriati-tarikati-marifeti dhe hakikati kanë nga dhjetë makame (pozita). Këtu nuk kemi mundësi që t'i prezentojmë të gjitha, por do të ndalemi në disa karakteristika me rëndësi të posaçme në mësimet dhe botëkuptimet e tij.

Ai gjatë sqarimit të këtyre makameve thotë kështu: i pari prej tyre është imani (besimi), kurse i dyti ameli (puna) gjegjësisht dituria. Imani, thotë Haxhi Bektash Veliu, është respekt dhe nënshtrim i plotë në All-llahun xh.sh.. Ai duke përcaktuar themelet e besimit islam, pas secilit prej tyre

78 Figlali, po aty, fq.167.

sjell nga një konkluzë morale, respektivisht thotë që një njeri nëse në diçka beson, atëherë besimin e tij duhet ta praktikojë në jetën e përditshme si dhe sjelljet e tija të jenë sipas normave morale të mënyrës së besimit të vet.

Ja se si vetë Haxhi Bektash Veliu, në fjalët e tija, e shpreh këtë realitet: " Besimi në Zotin e Madh është iman, por edhe përmbajtja në principet e këtij besimi dhe largimi prej asaj për të cilën ka thënë që është e ndaluar është iman. Mosrespekti i urdhërave të Zotit të Madh dhe mos-largimi prej ndalesave të Tija është mosbesim".[79]

Edhe besimi në melekët (engjujt) në botëkuptimin e Haxhi Bektash Veliut është shprehë me të njëjtën masë. Ai thotë: "Dhe besimi në melekët e Zotit është iman. Pra, tash, o shok i nderuar, çdo person ka 360 melekë. Si ke mundësi që para 360 melekëve të tregosh paedukatë, kurse këtë poshtërsi nuk e tregon para njerëzve të cilët janë si ti. Atëherë çfarë besimi në melekët është ky".[80]

Domethënë që besimi automatikisht neve na obligon edhe në pikëpamje morale. Haxhi Bektash Veliu thotë që e ke të domosdoshme të jetosh ashtu si beson. Me këtë ai orvatet që në brendinë e njeriut të vendosë një sistem të vetëkontrolit. Duke e vendosur njeriun në mesin e 360 melekëve, kërkon prej tij që pandërprerë të kontrollojë sjelljet dhe lëvizjet e tija.

---

79 "Pes, imdi Çalap Tanriya inanmak imandur ve buyrugun tutmak dahi imandir ve "glin" dedugunden yiglanmak (sakinmak) imandir. Pes, Tanri Tebareke ve Teala buyurdugun tutmayip yiglin dediginden yiglanmamak Tanriza inanmamaktir". Shih: Esad Coshan Makalat-I Haci- Bektas-I Veli, fq.11, Ankara 1990.

80 "Ve Tanrinin Feristelerine (melek) inanmak imandir. Pes imdi aziz-i men, her bir kisiye 360 feriste muvekkeldir. Pes bunca feristenin arasinda edebsizlik edersun ve senin gibi kisi katinda edebsuzluk etmezsin, hani feristelere inandigin". Shih: Po aty, fq. 12.

Në lidhje me besimin në librat e shpallura Haxhi Bektash Veliu thotë: "Pastaj besimi në Kur'anin dhe librat tjera të Zotit është iman. Brendia yte është plotë krenari, zili, kopraci, egoizëm, hidhërim, përgojim dhe maskarallëk. Mirë i dahuri im! Cili libër urdhëron që njëri prej këtyre veseve të këqija të jetë në brendinë e njeriut. Ku është besimi yt në librat dhe lajmet e tyre"?[81]

Haxhi Bektash Veliu pohon se një besimtar ose një dervish nuk ka mundësi që t'u besojë librave të dërguara prej All-llahut xh.sh. dhe në brendinë e tij të ekzitojë kryelartësia, zilia, kopracia ose veset tjera të liga. Fjalë identike me të mësipërmet Hynkari thotë edhe për besimin në Pejgamberët e Zotit, ndërsa për besimin në ahiretin thotë kështu:

"Pastaj o ju besimtarë, besimi në kijametin nuk është kështu siç jeni duke besuar ju. Ju çkado që të gjeni – pa pyetur është hallall ose haram- e veshni dhe furnizoheni. Shfrytëzoni begatitë me pa të drejtë. Ky është besim vallë, kujt i besoni ju? Çfarë besimi është ky?" [82]

Në fjalët e mësipërme Haxhi Bektash Veliu në mënyrë mjaftë të qartë thotë që nëse besoni në ditën e llogarisë atëherë mos hani e mos pini haram, mos bëni padrejtësi, përndryshe besimi i juaj në ahiretin nuk është asgjë.

Prej mendimeve të lartëpërmendura kuptohet qartë se Haxhi Bektash Veliu beson në pandashmërinë e besimit

81 "Pes, Tanrinin Kur'anina ve kitaplarina inanmak imandir… Pes, imdi için dolu kibir ve haset ve pehillik ve tamah ve ofke ve giybet ve maskarallik. Pes imdi aziz-i men hangi kitapta buyurur ki bunlarin birisi iman ehlunun içinde ola, hani kitaplarina ve hani haberlerine inandigin…? Shih : Po aty.

82 "Pes ey muminler, kiyamete inanmak boyle degill kim siz inanirsiz, zira ki her ne bulursaniz haramdan ve halaldan gizersiniz ve donanirsiz, haksiz yerde nimetler yiyip gonenursuz, yani is bu inanmak midur, kimsiz inanursuz? Bu nasil inançtir". Shih: Po aty.

dhe veprimtarisë pozitive fetare dhe prej ithtarëve të vet kërkon që besimi i tyre të reflektohet në përditshmërinë e jetës . Ai nuk pranon asnjë mangësi në 40 makamet të cilat i përmendën. Pra, këtë tërësi e kërkon në besim, praktikë fetare dhe në moral. Ja si thotë: " Një person nëse deklaron besimin me gojë, por nuk beson me zemër, nuk e jep zeqatin, ose ka mundësi por nuk shkon në haxhxh, ose një prej vendimeve të Zotit e sheh si të pavënd, ose nëse e mohon Muhammed Mustafa'në, ose e sheh të padrejtë njërin prej sahabeve (shokëve të Pejgamberit) atëherë është i humbur". [83]

Me një fjalë Haxhi Bektash Veliu anën e brendshme dhe të jashtme të njeriut e sheh si një tërësi dhe virtytshmërinë njerëzore e sheh në bashkimin e këndeve të trekëndëshit të lumturisë: besim- vepër- sjellje. Një sufi i tillë, në botëkuptimet e të cilit ekzistojnë karakteristikat parësore të fesë dhe Sheriatit Islam, të vlerësohet jashtë kornizave të Islamit dhe Tesavvufit është gabim i madh shkencor.

## PERIUDHA E BALLËM SULLTANIT

Haxhi Bektash Veliu botëkuptimet e veta sufite i kultivoi në rrethinën e Kërshehirit të sotshëm (Suluxha Karahoyuk), ku edhe rreth vetes tuboi një numër të konsiderueshëm të ithtarëve. Mirëpo, në të njëjtën kohë në mesin e ithtarëve të tij hyrën edhe dervishët babai, hajdari dhe kalenderi, të cilët në botëkuptimet e tyre sufite kishin elemente të

83 "Biregu diliyle iman goturse ve gonluyle inanmazsa veya zekat tam vermezse, veyahud hacca varir iken yoldan geri donse veyahud Tanri Teala hukumlerinden birini batil tutsa veyahud Muhammed Mustafaya inkar ile baksa Muhammedin sahabelerin birini nahak bilse isledigi amelleri hebaen mensura olur". Shih: Makalat , Po aty.

skajshme ezoterike që nuk përputhen aspak me mësimet islame.

Ky realitet do të ndikojë dukshëm në devijimin e disa grupeve bektashiane në periudhën e mëvonshme.[84] Për shkak të mosekzistimit të dokumenteve të përpikta historike edhe periudha pas Haxhi Bektash Veliut nuk është e qartë aq sa duhet. Një numër i madh dhe i rëndësishëm i dokumenteve dhe trakteve bektashiane është humbur dhe shkatëruar pas ndërprerjes së punës aktive të teqeve bektashiane në vitin 1826 nga ana e Sulltan Mahmudit II dhe ngritjes së formacionit jeniçer prej ushtrisë osmane.

Duke filluar prej viteve të para të shekullit XIV tarikati bektashian është në lidhje të ngushtë me ushtrinë osmane,madje një numër i konsiderueshëm i dervishëve bektashi para ushtrisë osmane është vendosur në vendet në të cilat më vonë do të niset ushtria osmane dhe kanë përgatitur terenin për islamizimin e këtyre vendeve; shkurtë thënë: kanë përfituar zemrat e njerëzve.

Mes periudhës së dy gjigantëve të Tarikatit Bektashian, Haxhi Bektash Veliut dhe Ballëm Sulltanit, Vilajet-Name't flasin për aktivitetet e disa personalieteve të shquara të cilët kanë ndikuar në islamizimin e Anadolisë dhe vendeve Ballkanike.

---

84 Njëri prej studjuesve më të shquar të sufizmit margjinal në Turqi Ahmet Yasar Ocaku në veprën e tij " Osmanli Imparatorlugunda Marjinal Sufilik, Kalenderiler" pohon se Haxhi Bektash Veliu është një shejh Hajdari-Vefai i cili ka jetuar në shekullin XIII. Ky vlerësim i Prof. Ocakut bazohet në praninë e elementeve margjinale në praktikën bektashiane, në të cilat dukshëm kanë ndikuar rrymat margjinale sufike-kalenderijtë, vefaijtë dhe hajdarijtë- mirëpo vetë Haxhi Bektash Veliu është sufi i cili ka pi ujë prej burimit jesevian dhe ky botëkuptim ka vazhduar një kohë të gjatë në mesin e bektashinjve, lirisht mund të themi deri në fillim të shekullit të XIX.

Ata janë: Sejjid Xhemal Sulltani, Saru Ismail Sulltani, Haxhëm Sulltani, Resul Baba, Pirab Sulltani, Tapduk Emre, Ibrahim Haxhiu, Xhem Baba, Huj ata dhe Sari Salltëk Baba. S'ka dyshim se më i shquari në mesin e këtyre personaliteteve është Sari Salltëk Baba, për të cilin bëjnë fjalë shumë legjenda si në Turqi ashtu edhe në viset e tjera të Ballkanit.

Sari Salltëk baba[85] është një misionar islam i cili ka ardhur në Ballkan para ushtrisë osmane. Sipas një dyvargëshi ai në Ballkan ka ardhë në vitin 662\ 1263.[86]

Për fat të keq, për jetën dhe veprën e këtij misionari të madh musliman nuk kemi asfarë dokumenti të shkruar historik, por e gjithë ajo që dihet rreth personalitetit të Sari Salltëkut është marrë prej legjendave. Aktivitetin e tij e argumentojnë edhe tyrbet e tija në disa vende të Ballkanit të sotshëm.[87]

Çështja e trashëgimit të postit të zbrazur me kalimin në ahiret të Haxhi Bektash Veliut – siç u përmend më lartë- është problemi themelor i ndarjes së bektashive në dy grupe kryesore, edhe atë: Dedebaba (Babagan) dhe Çelebi.

Grupi i Dedebaballarëve pohon se Haxhi Bektash Veliu nuk është martuar dhe se bijtë e lindur prej Kadënxhëk Anës janë bij të rrugës, madje thonë se pas Haxhi Bektash Veliut në post është ulur i biri i Idris Hoxhës Hëzër

85 Emri i vërtetë i tij sipas Evlija Çelebi'ut është Mehmed Buhari, ndërsa sipas Salltëkname's Sherif Hëzër. Shih: Sejahatname, Istanbul 131, I.659; Salltëkname, Istanbul Topkapi Saraji Muzesi, Hazine kutuphanesi No 1612, v.2\a.

86 "Sari Salltuk uburu Rumeline Altiyuz altmis iki idi heman". Shih: Ixhmali ahvali Ali Selçuk ber mucibi nakli Oguzname i Seyyid Lokman.

87 Aktiviteti i Sari Salltëkut në islamizimin e viseve Ballkanike do të prezentohet në pjesën ku flitet për depërtimin e tarikatit bektashian në Ballkan dhe rolit të tij në islamizimin e këtyre vendeve. Këtu u përmend vetëm për t'i ngelë besnik kronologjisë së ngjarjeve.

Baliu, pas tij Resul Baliu, Mursel Baliu dhe pas tij Ballëm Sulltani, i cili nuk është martuar (myxherred). Pas Ballëm Sulltanit një rrymë ka vazhduar nëpërmjet të vëllaut të tij Kalender'it, kurse në post pas tij është ulur Haxhi Iskender Dedeu, Emir Kasim Dedeu, Hudadadi biri i Mahmudit dhe pas tij në vitet 1551-1569 postnishin në qendrën bektashiane ka qenë Sersem Ali Baba.[88]

Ndërsa sipas Çelebinjëve Haxhi Bektash Veliu është martuar me Kadënxhëk Anën dhe djali i tyre Sejjid Ali Sulltani (1310-1402) është ulur në post pas tij. Sejjid Ali Sulltani ka pasë dy djem, Resul Baliun dhe Mursel Baliun.

88 Dedebaballarët të cilët u ulën në postin e qendrës bektashiane pas Sersem Ali Dedebabës janë:
- Haxhi Ahmed Ali Dedeu 977(1569)–977(1569) 1 vit.
- Ak Abdullah Baba prej Dimetoke 977(1569) – 1005( 1596) 27 vjet.
- Karar Halil Baba prej Dimetoke 1005(1596) – 1038( 1628) 33 vjet.
- Haxhi Vahdeti Baba prej Dimetoke 1038(1628)- 1060(1649) 22 vjet.
- Haxhi Sejjid Mustafa Dedebaba 1060(1649) – 1086(1675) 26 vjet.
- Sejjid Ibrahim Agahi Dedebaba 1986(1675)- 1101( 1689) 15 vjet.
- Sejjid Halil Ibrahim Dedebaba prej Urfe 1101(1689)- 1127(1714) 26 vjet.
- Haxhi Hasan Dedebaba prej Serezi 1127( 1714)-1149(1736)22 vjet.
- Hanzade Mehmeti prej Krimi 1149(1736)- 1173 (1759) 24 vjet.
- Sejjid Kara Ali Dedebaba prej Dimetoke 1173( 1759)- 1198(1783) 25 vjet.
- Sejjid Hasan Dedebaba prej Sinopi 1198(1783) – 1205(1790) 7 vjet.
- Haxhi Mehmet Nuri Baba prej Horasani 1205( 1790)- 1214(1799) 9 vjet.
- Sejjid Halil Hakli Dedebaba 1214(1799) – 1229(1813) 15 vjet.
- Mehmet Nebi Dedebaba prej Sivasi 1229(1813)- 1250(1834) 21 vjet.
- Haxhi Ibrahim Dedebaba prej Merzifoni 1250(1834)- 1251(1835) 1 vit.
- Sejjid Haxhi Mahmud Dedebaba prej Vidini 1251(1835)-1265(1846)12 vjet.
- Saatçi Ali Baba prej Sofje 1263(1846)-1265(1848) 2 vjet.
- Sejjid Hasan Dedebaba prej Çorumi 1265(1848)-1266 (1849) 1 vit.
- Haxhi Ali Turabi Dedebaba 1266(1849)-1285(1868) 19 vjet.
- Haxhi Hasan Dedebaba prej Selaniki 1285( 1868)-1291 (1874) 6 vjet.
- Perishan Hafiz Ali Dedebaba prej Konje 1291(1874)- 1297(1879) 6 vjet.
- Haxhi Mehmet Ali Hilmi Dedebaba 1297(1879)- 1325 (1904) 25 vjet.
- Haxhi Mehmet Dedebaba prej Malatje – Pas kalimit të Mehmet Ali Hilmi Dedebabës në Stanboll Haxhi Mehmet Baba prej Malatje ka qëndruar si ushtrues detyre në postin e teqes deri në vitin 1315(1897).
- Haxhi Fejzullah Dedebaba 1315(1897)- 1322-1904 si ushtrues detyre dhe prej vitit 1322(1904)- 1331(1913) si postnishin i qendrës bektashiane.
- Salih Nijazi Dedebaba 1331(1913)- 1941 28 vjet.

Më gjerësisht shih Nojan .B. Po aty. Fq. 53.

Resul Baliu është bërë postnishin në teqenë bektashiane në Kërshehir pas babait të vet, kurse Mursel Baliu ka vazhduar aktivitetet në teqenë e themeluar nga babai tij dhe që ende e ka atë emër, Sejjid Ali Sulltan në Dimetokë. Pas kalimit në ahiret të Resul Baliut, në post është ulur Mursel Baliu, pas tij i biri i tij Ballëm Sulltani dhe kështu ka vazhduar prej babës në djalin.[89]

Ballëm Sulltani i cili ka jetuar përafërsisht dy shekuj pas Haxhi Bektash Veliut ka merita të mëdha në institucionalizimin dhe formësimin e tarikatit bektashian, prandaj

---

89 Sipas Çelebinjëve në postin e teqesë kryesore bektashiane pas Haxhi Bektash Veliut janë ulë këto persona:

| | L. V. |
|---|---|
| - Sejjid Ali Sulltan | 1310-1402 |
| - Resul Bali | 1361-1441 |
| - Mursel Bali | 1384-1483 |
| - Ballëm Sulltani | 1473-1516 |
| - Kalender Çelebiu | 1476-1528 |
| - Iskender Çelebiu | 1512-1548 |
| - Jusuf Bali Çelebi | 1516-1569 |
| - Bektash Çelebi | 1544-1581 |
| - Resul Bali Çelebi | 1546-1588 |
| - Iskender Mursel Çelebi | 1551-1604 |
| - Hasan Çelebi | 1563-1607 |
| - Bektash Çelebi | 1566-1632 |
| - Kasëm Çelebi | 1578-1646 |
| - Jusuf Çelebi | 1582-1656 |
| - Haxhi Zulfiqar Çelebi | 1605-1667 |
| - Abdulkadir Çelebi | 1628-1685 |
| - Murtaza Ali Çelebi | 1646-1730 |
| - Haxhi Fejzullah Çelebi | 1711-1759 |
| - Bektash Çelebi | 1710-1761 |
| - Abdul-latif Çelebi | 1724-1803 |
| - Shehid Fejzullah Çelebi | 1742-1824 |
| - Mehmed Hamdullah Çelebi | 1767-1836 |
| - Velijeddin Çelebi | 1808-1871 |
| - Fejzullah Çelebi | 1862-1921 |
| - Velijettin Çelebi | 1867-1940 |
| - Ali Xhelalettin Ulusoj Çelebi 1922- | |

Më gjerësisht shih: Ulusoj Xh. Hunkar Haci Bektas Veli ve Alevi-Bektasi Yolu, 83-104.

edhe në traditën bektashiane konsiderohet si Pir-i Thani (Piri i Dytë).

Ballëm Sulltani – në bazë të pohimeve të dy grupeve kryesore të tarikatit bektashian – është i biri i Mursel Baliut, djalit të Sejjid Ali Sulltanit.

Sipas një legjende, kur Sejjid Ali Sulltani erdhi në Dimetokë, e bija e mbretit të atëhershëm bulgar kishte qendisur një sexhade, e kishte varë në mur dhe kishte thënë që kush do të lutet mbi të, me atë do të martohej. Sejjid Ali Sulltani dhe Mursel Baliu një ditë e kanë vizituar shtëpinë e tyre dhe pa kërkuar leje e kanë marrë sexhaden dhe janë falë mbi te. Por, pasi që të dy ishin mjaft të moshuar, vajza e hoq sexhaden dhe të dy u rrëzuan poshtë. Atëherë Sejjid Ali Sulltani kuptoi se kjo fuqi vinte prej djalit të cilin ajo do ta lindte, Ballëm Sulltanit. Gishtat e Mursel Baliut prodhonin mjaltë, ai e zgjati dorën në gojën e vajzës, e cila hëngri prej mjaltës së gishtave të tij dhe mbeti shtatzënë dhe prej saj lindi Ballëm Sulltani. Pasi që i vdiq nëna, Ballëm Sulltani kaloi në Teqenë e Sejjid Ali Sulltanit në Dimetokë. Këtu qëndroi deri në moshën 18 vjeçare në një dhomë e cila edhe sot e mbanë emrin "Mësojtoreja e Ballëm Sulltanit".[90]

Në vitin 1499 Sulltan Bajezidi II e ka thirë Ballëm Sulltanin në Stamboll dhe me urdhërin e tij është bërë postnishin në Teqenë Bektashiane në Kërshehir.

Piri i dytë i bektashive Ballëm Sulltani ka bërë disa ndryshime në mënyrën e aplikimit të riteve dhe erkanit bektashi; e ka sistematizuar dhe disiplinuar organizimin e teqeve dhe ka formuar grupin e myxherredëve (të pamar-

90 J.K. Birge, Po aty. fq. 64; Lideri i Çelebinjëve të sotëm z. Xhelaleddin Ulusoji pohon se Ballëm Sulltani është një djalë hungarez ose serb i cili është munduar ta prishë tarikatin bektashian dhe të përçajë bektashinjtë. Shih: E.R. Figlali, Po aty, fq. 198.

tuarit) të cilët tërë jetën e tyre do t'ia kushtonin tarikatit. Pas Ballëm Sulltanit tarikati bektashian me bekimin e Portës së Lartë (Bab-i Ali) me të madhe është përhapë në Anadoli dhe Ballkan. Prej kësaj kohe jeniçerët janë inkuadruar në teqenë bektashiane.[91]

Paraqitja dhe prezenca e propagandave margjinale sufite (hurufi) në Anadoli kah fundi i shekullit XVI do të ndikojë edhe në mësimet e tarikatit bektashian. Këto ideologji me themele joislame do të ndikojnë që bektashinjtë dalëngadalë të largohen prej mësimeve të Haxhi Bektash Veliut. Si rezultat i kësaj, në vitin 1826 do të suspendohet formacioni jeniçer prej ushtrisë osmane dhe me një ferman[92] të Sulltan Mahmud'it të Dytë në vitin 1827 do të mbyllen teqetë bektashiane. Vendin e bektashive në ushtri do ta marrin mevlevijtë.

Tarikati bektashian prej vitit 1827 e deri në vitin 1925 ka vepruar në formë gjysëmilegale, me përjashtim të periudhës së Abdulhamitit, i cili ka qenë mjaft i afërt me grupin e dedebaballarëve. Veprimi i plotë ilegal i bektashive dhe mbyllja e Kryegjyshatës, gjegjësisht Teqesë së

91 Edhe pse argumentet historike e argumentojnë të kundërtën, një grup i hulumtuesve mundohen që formimin e rendit jeniçer ta lidhin me Haxhi Bektash Veliun. Mirëpo kjo historikisht është e pamundur. Rendi jeniçer është inkuadruar në teqenë bektashiane ose anasjelltas në kohën e Ballëm Sulltanit. Shih Figlali, Po aty. fq.154.

92 "Bekta[ë Tekkelerënën türbe mahalleri hariç, bütün binalarën zëkëlmasë, e[za ve emlak ve musakkafatlarën ëstërdadë ile devlete gelir kaydedilmesi ve bu tarihteki Bekta[i lëderi Hamdi Bin Feyzullahën fesadi beldeye bais oldugundanö Amasyaya sgrggn edilmesi kararla[tërëlmë[tër.
"Të rënohen të gjitha teqetë bektashiane, përveç tyrbeve. Mallrat, pasuritë, ndërtesat të konfiskohen dhe të përdoren në të mirë të shtetit. Lideri i tashëm i bektashive Hamdi B. Fejzullahi pasi është shkaktar i trazirave në popullatë, të internohet në Amasja. Shih Ulusoy Celalettin, po aty. fq. 92.

Haxhi Bektash Veliut fillon prej vitit 1925. Në këtë vit Parlamenti Kombëtar i Turqisë sjell vendim për mbylljen e të gjitha teqeve dhe tarikateve në territorin e Turqisë. Atëherë Kryegjyshi Bektashian Salih Nijazi Dedeu (me origjinë shqiptare) kaloi në Shqipëri dhe me ndihmën e shtetit të atëhershëm dhe mbretit vazhdoi aktivitetin e tij në Shqipëri.[93]

## DEPËRTIMI I TARIKATIT BEKTASHIAN NË VISET TONA DHE ROLI I TIJ NË ISLAMIZIMIN E POPULLATËS

Teqetë dhe tarikatet kanë lozur rol të rëndësishëm në depërtimin dhe vendosjen e Fesë Islame në viset ballkanike. Viset ballkanike para depërtimit të ushtrisë osmane janë çliruar nga ana e misionarëve, shumica e të cilëve kanë qenë pjesëtarë të një tarikati të caktuar. Këta misionarë kanë rahatuar në pikpamje psikologjike popullatën e

93 Emigrimi i Salih Nijazi Dedeut prej Turqisë në Shqipëri është bërë shkak për mosmarrëveshje mes bektashive të Turqisë dhe Shqipërisë. Sipas bektashinjve të Turqisë Salih Nijazi Dedeu kur niset për në Shqipëri në vend të vet zëvendës e lë Ali Naxhi Bajkall'in. Pas kalimit në ahiret në vitin 1960 vendin e tij e zë Salih Bedrettin Nojani. Salih Bedrettin Nojani kaloi në ahiret më O6. 01. 1997 dhe në 12.12 1997 pa prezencën e baballarëve shqiptarë kryegjysh I ri është zgjedhë Hajdar Erxhan Baba. Ndërsa shumica e baballarëve shqiptarë këtë nuk e pranojnë. Sipas tyre Salih Nijazi Dedeu nuk la zëvendës në Turqi dhe derisa Teqeja e Haxhi Bektashit nuk fillon me punën, Kryegjyshata do të qëndrojë në Shqipëri. Pas proçeseve demokratike në Shqipëri në postin e kryegjyshit bektashian, pa miratimin e bektashinjve të Turqisë, është ul halifeja e Bedri Nojanit, Baba Reshat Bardhi.

rraskapitur prej sundimeve të mëparshme dhe kanë përgatitur terrenin për ardhjen e osmanlinjve.

Bektashinjtë kanë qenë ndër bartësit kryesorë të aktiviteteve të lartëpërmendura, këtë e argumenton edhe numri i konsiderueshë i teqeve dhe tyrbeve bektashiane, të cilat edhe sot e kësaj dite ekzistojnë në shumë vende të Ballkanit.

Nëse pak më tepër thellohemi në analizën e nuansave të përditshmërisë së muslimanëve në Ballkan, qartë mund të vërejmë elementet sufite në ibadetet, sjelljet dhe botëkuptimet e tyre. Në veçanti përqëndrimi i sufijëve në dashurinë ndërnjerëzore,në kultivimin e tolerancës dhe vënia në shërbim të popullatës, pastaj pikëpamjet ekonomiko-sociale pa dallim feje, gjuhe dhe kombi, kanë ndikuar dukshëm në pranimin e Islamit nga ana e shqiptarëve dhe krishterëve tjerë të asaj kohe. Teqetë ishin të hapura për të gjithë njerëzit pa marrë parasysh cilës fe, komb ose gjuhë i takonin.

Njëkohësisht edhe vet Shteti Osman me të madhe ka ndihmuar veprimtarinë e këtyre sufive duke u mundësuar të bëjnë komplekse të ndryshme nëpërmjet të cilave ata kanë mundësuar afrimin e popullatës me administratën dhe udhëheqësinë shtetërore.

Tarikatet rol të rëndësishëm kanë luajtë edhe në islamizimin dhe ngritjen kulturore, shkencoe dhe artistike të shqiptarëve. Ata i kanë dhënë ngjyrë dhe ton të posaçëm atmosferës shoqëroro-politike dhe religjioze në viset tona.

Depërtimi i tarikatit bektashian në viset tona është bërë në dy mënyra kryesore:[94]

Mënyra e parë është nëpërmjet të dervishëve të hershëm bektashian në fillim të shekullit XIII para ardhjes së

94 F.W. Hasluck, Bektasi Tetkikleri( terc. Ragip Hulusi) Istanbul devlet Matbaasi, Istanbul 1928. fq. 85.

osmanlinjve. Këta dervishë janë vendosur në vende të ndryshme dhe duke u inkuadruar në rradhët e popullatës gjegjëse, kanë vënë themelet e proçesit të islamizimit të saj.[95]

Në krye të personaliteteve të tilla padyshim është Sari Salltëk'u të cilin e përmendëm më lartë. Sari Salltëku sa është përvetësuar nga ana e muslimanëve po aq është përvetësuar edhe na ana e të krishterëve, kështu që thuhet se varri i tij gjendet në shumë kisha anembanë reliefit ballkanik.

Sipas legjendës, Sari Salltëku është nxënës i Ahmed Jeseviut dhe shok i Haxhi Bektash Veliut . Ai së bashku me shtatëdhjetë dervishë tjerë është dërguar në Evropë. Në këtë udhëtim ai e ka vizituar Krimenë, Moskën dhe Poloninë. Para vdekjes ka lënë porosi që trupin t'ia venë në shtatë tabute (arkivole). Pasi shtatë mbretëri do të luftojnë për trupin e tij. Si ka thënë edhe është bërë. Secili mbret ka marrë nga një tabut dhe në secilin prej tyre ka pasë nga një trup të Sari Salltëkut.[96]

Përveç shtatë mbretërive (të atëhershme) për të cilat Hasluck'u thotë se kanë tabutin e Sari Salltëkut, supozohet se varri i tij gjendet edhe në manastirin e Shën Naumit në Ohër. Poashtu, një mal i cili gjendet 600 metra mbi Krujë në Shqipëri mban emrin e Sari Salltëkut. Në shpellën e cila

---

95 Kur them islamizimit kam për qëllim islamizimin masiv të popullatës në Ballkan, kurse raste individuale të prezencës së Islamit në viset tona hasen edhe para ardhjes së Osmanlinjëve. Më gjerë shih: Ibrahimi Nexhat, Islami në Trojet Iliro-Shqiptare Gjatë Shekujve. 1998 Shkup. fq. 179 e më tej.

96 Shtatë mbretëritë të cilat e posedojnë tabutin e Sari Salltëkut janë: Moska, Polonia, Bohemia, Suedia, Edreneja, Moldavija, Dobruxha. F.W. Hasluck, Anadolu ve Balkanlarda Bektasilik, Istanbul, 1995. fq. 155-56.

gjendet në këtë mal është Teqeja e Sari Salltëkut. Në hyrje të teqesë ka gjurmë të këmbëve, për të cilat supozohet se janë të Sari Salltëkut.[97]

Gjurmë të tilla janë dëshmuar edhe në vendin Guricaj në Radë pranë Durrësit edhe këto pranë teqeve kushtuar Sari Salltëkut. Gjurmë të ngjashme hasen edhe në periferi të Zgatarit të Opojës në vendin e quajtur Gjerman. Edhe në rrethinën e Pejës një vend e mban emrin Sari Salltëk.[98]

Duke marrë parasysh dashurinë dhe interesin që kanë pasë shqiptarët dhe popujt tjerë të Ballkanit për Sari Salltëkun shumica e tarikateve të cilat ekzistojnë në këto vise, këtë personalitet të lartë janë munduar ta prezentojnë si pjestar të rradhëve të veta. Është rëndë të konstatohet se cilit tarikat i takoi Sari Salltëku mirëpo emri i tij autoritet dhe famë më të madhe ka gëzuar në mesin e bektashive.

Mënyra e dytë e depërtimit të tarikatit bektashian në Ballkan, e me të edhe në viset shqiptare, është nëpërmjet të baballarëve bektashi të cilët pas vendosjes së administratës osmane kanë ardhur prej Teqesë së Dimetokës.

Misionari themelor i kësaj periudhe është Sejjid Ali Sulltani i cili ka thirrë në Greqinë Lindore, në Bulgarinë Lindore dhe Rumaninë Jugore.[99]

Sejjid Ali Sulltani është vendosur në qytetin e Dimetokës dhe aty ka themeluar një teqe e cila edhe sot e kësaj dite e mban emrin e tij. Në Vilajetname'n Sejjid Ali Sulltani përmendet si njëri prej të katërdhjetëve të cilët e kanë parë

---

97 Kaleshi Hasan, Legjendat Shqiptare për Sari Salltëkun, Përparimi, 1\ 1967, Prishtinë. Fq.. 86-103.

98 Më gjerë shih: Ibrahimi Nexhat, Po aty. fq. 235-245; Kaleshi Hasan, po aty.

99 Michael Kiel, Sari Saltik ve Erken Bektasilik Uzerine Notlar. Turk Dunyasi Arastirmalari ergisi, v.2, II,9. Aralik 1980. Fq. 25.

në ëndërr Pejgamberin a.s. dhe janë urdhëruar që të shkojnë te Haxhi Bektash Veliu.[100]

Teqeja e Sejjid Ali Sulltanit është teqeja e dytë me vlerë pas Teqesë së Haxhi Bektashit. Më vonë prej kësaj teqeje kanë arritur baballarë me famë, si Ballëm Sulltani, Vahdeti Dedeu, Sejjit Mustafa Dedeu, Kara Ali Dedeu, Sadik Abdullah Dedeu, të cilët kanë arritur që të përhapin Islamin dhe tarikatin bektashian në Gadishullin Ballkanik.

Ndër misionarët Bektashi të cilët e kanë përhapur këtë tarikat në mesin e shqiptarëve dallohet Baba Kasëmi, i cili, sipas disa të dhënave, në Shqipëri ka ardhur në kohën e Mehmedit të Dytë Fatihut.[101] Poashtu rol të rëndësishëm do të luajnë edhe Sersem Ali Baba[102], Shemimi Baba, Harabati Baba, Hëdër Baba etj.

Harabati Baba dhe Hëdër Baba, dy dervishë të Teqesë së Dimetokës janë nisë drejtë viseve shqiptare. Kur kanë arrijtë në Tetovë Harabati Baba me dy dervishë ngel në Tetovë kurse Hëdër Baba vazhdon edhe më. Harabati Baba në vendin ku sot gjendet Teqeja Harabati Baba e sheh kandilin e ndezur të Sersem Ali Dedeut dhe aty ndërton tyrben e tij. Më vonë kjo tyrbe rritet në një kompleks të madh i cili do të ndikojë dukshëm në jetën fetare, sociale, ekonomike dhe artistike të popullatës së këtyre viseve. Ndërsa Hëdër Baba  ka vazhduar rrugën deri në

100 J.K. Birge, po aty, fq. 58.

101 Baba Turabi në librin e tij Historia e Përgjithshme e Bektashinjët pohon se Baba Kasëmi në Shqipëri ka ardhur në vitin 1378.

102 Sersem Ali Baba është me prejardhje nga Tetova. Ka qenë vezir i Sulltanit, mirëpo është larguar prej funksionit dhe ka shkuar në Nexhef. Në vitin 958\1551 është ulur në postin e kryegjyshit në Teqenë e Haxhi Bektashit dhe ka qëndruar aty 19 vjet. Teqeja bektashiane e Tetovës e mban emrin e tij. Shih Nojan, Bedri, po aty, fq. 52.

Kërçovë ku edhe ka ndërtuar një teqe e cila mban emrin e tij.

Një ndër faktorët me rëndësi në përhapjen e tarikatit bektashian në viset ballkanike është edhe relacioni bektashi-jeniçer. Kudo që shkonin jeniçerët aty automatikisht me vete e bartnin edhe tarikatin e tyre.

Tarikati bektashian ka luajtë rol të rëndësishëm në islamizimin e popullatës ballkanike, në veçanti të shqiptarëve, në inkuadrimin e saj në administratën osmane si dhe në zhvillimin e arteve dhe zanateve të ndryshme në popullatë.

## TARIKATI BEKTASHIAN NË VISET SHQIPTARE GJATË PERIUDHËS OSMANE

Në bazë të asaj që u tha deri më tash, shihet qartë se historikisht nuk dihet saktë koha e përpiktë e vendosjes së bektashinjve në viset tona, por është më se e qartë se me ardhjen e ushtrisë osmane kanë ardhur edhe dervishët dhe baballarët bektashi.

Një numër i konsiderueshëm i këtyre dervishëve janë përqëndruar në vende të caktuara dhe kanë formuar teqetë e tyre. Për veprimtarinë bektashiane deri në gjysmën e shekullit XVII në viset shqiptare nuk ka të dhëna të shkruara. Të dhënat për formimin e teqeve bektashiane fillojnë prej gjysmës së dytë të shekullit XVII, kurse periudha më e frytshme është shekulli XVIII dhe XIX. Kjo shihet edhe nga poezi të shumta të shkruara nga ana e baballarëve dhe dervishëve bektashi në këtë periudhë.

Shumica e administratorëve të shtetit osman në viset shqiptare gjatë shekujve XVIII dhe XIX i takonin tarikatit

bektashian, prandaj edhe aktiviteti i bektashive si në lëminë artistike poashtu edhe në atë sociale, në ndërtimin e tyrbeve dhe teqeve ka qenë i madh në këtë epokë. Në mesin e tyre mund të përmenden Ali Pashë Tepelena, Rexhep Pasha, Abdurahman Pasha etj.

Në kohën e Rexhep dhe Abdurahman Pashës, me ndihmën e tyre është rindërtuar Teqeja Harabati Baba dhe i janë shtuar disa ndërtesa ndihmëse. Kompleksi i Harabati Baba Teqesë ka kontribuar dukshëm në ngritjen dhe zhvillimin e Tetovës dhe rrethinës. Dervishët në njërën anë bënin ibadet dhe luteshin, kurse në anën tjetër edhe mësonin ndonjë zanat ose degë të artit. Kështu që përveç zanateve të kohës, në Harabati Baba si dhe në teqetë tjera bektashiane në mbarë trojet shqiptare është kultivuar me të madhe poezia, muzika sufite, piktura etj. Zbukurimet, pejsazhet, nefeset (poezi bektashiane) e shkruara në vetë murret e Harabati Babës janë argumente bazë të këtij realiteti.

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII në postin e Teqesë Harabati Baba është ulur Baba Mehmeti prej Malatje (v. 1194\1780). Pas tij Husein Dedeu (v.1199\1784), Baba Sadiki (1204\1789), Dede Hasani (1208\1793).[103]

Përveç Teqesë Harabati Baba të cilën e përmendëm vetëm sa për ilustrim, gjatë periudhës osmane kanë vepruar edhe shumë teqe tjera me rëndësi, si p.sh.: Teqeja e Baba Mustafës, Teqeja e Baba Sulejmanit në Shkup, Teqeja e Husein Babës në Manastir, Teqeja e Hamza Babës në Shtip, Teqeja e Haxhe Babës në Veles, Teqeja e Hëdër Babës në Kërçovë, Teqeja e Dikmen Babës në Kanatllar të Prilepit etj.

103 Më gjerë shih: Vishko Ali, Harabati Teqe e Tetovës dhe Veprimtaria në të në periudhën e kaluar, Tetovë 1997.

Në Kosovë teqetë bektashiane më aktive kanë qenë: Teqeja e Mitrovicës (Zveçanit), e Janjevës, e Prishtinës, e Kaçanikut, e Prizrenit si dhe ajo e Gjakovës.

Prej teqeve bektashiane në Shqipëri mund të veçohen: Teqeja e Krujës, e Elbasanit, e Beratit, e Peqinit, e Çermenikës, e Martaneshit, e Mallakastrës, e Skraparit, e Tomorit, e Vlorës, e Leskovikut, e Tepelenës, e Kukësit dhe e Tropojës.

Teqetë bektashiane në gjysmën e dytë të shekullit XIX janë bërë çerdhe të kryengritjes ndaj shtetit osman. Rol të rëndësishëm në këtë kanë luajtë edhe misionarët politikë perëndimorë të cilët si udhëpërshkrues me muaj të tërë kanë qëndruar nëpër teqetë bektashiane në tërë territorin e banuar me shqiptarë. Mirëpo, tërhjekja e shtetit osman prej Ballkanit nuk ka qenë aspak në favor të bektashinjve. Pas ndarjes së trojeve shqiptare, qendrat bektashiane jashtë Shqipërisë janë braktisur dhe shumica e bektashive ose është inkuadruar në mesin e popullatës tjetër ose ka emigruar në Shqipëri . P.sh. teqeja Harabati Baba është mbyllë në vitin 1912 dhe nëse veçohen dy tri vitet e shërbimit të Baba Qazimit dhe Dervish Musës, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kjo teqe ka mbetur e mbyllur për ibadet 80 vite të tëra.

Pas dy luftrave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, respektivisht pas vitit 1914, Perandoria Osmane tërhiqet në tërësi prej trojeve shqiptare. Fundi i luftës nuk solli rezultate të volitshme për shqiptarët. Shqiptarët mbetën të ndarë në tre shtete: në Shqipëri, në Greqi dhe në Mbretërinë Jugosllave. Kjo ndarje e trojeve etnike ishte e kobshme si në pikpamje kombëtare, ashtu edhe në atë fetare. Grekët i mbyllën ose i shndërruan në kisha të gjitha faltoret -

xhamitë dhe teqetë muslimane shqiptare në pjesën e Çamërisë. E njëjta gjë ndodhi edhe me disa teqe në territorin e Mbretërisë Jugosllave, p.sh. Teqeja në Makedonski Brod u shndërrua në kishën e Shën Nikollës etj.

Mes dy luftrave botërore aktiviteti i bektashinjve shqiptarë si dhe botërorë-pasi në vitin 1925 u mbyllën teqetë në Turqi- është i përqëndruar në Shqipëri nën udhëheqjen e Salih Nijazi Dedeut.

Në këtë periudhë fillon aktiviteti i bektashinjëve shqiptarë për pavarësi nga Komuniteti Musliman. Kjo edhe ndodhë në Kongresin e Lushnjës ku Bektashizmi pranohet si i barabartë me Sunizmin, Kishën Ortodokse dhe ate Katolike.

Në 17 janar të vitit 1921 në Prishtë është mbajtë kongresi i parë bektashian dhe në te kanë marrë pjesë 37 baballarë. Në të është zgjedhur një këshill prej shtatë baballarëve të cilët do të thonin fjalën e fundit në lidhje me çështjet bektashiane.

Në vitin 1933 Mbreti Ahmet Zogu Salih Nijazi Dedeut i ndërton godinën e kryegjyshatës, në të cilën ai përgatiti 67 dervishë shqiptarë dhe i ngriti në baballarë e më pas i dërgoi në teqe të ndryshme në mbarë trojet shqiptare. Në këtë periudhë në Tetovë prej teqesë së Elbasanit janë dërguar dervish Qazim Bakalli dhe Musa Hinadema.[104]

Në periudhën mes dy luftrave botërore një numër konsiderueshëm i hoxhallarëve janë munduar që bektashinjtë të cilët ishin mjaft të larguar prej vijës islame t'i kthejnë në zbatimin e ibadeteve themelore të çdo muslimani: të falin namaz, të agjërojnë etj.[105]

104 Për aktivitetin e tyre në Tetovë dhe më gjerë shih: Vishko Ali, Po aty.

105 Mund të veçohen Xhemil ef. Jusufi dhe Bedaet ef. Jusufi, Ali ef. prej Mati etj.

Pas Luftës së Dytë Botërore, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë e Maqedoni, filloi kriza e praktikës fetare. Pas një periudhe të presionit të dukshëm në Shqipëri mbyllen të gjitha faltoret, kurse në Jugosllavinë komuniste aktivitetin e saj e vazhdon Teqeja e Gjakovës nën udhëheqjen e Baba Qazim Bakallit. Bektashinjtë e Maqedonisë janë udhëhequr nga Tahir Gashi.

Në periudhën e Jugosllavisë komuniste (1945-1990) tarikatet dhe teqetë janë inkuadruar në organizatën e Bashkësisë Islame. Organizata e parë e tarikateve dhe teqeve në Jugosllavi është paraqitur në vitin 1970 dhe ka marrë emrin Federata e Dervishëve të Tarikateve Islame të Jugosllavisë.[106]

Në vitin 1978 kjo organizatë ka nxjerë edhe një gazetë të pavarur që mbante emrin "HU". Bektashinjtë shqiptarë në këtë organizatë i përfaqësonte Baba Qazim Bakalli.

Në Shqipëri pas vrasjes së Salih Nijazi Dedeut në vitin 1941[107]në vend të tij vjen Baba Rizai, pas vdekjes së tij në vitin 1944, në këtë post vjen Baba Xhaferi.Pas vdekjes së tij në këtë post në vitin 1945 vjen Baba Kamberi. Pas vdekjes së tij në vitin 1947 postin e merr Baba Abbasi.[108] Pas Baba Abbasit në post vjenkalon Baba Ahmet Muhtari i cili internohet nga ana e shtetit komunist dhe në vend të tij

106 Shukriç Nijaz, Islamska Zaednica u Bosni I Hercegovini nakon oslobodjenja, Islam I muslimani u BiH , Sarajevo 1977,. fq. 153-68.

107 Sipas bektashinjve ai u vra nga ana e fashistëve italjanë, mirëpo ka edhe mendime se ai u vra për shkak të bashkëpunimit me italianët.

108 Në vitin 1947 Baba Abbasi, pasi që vrau baba Fajën dhe Baba Fejzën, bëri vetëvrasje. Baba Faja dhe Baba Fejza kishin pranuar sugjerimet e Enver Hoxhës për ndryshimin e veshjes tradicionale bektashiane me atë moderne evropiane. I nevrikosur prej tradhtisë që bëjnë këta dy baballarë Baba Abbasi i vret që të dy dhe më pas bën vetëvrasje.

vendoset Baba Laziu i cili në këtë post ka qëndruar deri në vitin 1967 kur edhe janë mbyllë teqetë në Shqipëri.

Pas proçeseve demokratike në Shqipëri në vitin 1991, Baba Selimi, Baba Bajrami, Baba Nakiu, Baba Sherifi dhe Baba Reshat Bardhi tubohen dhe duke e zgjedhur Dede Reshat Bardhin për kryegjysh fillojnë me riorganizimin e Kryegjyshatës bektashiane në Tiranë.

Pas vitit 1990 edhe bektashinjtë e Maqedonisë filluan me praktikimin e riteve dhe lutjeve bektashiane haptazi. Me aktivitete fillon Teqeja e Hëdër Babës në Kërçovë, me Baba Ejup Rakipin në krye, në fshatin Kanatllar të Prilepit nën udhëheqjen e Baba Musës, Baba Xhaferit dhe Baba Idrizit.

Në Nevruz të vitit 1993 bektashinjtë e Tetovës, Gostivarit dhe Kërçovës së bashku hyjnë në Teqenë e Harabati Babës në Tetovë, e cila shërbente si kompleks turistik dhe pas grevës dhjetëditëshe arrijnë që të vendosen në pjesën e Tyrbes dhe Odës së Mejdanit (dhoma e lutjeve dhe ceremonive bektashiane). Për postnishin të Teqes Harabati Baba në Tetovë është vendosur Baba Tahir Emini.

## PJESA E DYTË

### THEMELET E BESIMIT DHE PRAKTIKËS ISLAME SIPAS TARIKATIT BEKTASHIAN

Në pjesën e parë të këtij punimi u munduam që, duke u bazuar në literaturën bazë të paraqitjes së frakcioneve dhe rrugëve sufite (tarikateve) e në veçanti të tarikatit bektashian, të prezentojmë një pasqyrë objektive të paraqitjes, zhvillimit dhe degëzimit të tyre në përgjithësi në botën islame e në veçanti ndër shqiptarët.

Tarikati bektashian, si një hallkë e zinxhirit të Tesavvufit islam, gjatë 6-7 shekujve të ekzistimit të vet, falë faktorëve të ndryshëm të cilët u përmendën në tekstin e mësipërm, pësoi disa ndryshime në mënyrën e prezentimit të besimit islam dhe praktikimit të obligimeve themelore të Fesë Islame.

Ne këtu nuk kemi mundësi që të hyjmë në detajet e botëkuptimit bektashian rreth çështjeve të besimit (iman) dhe praktikës (islam) të Fesë Islame, mirëpo në këtë pjesë do të shtjellojmë disa ndër më të rëndësishmet.[109]

109 Për shkak të ekzistimit të disa mënyrave të prezentimit dhe praktikimit të elementeve të besimit dhe praktikës islame në mesin e vetë bektashinjve, mosekzistencës së një autoriteti për tërë bektashinjtë e botës dhe koncentrimit të tepërt të bektashinjëve në anën folklorike të rrugës së tyre është vështirë që të jepet një pasqyrë reale rreth asaj që sot bektashinjtë e nënkuptojnë si besim dhe praktikë islame. Prandaj edhe çështjet e shtjelluara në këtë pjesë kanë të bëjnë me atë se si duhet të besojnë dhe zbatojnë obligimet fetare bektashijtë sipas literaturës themelore bektashiane.

1. Koncepti i Zotit në tarikatin bektashian

Të gjithë bektashijtë, pa marrë parasysh cilit grup i takojnë, besojnë në ekzistencën dhe njësinë e Zotit xh.sh., respektivisht kanë besim të patundshëm në tevhidin.[110] Krahas kësaj mënyra e besimit në All-llahun xh.sh. te bektashinjtë përmban edhe shumë elemente të traditës sufite.

Njeriu, thotë Haxhi Bektash Veliu, duhet të shkrihet në Zotin xh.sh nëpërmjet të përvojës dhe praktikës fetare, të mundohet që në këtë botë të jetojë me sekretin e afërsisë në All-llahun xh.sh. dhe të heq dorë prej çdo gjëje që nuk ka të bëjë me Atë. Nëse njeriu e rrok një besim të tillë atëherë gjithnjë do të jetë pranë Zotit. Ashtuqë në tërë veprat e tija edhe pse nuk e sheh, do të sillet sikur e sheh Zotin xh.sh., gjegjësisht Zotin do ta kërkojë në brendinë e tij e jo jashtë vetes. Në traditën sufite, e në veçanti në atë bektashiane mjaft është prezente përmasa e dashurisë ndaj Zotit dhe aspak nuk flitet për frikën prej Tij.

Ja si është shprehur besimi bektashian në Zotin në një poezi të Kajgusuz Abdall'it

"Cilësi e mirë e ytja KulhuvAll-llahu ehad
Në çdo moment je i fuqishëm e në çdo sahat

Tërë sekretet i di, Ti o Kadir
S'ke shok, as të ngjashëm, as rival.

Çdo gjë je Ti i nderuar, i shënuar
Çdo gjë pa Ty është e shkatërruar.

110 Disa orientalistë janë orvatur që prezencën e treshit All-llah-Muhammed-Ali në tarikatin bektashian ta komentojnë si trinitet krishter. Mirëpo ky vlerësim është i gabuar pasi, sipas bektashinjve Muhammedi a.s. dhe Hazreti Aliu nuk janë as bij të Zotit e as shpirtëra të shenjtë, por janë njerëz të cilët falë përsosurisë (kemalit) së tyre janë më afër Zotit se sa njerëzit tjerë.

Pronar je i ekzistencës, i përhershëm pa fund
Ti je krijues i krijesave, o Dhul xhelal!

Zoti është Mbulues i gabimeve dhe Fisnik,
Ai është i Gjithdijshëm, i Urtë dhe plot mëshirë.[111]

Trajta e besimit te bektashinjtë është ngushtë e lidhur edhe me urtinë e ekzistencës dhe krijimtarisë.[112]Si në të gjitha tarikatet ashtu edhe te bektashijtë themel është njëshmëria e qenësisë (vahdet-i vuxhud), respektivisht ka vetëm një ekzistencë reale absolute (vuxhud-i hakik-i mutllak) dhe ai është All-llahu xh.sh. Të gjitha gjërat e tjera janë vetëm hije të ekzistencës.[113]Para paraqitjes së gjërave

111 Iy sýfatýn KulhuvAll-llahu ehad
Her dem içinde Kadýrsýn her sahat

Cümle sýrrý sen býklýrsýn ey Kadýr
Bý þerýksýn bi misalsin bi nazir

Cümle sensýn muteberu muhtasar
Ol ký sensýzdýr fiþar ender fiþar

Malýkul mulksýn Kadým u lem yezel
Mahlukun Halýký sensýn zulcelal

Tanrý settarul uyubdur hem Kerým
Hem alýmdýr hem hakýmdýr hem rahým.

112 Çështja e ekzistencës dhe gjithësisë është njëra ndër më të rëndat për sqarim në të gjitha filozofitë. Por, pasi ajo është drejtëpërdrejtë e lidhur me çështjen e ekzistimit të All-llahut xh.sh. edhe Kur'ani i ka kushtuar rëndësi të posaçme.

113 Kundërshtarët e vahdet-i vuxhudit e kanë identifikuar atë me panteizmin, mirëpo ka dallime mjaftë të qarta mes panteizmit dhe vahdet-i vuxhudit, edhe pse në shikim të parë ata duken si të njëjta. Dallimi themelor është në atë se vahdet-i vuxhudi përjetohet kurse panteizmi është prodhim i arsyes. Prandaj personi i cili nuk e ka përjetuar vështirë mund ta kuptojë. Sa për ilustrim do të jap një shembull të shkurtër:
Nëse mbi tavolinë i vemë dy gota dhe njërën prej tyre e mbushim me ujë të pijshëm kurse tjetrën me uj deti dhe i thërrasim disa persona që prej së largu t'i shikojnë ato, do të shohim se ata nuk do të

tjera pos All-llahut, Ai ekzistonte në trajtën e "ahadijjet'it".[114] Dhe ishte e bukura absolute (Xhemal-i mutlak). Krijimtaria është vetëm paraqitja e kësaj bukurie absolute .

Në këtë kontekst përmendet edhe një hadith-i kudsi[115], në të cilin thuhet: "Unë isha një arkë e fshehtë, dëshirova të njihem prandaj i krijova krijesat (halkin)". All-llahu xh.sh. tha "kun" (bëhu) dhe çdo gjë u bë.[116]Por e tërë ajo që u bë nuk është jashtë Zotit, por është paraqitje trajtësore e asaj që më parë ekzistonte në diturinë absolute të All-llahut xh.sh. P.sh. një piktor para se të paraqesë në pëlhurë pikturën, atë e ka në idetë e tija, respektivisht

---

bëjnë dallim mes tyre. Mirëpo, nëse i afrohen gotave do të shohin pak dallim, e nëse i shijojnë atëherë do të konstatojnë se nuk janë të njëjta dhe se njëra prej tyre është e mbushur me ujë të pijshëm, kurse tjetra me ujë deti.

114 Sipas botëkuptimit sufit diçka nuk mund të krijohet prej asgjëje (creation ex nihilo), prandaj kushtimisht themi se krijesat në fillim ishin bashkë me Zotin.Mu për këtë në tesavvuf nuk përdoret termi krijim (halk) por termi paraqitje, dukje (tedhahur) . Paraqitja e krijesave tjera dhe ndarja e tyre prej Zotit është bërë nëpërmjet të shtatë shkallëve të krijimtarisë (meratibul vuxhud), edhe atë:

1. La teajjun, ahadijjet – Pozita kur nuk ekzistonte asgjë pos All-llahut dhe për të cilën nuk din asgjë askush tjetër pos All-llahut xh,.sh.
2. Taajjun-i evvel, Hakikat-i Muhammedije- Në këtë shkallë krijesat paraqiten në diturinë absolute të All-llahut xh.sh. I pari në të është Nuri i Muhammedit a.s.
3. Teajjun-i Thani- Në këtë shkallë ekzistojnë si të ndara në diturinë e All-llahut xh.sh.
4. Alem-i Ervah-Shpirtërat
5. Alem-i Mithal- Idetë
6. Alem-i Shehadet-Gjithësia
7. Insan-i Kamil- Përsosuria njerëzore.

115 Hadith-i kudsi janë thëniet e All-llahut xh.sh të prezentuara me fjalët e Pejgamberit a.s.. Sufijtë këtë hadith e pranojnë si të vërtetë edhe pse shkencëtarët e shkencës së hadithit thonë se është i dobët.

116 Jasin 82.

ekzistenca e pikturës nuk fillon me prezentimin e saj në pëlhurë por qysh prej trajtës ideore të saj.

Sipas bektashinjve, gjithësia është reflektim i ekzistencës absolute. Kurse trajta më e përsosur e këtij reflektimi është njeriu, prandaj edhe ai Zotin duhet ta njohë prej vetvetes. Në një hadith-i kudsi thuhet: "Ai që e njeh veten, e njeh edhe Zotin". Njeriu ngritet në gradat më të larta vetëm nëpërmjet të zemrës dhe brendisë së pastër, pasi zemra është vendbanim i Zotit. Bektashinjtë këtë botëkuptim e mbështesin në ajete të Kur'anit Famëlartë dhe si prova sjellin argumentet e mëposhtme:

"...Vërtetë, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në më të ultën e të ultëve. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë. E pas gjithë kësaj, ç'të shtyri të përgënjeshtrosh ditën e shpërblimit (përgjegjësisë)? A nuk është All-llahu më i urti i gjykuesve."[117]

" Ne e kemi krijuar njeriun dhe e dimë se ç'pëshpëritë ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij".[118]

"... dhe ta dini se All-llahu ndërhyn ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai".[119]

" Çfarëdo e mirë që të vjen është nga All-llahu, e çka të ndodhë nga ndonjë e keqe është nga vetë ti..."[120]

" Kur Zoti yt u tha engjëjve : Unë po krijoj një njeri nga balta dhe kur ta kem përsosur atë dhe t'i kem dhënë nga ana ime shpirt, ju menjëherë përulunju atij (në sexhde).

117 Tin, 95\4-5.
118 Kaf, 50\116.
119 Enfal 8\24.
120 Nisa 4\79.

Engjëjt të gjithë së bashku iu përulën përveç Iblisit që ishte kryelartë dhe që u bë prej jobesimtarëve".[121]

"…Ai është me ju kudo që të jemi, All-llahu është përcjellës i asaj që punoni".[122]

Në bazë të ajeteve të lartëpërmendura bektashinjtë pohojnë se njëshmëria qenësore paraqitet me aktivitetin metafizik të zemrës. Zemra edhe pse lëviz dhe sillet në mundshmëri, muhibi bektashian nëpërmjet të prezentimit, ekstazës, reflektimeve metafizike, botës së simboleve etj. Del prej mundshmërisë dhe i afrohet qenësisë së pastër hyjnore.

Besimi i këtillë në tarikatin bektashian – si edhe në tarikatet e tjera – arrihet nëpërmjet të dashurisë hyjnore ( ashk-i ilahi). Kjo dashuri mund të sendërtohet në përputhshmëri me vendimet e sheriatit. Njeriu duhet të pastrojë zemrën prej materies dhe ndryshkut të pakujdesisë, me qëllim që të sendërtohet në pasqyrë të emrave dhe cilësive të All-llahutxh.sh..

Njëri ndër poetët më me famë në mesin e bektashive Junus Emre'ja këtë realitet të besimit e ka shprehur me një dyvargësh.

"Mua mos më thuaj rob unë nuk jam rob
Një unë ka në mua, brenda meje".

Qenësia e të gjitha gjërave tjera përveç All-llahut xh.sh. është alegorike dhe relative. Çdo gjë në gjithësi është persiatje dhe shpresë. Gjësendet ekzistojnë me Zotin, kurse nuk ekzistojnë në vetvete. Qenësia në realitet është e atij që ekziston prej vetes. Personat që janë të ngritur prej alegorisë në realitet janë të bindur se nuk ka ekzistencë tjetër pos All-llahut xh.sh.. Qenësia e

121 Sad, 38\ 71-74.
122 Hadid 57\ 4.

gjësendeve të mundshme nuk është qenësi që ekziston prej vetes. Gjërat e mundshme qenësinë e kanë në bazë të lidhjes së tyre me qenësinë e Vërtetë.Qenësia reale është e amshueshme dhe nuk ka fillim. Njeriu çdo gjë e vlerëson prej dritares së të krijuarës. Çdo gjë që vlerësohet prej dritares së të krijuarës është kohore dhe vendore. Prandaj afrimi i vërtetë me Zotin mund të bëhet vetëm me ndjekjen e një udhërrëfyesi (myrshidi) të përsosur.

## NUR-I MUHAMMED ALI

Sipas botëkuptimit bektashian All-llahu xh.sh. ka krijuar një dritë prej dritës së vete dhe e ka emërtuar si Nur-i Muhammedi,[123]dhe pikërisht kjo dritë është shkak i krijimit të gjithësisë. Krijimi i dritës së Pejgamberit prej dritës së All-llahut nuk ka trajtë materiale, por do të thotë krijim i një drite si domosdoshmëri e vullnetit hyjnor.

Pejgamberi a.s. është emnues i përbashkët i emrave të Zotit dhe përfaqësues i emrit "Rahman". Ai është njeriu më i përsosur, është sekret i udhërrëfimit (irshadit) dhe epiqendër praktike e Kur'anit dhe së Vërtetës.

Këtë përmasë të personalitetit të Pejgamberit a.s. e shprehin shumë ajete të Kur'anit Famëlartë:

123 Përcillet një hadith prej Xhabir ibën Abdullahut në të cilin thuhet: O i Dërguar i All-llahut prindërit e mi të qofshin falë, a më thua cilën gjë Zoti e krijoi të parën? Pejgamberi urdhëroi : O Xhabir, All-llahu i Lartë piksëpari prej dritës së vet e krijoi dritën e pejgamberit tënd…" Në vazhdim të hadithit shkallë shkallë përmendet krijimi i gjallesave tjera prej kësaj drite. Shih: M. Demirci, Nur-i Muhammedi, Përmbledhje punimesh e Universitetit 9. Eylul Izmir, I,251.

"Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e All-llahut"[124]

"Vërtet ti je në një shkallë të lartë të moralit"[125]

"O ti pejgamber, ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar, përgëzues, e qortues dhe me urdhërin e All-llahut thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtarë ndriçues" [126]

"Ai është mëshirë për botërat" [127]

Pejgamberi a.s. është vula e të gjithë pejgamberëve, i pari i krijimtarisë dhe shkaku i krijimit të gjithësisë.[128] Ai është kryesues i pejgamberëve, udhërrëfyes i evlijave, lajmëtar i mëshirës, shërim i zemrave dhe pasqyrë e bukurisë hyjnore. Në një hadith-i kudsijj në lidhje me të thuhet: "Sikur të mos ishe ti, sikur të mos ishe ti, nuk do të krijoja gjithësinë"[129]

Nur-i Muhammedi (Hakikat-i Muhammedijje) është fillimi i shkallëve të qenësisë. Mbi të ekziston Qenia (Dhat) e cila nuk mund të cilësohet me asnjë emër dhe cilësi. Nur-i Muhammedi në aspekt të realitetit të përcaktuar gjegjësisht paratrajtës primare (ajn-i thabit) të saj në diturinë e All-llahut xh.sh. është pa fillim, ndërsa në aspektin e paraqitjes së jashtme është e krijuar dhe e prezentuar në personalitetin e Pejgamberit a.s..

Fuzuliu dritën e Pejgamberit a.s. e ka shprehur në vargjet:

"O i dashur i All-llahut, dhe më i miri i mirësisë

---

124 Ahzab, 33\ 21.
125 Kalem, 68\ 4.
126 Ahzab, 33\ 45-46.
127 Enbija, 21\ 1o2.
128 Ahzab, 33\ 40.
129 Në lidhje me këtë hadith ka mendime të ndryshme në mesin e dijetarëve muslimanë. Shkencëtarët e hadithit e konsiderojnë si apokrif (meudu) ndërsa sufijtë, në bazë të kritereve të veta, e konsiderojnë të saktë.

Digjem për ty. Digjem me mall për takimin me ty
Siç digjen buzët e thara për takimin me ujin"
Ndërsa një poet tjetër thotë:
"Ti je esenca e krijimtarisë. Uji dhe balta e
Ademit dhe Havës krenohet me qenien tënde".

Gjithësia është një pasqyrë e cila ri në këmbë me të vërtetën, ndërsa e vërteta gjithnjë vërehet prej pasqyrës së Muhammedit a.s.. Në këtë pikë bektashinjtë së bashku me Muhammedin a.s. si dritë të Zotit e shohin edhe Hazreti Aliun. Ata i unjësojnë të dy dhe në to e shohin përfaqësimin e dritës hyjnore. Sipas tyre, Muhammedi dhe Aliu edhe pse kanë trupa të ndryshëm ata janë një, janë të krijuar prej dritës së njëjtë. Në botëkuptimin bektashian Pejgamberi a.s. dhe dhëndëri i tij janë të bashkuar në një fizionomi teologjike.[130]

Duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s. "Unë jam qyteti i diturisë, kurse Aliu është dera e tij" bektashinjtë Hazreti Aliut i atribuojnë edhe cilësi të larta. Me këtë paraqiten dy koncepte të Aliut. i pari është Aliu njeri, i cili jeton ndër njerëzit, kurse i dyti është Aliu doktrinal i cili ka vlerë kozmike. Trajtësimi i dritës hyjnore në Muhammedin a.s. dhe Aliun r.a. është bërë subjekt i shumë poezive bektashiane. Në këto poezi, duke u bazuar në botëkuptimin e vahdet-i vuxhudit (njëshmëria e qenësisë), bektashinjtë e kanë unjësuar dritën hyjnore, pejgamberiane dhe atë të Aliut r.a. (Nur-i Ilahi- Muhammedi-Ali).[131]

130 Eroz, M. Po aty. fq.213.

131 Nga disa studjues perëndimorë dimensioni sufit i dritës hyjnore të prezentuar në poezitë bektashiane është sqaruar me doktrinën e trinitetit krishter. Është ireale dhe e njëanshme të dilet me tezë të këtillë kur është më se e qartë se poezia sufite- brenda saj edhe ajo bektashiane- gjatë unjësimit të dritës së lartëpërmendur ndalet në esencën e saj e jo në personalitetet ku është prezentuar. Ndërsa në

Në kulturën bektashiane esenca e dritës është hyjnia. Drita e dërgueshmërisë është pejgamberi i fundit Muhammedi a.s., kurse drita e velajetit (evlijallëkut) është në Aliun r.a.. Cilësia e dërgueshmërisë së Pejgamberit a.s. ka përfunduar me të, ndërsa cilësia e evlijallëkut të tij ka vazhduar nëpërmjet të Aliut r.a. dhe evlijave tjerë që do të vijnë pas tij.

Njëri prej kryegjyshëve bektashi, Bedri Nojan, në librin e tij në lidhje me këtë çështje thotë: "Treshi - All-llah-Muhammed-Ali- i prezentuar në kulturën bektashiane nuk ka asgjë të përbashkët me trinitetin – Ati-biri-shpirti i shenjtë- e krishterizmit. Babai, nëna dhe familja e Muhammedit a.s. dhe Aliut r.a. janë të njohura, ata kurrë nuk kanë pohuar se kanë zbritur prej qiellit. Edhe Pejgamberi a.s., edhe Aliu r.a. gjithnjë kanë theksuar se janë rob të All-llahut xh.sh..[132]

Është e udhës që personaliteti i Aliut r.a. të vlerësohet në bazë të fjalëve dhe veprave të tija të prezentuara në shumë burime historike. Një afrim sistematik dhe preciz në këto vepra më së miri do të pasqyronte personalitetin e Aliut r.a.. Ne këtu do të paraqesim disa mendime të Aliut r.a. të nxjerra prej fjalimeve të tija:

"Çështja parësore e fesë është njohja e All-llahut. Përsosja e njohjes së Zotit është verifikimi i Tij. Verifikimi i tij bëhet me besim të patundshëm në njëshmërinë e Zotit".[133]

"… Pastaj All-llahu dërgoi pejgamberët që njerëzimit t'ia transmetojnë fjalën hyjnore, t'ia përkujtojnë mirësitë e

krishterizëm të tri elementet e trinitetit kanë personalitet të posaçaëm. Shih: Birge, Po Aty. fq.217.

132 Nojan, B. po aty. fq.54.

133 Imam Ali Ibën Ebu talib, Nahxhu'l-Belaga, I,91.

Zotit, t'i këshillojnë ata dhe t'ua përfaqësojnë vlerën e urtisë duke i ngritur perdet para syve të tyre. Zoti njerëzve u ka dërguar pejgamberë, libra dhe prova për zbulimin e rrugës së drejtë".[134]

"Lartësimi i qoftë All-llahut që e shpërndanë mirësinë në krijesat, e zgjat dorën e mëshirës dhe bujarisë dhe i furnizon ata me të gjitha begatitë. Atë e falënderojmë në çdo punë dhe prej Atij ndihmë kërkojmë. Nuk ka Zot përveç Tij dhe Muhammedi a.s. është rob dhe i dërguari i Tij. Ai e ka dërguar Muhammedin a.s. për t'i transmetuar në mënyrë koncize urdhërat e Tija dhe për të sqaruar Madhërinë e Tij. Pejgamberi e ka kryer obligimin e tij me sukses dhe ka kaluar në botën tjetër duke ecur në rrugë të drejtë (sirat-i mustekim). Neve na ka lënë trashëgim flamurin e të vërtetës. Kush devijon prej këtij flamuri, del prej besimit; kush ngec pas tij, shkatërrohet; ndërsa kush ngjitet për të, është ngjitur për Zotin..."[135]

"Vazhdo të përkujtosh Zotin, pasi ky është adhurimi më i mirë. Vazhdo të kesh mall dhe dëshirë për të, pasi ai u ka premtuar besimtarëve dhe premtimi i Tij është i vërtetë. Ec gjurmëve të Pejgamberit a.s., pasi ajo është rruga më e mirë. Ndiqe sunnetin e Pejgamberit a.s. pasi ai paraqet sjelljen më të lartë. Mësoje Kur'anin, ai është fjala më e vërtetë. Kuptoje atë sa më mirë, ai është lule e zemrës"[136]

"Në momentin kur i zbriste shpallja Muhammedit a.s. dëgjova britmat e shejtanit. E pyeta të Dërguarin e Zotit se çka është kjo britmë? Ai m'u përgjigj: Kjo britmë është e Shejtanit, ai e ka humbur shpresën se dikush do ta adhuroje atë. O Ali edhe ti je duke dëgjuar atë që unë e

134 Po aty. fq.95.
135 Po aty, fq. 244.
136 Po aty, fq. 257.

dëgjoj dhe e sheh atë që unë e shoh, me një përjashtim të vetëm se ti nuk je pejgamber, por je vetëm një zëvendës dhe je në rrugë të drejtë…"[137]

Thëniet e sipërpërmendura dhe shumë të tjera, tregojnë pasqyrën e vërtetë të botëkuptimit të Aliut r.a.. Ai ka qenë njëri prej më të afërmëve të Pejgamberit a.s., besimtar i vërtetë, njohës i mirë i Islamit, evlija, sufi etj. Por assesi pejgamber, zot, e kështu me rradhë. Përfaqësimi i Hazreti Aliut me cilësi hyjnore në poezitë bektashiane ka karakter simbolik dhe ka të bëjë me esencën ( hakikatin) e cilësive e jo me trajtësimin e tyre.

Nuk është e udhës që, duke u bazuar në legjendat hagjiografike që kanë të bëjnë me personalitetin e hazreti Aliut, ai të nxirret prej kornizave të të qenit njeri dhe të diskutohet në bazë të ndonjë platforme tjetër.

## KUSHTET E BESIMIT DHE PRAKTIKËS ISLAME

Kushtet e besimit që në mesin e popullatës muslimane janë të njohura në gjashtë themelet e "Amentu bil-lahit" respektivisht besimi në qenësinë dhe njëshmërinë e All-llahut, besimi në melekët (engjujt), besimi në librat e shpallura, besimi në pejgamberët, besimi në Ditën e gjykimit në tarikatin bektashian janë identike me botëkuptimin sunnit-hanefit. Ndërsa një dallim të vogël ka në botëkuptimin e kada-së dhe kader-it (caktimit hyjnor). Sipas bektashive,[138] njerëzit nuk kanë mundësi që gabimet dhe lëshimet e tyre t'ia mveshin caktimit hyjnor dhe t'i

137 Po aty, fq. 393.

138 Shih: Tam Hakiki Hysnije, fq.25; Buyruk fq.59; R. Zelyut, Oz Kaynaklarina Gore Alevilik, fq.58)

shpëtojnë përgjegjësisë para All-llahut xh.sh.. Të gjithë njerëzit janë të vetëdishëm për veprat e tyre dhe për to do të jenë përgjegjës. Bektashinjtë në çështjen e caktimit hyjnor janë shumë afër botëkuptimit të mu'teziles, edhe pse ata nuk janë thelluar në prova mendore në lidhje me këtë problematikë, si e bën këtë mu'tezileja.[139]

Përgjigjen më të kapshme në lidhje me caktimin hyjnor e ka dhënë Aliu r.a.. Ai thotë se çdo gjë në gjithësi e njomë ose e thatë, e mirë ose e keqe, e bukur ose e shëmtuar, e dobishme ose e padobishme, e madhe ose e vogël është krijuar nga ana e All-llahut xh.sh.. Njeriu veprat e veta i kryen në bazë të lirisë dhe vullnetit personal. Për pasojë ai do të ballafaqohet me rezultatin e veprave të tija të mira ose të liga. [140]

Fjalët e sipërpërmendura të Hazreti Aliut janë në përputhshmëri të thuktë me ajetet kur'anore të cilat nuk lënë aspak vend për dyshim në këtë çështje: "E kush punoi ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe që peshon sa grimca, edhe atë do ta gjejë".[141]

Praktika islame është ngushtë e lidhur me shkollën juridike, rregullat e të cilës ndiqen nga një grup i caktuar njerëzish. Më lartë, në pika të shkurta, u përpoqëm të sqarojmë se tarikati bektashian nga aspekti i themeleve të besimit është identik me Ehl-i Sunnetin. Nëse analizohen kushtet dhe rrethanat e paraqitjes dhe zhvillimit të këtij

---

139 Asnjë prej rrymave kelamiste (apologjetike) në kulturën islame, përveç Xhebrijjes nuk e largon njeriun prej përgjegjësisë para All-llahut xh.sh. Polemikat e paraqitura në mes të Mu'teziles dhe Ehl-i Sunnetit në këtë çështje janë përfaqësime të dendësisë kulturore islame në lidhje me bartjen e përgjegjësisë.

140 Shih: Nahxhu'l-Belaga, fq. 92, 155-156, 345, 256.

141 Zilzal, 99\ 7-8.

tarikati, do të shihet se ky mendim është më se i vërtetë.[142] Është i madh numri i dijetarëve si dhe vetë bektashinjve të cilët pohojnë se bektashinjtë në praktikën e tyre islame e ndjekin shkollën juridike xhaferite. Por ka edhe të tillë që duke u bazuar në rrethanat shoqëroro-politike dhe në vazhdimësinë e këtij tarikati thonë se bektashinjtë janë ithtarë të shkollës juridike hanefite. Të dyja shkollat juridike të lartëpërmendura kanë dallime sekondare në mes vete dhe pa marrë parasysh cila prej tyre ndiqet, adhurimi i bërë me qëllime dhe shpirtëri të pastër arrinë deri në pragun hyjnor.Çështje më me rëndësi është që adhurimi të bëhet me sinqeritet dhe të aplikohet në jetën e përditshme se sa të thellohemi në polemika shterpe të cilat rezultojnë me ngecje në të gjitha lëmitë.

Për hirë të sistematikës studjuese këtu do të përmendi fjalët e Munxhi babës, i cili pranohet si autoritet në mesin e bektashinjve:

"Dëgjo, biri im! Është gabim të pohohet se Imam Xha'fer es-Sadiku është themelues i një shkolle juridike. Imam Xha'feri ishte lider i vërtetë dhe nuk ishte i preokupuar me themelimin e një shkolle të caktuar. Shkollat juridike dhe ato apologjetike janë themeluar pas kohës së tij. Ai ishte imam i gjashtë i zinxhirit të bijve të Pejgamberit a.s., prandaj është e palogjikshme të thuhet se ai ka themeluar një shkollë. Ai ka ndjekur mësimet e babait të vet Imam Muhammed Bakir'it, ai të babait të vet Ali Zejne'l Abidin'it , ai të babait të vet Husein b. Aliut dhe Huseini r.a. prej babait të vet Aliut r.a. dhe gjyshit Pejgamberit a.s.. Ky zinxhir i hakikatit nuk ndërpritet në asnjë vend.

142 Dijetarë të caktuar, kryesisht perëndimorë, kanë pohuar se bektashinjtë në çështjet e besimit janë shiitë, duke u bazuar në ekzistencën e botëkuptimit të dymbëdhjetë imamëve dhe ndjekjes së shkollës juridike të Imam Xha'fer es-Sadik'ut. Në tekstin e mëtutjeshëm do të bëhet fjalë edhe për këto dy pika me rëndësi.

Lideri i parë i sunnive është Hasan el-Basriu. Ky person i cili ishte prej tabiinëve (ndjekës i shokëve të Pejgamberit a.s.) ka qenë prej shokëve të Aliut r.a.. Shumica e tarikateve nëpërmes tij arrijnë deri te Aliu r.a.. Hasan el Basriu ka qenë nxënës i Hasanit r.a. dhe prej tij ka dëgjuar ligjëratat rreth caktimit hyjnor, të mirës dhe të keqes. Në të vërtetë Ehl-i Sunneti i vërtetë janë të gjithë ata që e duan dhe e ndjekin rrugën, praktikën dhe sjelljet e Aliut r.a. të trashëguara prej Pejgamberit a.s..

Të gjithë imamët e Ehl-i Sunnetit e kanë pranuar virtytshmërinë e Aliut r.a. dhe kanë dëgjuar ligjëratat e bijve të tij, imamëve, si dhe kanë qenë krenarë që janë nxënës të tyre. Imam A'dham Ebu Hanifeja ka qenë nxënës i Imam Xha'fer es-Sadikut dhe në momentet më të vështira të jetës e ka pohuar këtë.

Imam Ahmed b. Hanbeli nuk ishte vetëm dijetarë në lëminë e fikhut (Drejtësia Islame) por ishte edhe dashurues i Ehl-i Bejtit dhe arif (gnostik).

Nëse analizohen ligjëratat në Arafat të Imam Shafiut, do të shihet se të paktë janë individët që kanë thënë fjalë më të lavdishme për Aliun r.a. se ai. Fjalë të ngjashme mund të rradhiten edhe për Imam Malikun. Për pasojë nuk është e mundur që Ehl-i Sunneti dhe ithtarët e Aliut r.a. të ndahen prej njëri-tjetrit. Në këtë kontekst unë them: " Kushdo që është Ehl-i Sunnet është ithtar i Aliut r.a., kushdo që është ithtar i Aliut është Ehl-i Sunnet". Tash a kuptove biri im? Ndaç le të na thonë alevi ndaç le të na thonë sunni, për ne është një".[143]

Për sa i përket zbatimit të rregullave islame, një përqindje e madhe e bektashive i pranojnë obligimet, si namazin, agjërimin, zekatin, haxhin etj. Aliu r.a. në jetën

143 Shehbender Zade Hilmi bey, Islam Tarihi, II, 423; Abdulkadir Sezgin, Haci Bektas Veli ve Bektasilik, fq. 160.

dhe praktikën e tij nuk ka lënë asnjë pikë dyshimi në lidhje me faljen e namazit dhe obligimet tjera islame. Namazin e ka pranuar si shtyllë të fesë.[144] Historikisht është pranuar se bijtë e tij, në veçanti Xha'fer es-Sadiku, rrugën e të cilit thonë se e ndjekin një grup i konsiderueshëm i bektashinjve kanë qenë të përpiktë në kryerjen e obligimeve fetare.

Prej Vilajetname's mësojmë se Haxhi Bektash Veliu ka falë namaz mbi një gjeth. Tekste identike ka shumë edhe në Makalat'in e tij, për të cilin folëm më lartë.

Namazi është prezent edhe në poezitë bektashiane . P.sh. Poezia "Daha namaz sorarmisin? (A ende pyet për namazin?) e Kajgusuz Abdall'it; "Kil bes vakit namaz kazaya koma" ( Fal pesë kohë namaz e mos e le për kaza) e Pir Sulltan Abdall'it. Ahu Gurbiu në poezitë e tija pohon se namazi dhe agjërimi janë urdhëra të Kur'anit.[145]

Shumica e studjuesve dhe liderëve bektashi në ditë të sodit në veprat e tyre pohojnë se praktika islame ekziston në tarikatin bektashian. [146]

Ka një grup të bektashinjve të cilët e kundërshtojnë këtë dhe pohojnë se namazi dhe abdesti janë simbole të drejtësisë dhe mirësisë. Argument për pohimet e tyre sjellin disa vargje të Junus Emre's. Pohimi i këtillë është rezulltat i mosnjohjes së mjaftueshme të karakterit të poezisë sufite. Simbolika në poezinë sufike assesi nuk e kundërshton dhe nuk e pezullon thënien reale dhe egzoterike të vargut. Gjegjësisht simbolika e namazit dhe abdestit është drejtësia dhe mirësia, por në të arrihet nëpërmjet të zbatimit të këtyre dy ibadeteve. Imam Xhunejd Bagdadi në lidhje me këtë çështje ka thënë: "Nëse e shihni një njeri

144 Nahxhu'l-Belaga, fq. 410.
145 S. Ergun, Bektasi Sairleri, I, 170 dhe në vazhdim.
146 Shih: B. Nojan, Po aty, fq.224; H. Kaya, Bektasi Ilmihali etj.

se rri këmbëkryq në ajër, ose ec mbi ujë nëse nuk i përmbahet sheriatit mos i besoni".

Pikërisht për këtë, njerëzit të cilët dëshirojnë të thellohen në lartësitë e tarikatit piksëpari duhet të ndjekin rregullat e sheriatit dhe gjithmonë të kenë parasysh faktin se kalimi në gradë më të lartë shpirtërore nuk i mënjanon obligimet e gradës më të ulët.

Një numër i konsiderueshëm i bektashinjve të sodit i falin pesë kohët e namazit, bile falin edhe namaz të natës , e agjërojnë muajin e Ramazanit por edhe dhjetë ditët e para të muajit Muharrem. Botëkuptimi i zekatit te bektashinjtë është i marrët prej "humus-it" (një të pestat) të shiitëve. Ata duke u bazuar në ajetin "Ju (besimtarë) ta dini se një e pesta e asaj që e fituat, nga ndonjë send, i takon All-llahut, të Dërguarit të tij, të afërmëve të tij, jetimëve, nevojtarëve dhe atyre në mërgim, nëse keni besuar All-llahun dhe atë që ia zbritëm robit Tonë ditën e Furkanit ( ditën e Bedrit), ditën e konfrontimit të dy grupeve, All-llahu është i fuqishëm për çdo gjë" (Enfal, 8\ 41), ku flitet për plaçkën e luftës, ata thonë se edhe në kushte të paqes ithtarët bektashinj një të pestën e fitimit të tyre duhet t'ia japin teqesë. Te bektashinjtë kjo nuk është emërtuar "humus" si te shiitët, por quhet "Hakkullah" (Haku i Zotit) ose "Lokma" (kaçore).

Hakkullahi ndahet në tri grupe:

1. Hakku i Kazanit të zi- jepet për nevojat e teqesë.
2. Hakku i Myrshidit (udhërrëfyesit)- jepet për udhërrëfyesin dhe baballarët.
3. Hakki Çerag- jepet për ndihmë të myhibëve (ithtarëve) të cilët janë të nevojshëm.

Në përjashtim të kësaj që u tha bektashinjtë i pranojnë edhe rregullat tjera të praktikës Islame.

## EHL-I BEJTI DHE DYMBËDHJETË IMAMËT

Ehl-i Bejt, në aspektin gjuhësor, do të thotë "anëtarë të familjes". Ndërsa në terminologjinë e shkencave islame termi "Ehl-i Bejt" përdoret për familjen e Pejgamberit a.s..

Termi Ehl-i Bejt përdoret në tri vende në Kur'anin Famëlartë. Në njërin prej tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë flitet për familjen e Pejgamberit a.s.. Në këtë ajet thuhet: " Dhe rini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme, falnie namazin, jepnie zeqatin dhe respektonie All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. All-llahu ka për qëllim që nga ju, o familje [147] e shtëpisë (së pejgamberit), të largojë ndytësinë e mëkateve dhe t'ju pastrojë deri në skaj".

Ebu Xha'fer et-Taberiu në tefsirin e tij "Xhamiu'l-Bejan" ka përcjellë një hadith të Pejgamberit a.s. prej gruas së tij Ummi Selemes[148] ku thuhet: Ummi Selemeja ka thënë: Pejgamberi a.s. ishte pranë meje. Aty ishin edhe Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Huseini. U përgatita diçka për të ngrënë. Hëngrën prej saj dhe ranë të flejnë. Pejgamberi a.s. e hudhi një mbulesë mbi ta dhe tha: O All-llah, ata janë Ehl-i Bejti im, largoji të metat prej tyre dhe bëri të pastër".

Në bazë të transmetimit të sipërpërmendur Pejgamberi a.s. Aliu r.a., Fatimeja, Hasani dhe Huseini janë pesë personat të cilët janë emërtuar si Ehl-i Bejt.[149]

147 Ahzab, 33\33.

148 Ebu Xha'fer Taberi, Xhamiu'l bejan, Kairo, 1323, fq. 22\6.

149 Në literaturën klasike islame ka polemika të shumta në lidhje me atë se kush është prej Ehl-i Bejtit. A hynë në të edhe gratë e Pejgamberit a.s., ose jo? Hyjnë aty axhallarët dhe fëmijët e tyre, ose jo? E kështu me rradhë. Mirëpo, edhe pse në literaturën shiite dhe atë sufite Ehl-i Bejti ka pasur theks të posaçëm në këto pesë veta edhe në literaturën sunnite ky botëkuptim ka qenë prezent, por më tepër në

Në kulturën dhe literaturën bektashiane Ehl-i Bejti është një ndër elementet kryesore. Ai si term përmendet pothuajse në të gjitha poezitë dhe lutjet, si dhe në bisedat e tyre të parët bektashian Ehl-i Bejtin e përmendin si ilustrim të jetësimit të vlerave islame.

Në botëkuptimin bektashian Ehl-i Bejti është grupi (frakcioni) i shpëtuar.[150] Grupi i shpëtuar (firkatu'n-naxhije) i përmendur në hadithin e pejgamberit a.s. sipas bektashinjve është grupi i përbërë prej njerëzve të cilët e duan dhe e ndjekin Ehl-i Bejtin. Ky grup në kulturën bektashiane është emërtuar si "Guruh-i naxhi". Prej këtu del edhe botëkuptimi i tevel-la-së dhe teberra-së që do të thotë: "t'i duash ata që e duan Ehl-i Bejtin dhe të mos i duash ata që nuk e duan Ehl-i Bejtin.

## DYMBËDHJETË IMAMËT

aspektin kulturor dhe folklorik. Ka edhe dijetarë të cilët pohojnë se qëllimi i këtij hadithi nuk është apostrofimi i këtyre personave në aspektin familjar, por në aspektin e njerëzve, të cilët nën ombrelën e sunnetit të pejgamberit në përpikshmëri do të ndjekin urdhërat e tij.

150 Ka një hadith i cili prej Pejgamberit a.s. transmetohet në trajta të ndryshme. Sipas tij, ummeti i Pejgamberit do të përçahet në 73 frakcione. 72 prej tyre do të hyjnë në Xhehennem, kurse vetëm njëra prej tyre që do të ecë në rrugën e Pejgamberit dhe shokëve të tij do të hyjë në Xhennet. Ky është frakcioni ngadhnjyes ( firkatu'n-naxhije). Ndërsa në një transmetim tjetër të këtij hadithi thuhet se muslimanët do të ndahen në 73 frakcione, 72 prej tyre do të hyjnë në Xhennet, kurse vetëm një në xhehennem. Më gjerësisht për këtë hadith shih: E. R. Figlali, Çagimizda Itikadi Mezhepler, fq.17.

Çështja e imamatit (udhëheqësisë), respektivisht e dymbëdhjetë imamëve, paraqet njërën prej problemeve kryesore ndarëse në mes të botëkuptimit sunnit dhe atij shiit. As njëra e as tjetra palë nuk e mohojnë imamatin por shiitët atë e konsiderojnë si domosdoshmëri dhe kusht të besimit, ndërsa sunnitët imamatin e diskutojnë si çështje të lirë të shoqërisë. Imamati, në botëkuptimin shiit, është prezentuar si kusht i besimit dhe si vazhdë e domosdoshme e nubuvvetit (dërgueshmërisë) e cila caktohet nga ana e Fuqisë Krijuese, ndërsa sunnitët atë e kanë konsideruar si çështje e zgjedhjes së lirë të popullatës.[151]

Duke u nisur nga botëkuptimet e këtilla shiitët dymbëdhjetë imamët i kanë konsideruar si pasardhës të pushtetit materialo-kuptimor të Pejgamberit a.s. ndërsa sunnitët ata i kanë respektuar si bij të Pejgamberit a.s. dhe dijetarë të famshëm. Ndërsa, për sa i përket botëkuptimit sufit dhe tarikateve, Aliu r.a. dhe bijtë e tij konsiderohen si bartës të kurorës kuptimore dhe si hallka të zinxhirit sufit dhe aspak nuk hyhet në polemika dhe diskutime rreth çështjes së pushtetit material.

Edhe në kulturën dhe traditën bektashiane dymbëdhejtë imamët janë bartës të velajetit (miqësisë) me All-llahun dhe zënë vend të rëndësishëm. Pothuajse secili

151 Qasjet e ndryshme ndaj problemit të udhëheqësisë në Islam kanë hapur hendekun e madh konfliktuoz në mes të sunnitëve dhe shiitëve. Shiitët duke iu përmbajtur botëkuptimit se udhëheqësia (imameti) përcaktohet nga ana e All-llahut xh.sh. kanë pohuar se udhëheqësi i muslimanëve pas Muhammedit a.s. njëkohësisht edhe imam i parë duhet të jetë Aliu r.a., kurse sunnitët kanë qenë të mendimit se udhëheqësi ( halife, imam) zgjidhet nga ana e popullatës dhe se për këtë Pejgamberi pas vetes nuk ka përcaktuar askend për pasardhës të tij. Ebu Bekri është ai i cili ka fituar votat e muslimanëve në Thekife Beni Seide, thonë sunnitët dhe është bërë udhëheqës i muslimanëve pas Muhammedit a.s..

prej poetëve bektashian ka të shkruara nefese (poezi bektashiane) kushtuar dymbëdhjetë imamëve të ashtuquajtura duvaz, duvaz-imam, duvazdeh-imaman dhe këto nefese lexohen me një respekt të posaçëm gjatë ceremonive bektashiane.

Jeta dhe veprimtaria e dymbëdhjetë imamëve në kulturën dhe folklorin bektashian është prezentuar nëpërmjet të hagjiografive (menkabe). Ne këtu në pika të shkurtëra do të mundohemi t'i prezentojmë ata, duke u bazuar në literaturën burimore për jetën dhe veprën e tyre, por duke pasur parasysh edhe folklorin e bujshëm bektashian për to.

## 1. IMAM ALIU R.A.

Imami i parë dhe kryesuesi i zinxhirit të dymbëdhjetë imamëve është Ali b. Ebi Talibi, halifi i katërt pas Pejgamberit a.s.. Babai i tij ka qenë axha i Pejgamberit a.s. Ebu Talib b. Abdulmutalibi, kurse e ëma e tij është quajtur Fatime binti Esed b. Hashim. Ka lindur në Mekë dhjetë vjet para shpalljes, respektivisht kah viti 600. Aliu r.a. ka banuar në shtëpinë e Pejgamberit a.s. deri në shpërnguljen për në Medine.

Aliu r.a. ka pasur shumë nofka , sa për ilustrim: ai është emërtuar Kerremellahu vexhheh (All-llahu ia ndriçoftë fytyrën) për shkak se asnjëherë nuk i ka adhuruar idhujt. Përveç kësaj është emërtuar si Ebu'l-Hasan, Ebu Turab, Esedullahil Galib, el-Murtada, Hajdar-i Kerrar etj.[152] Në lietraturën klasike shiite dhe bektashiane ka një numër të

152 Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq.167.

madh hagjiografish të cilat flasin për lindjen dhe jetën e tij para shpalljes.[153]

Aliu r.a. është personi i dytë pas Hatixhes r.a. i cili i ka besuar Pejgamberit a.s.. Kur Pejgamberi a.s. filloi të thërret haptazi në fe dhe e tuboi familjen e tij, iu drejtua atyre me këto fjalë: "O bij të Abdulmutallibit, All-llahu më ka urdhëruar që t'ju thëirras në fenë e vërtetë të Tij, në Islam. Kush prej jush do të më ndihmojë në këtë punë?" Të gjithë heshtën, ndërsa më i riu në mesin e tyre Aliu r.a. briti: "Unë, o i Dërguari i All-llahut. Unë do të bëhem ndihmës dhe zëvendësi yt"! Pejgamberi a.s. e ka kap për qafe Aliun r.a. dhe ka thënë: "Ja ky i ri është vëllau, trashëgimtari dhe zëvendësi im në mesin tuaj". Dëgjoni fjalët e tij dhe respektonie atë".[154]

Aliu r.a. prej moshës pesëvjeçare ka qenë pranë Pejgamberit a.s. dhe së bashku me të është munduarr për përhapjen e Fesë Islame. Qëndrimi i tij pranë Pejgamberit a.s. i ka mundësuar që të edukohet prej fjalëve të tij dhe të bëhet njohësi më i mirë i Kur'anit, sunnetit, hallallit dhe haramit. Ai është njëri prej dhjetë personave të përgëzuar me xhennet (ashere-i mubeshshere). Të gjitha burimet islame flasin për devotshmërinë dhe fetarësinë e tij. Aliu r.a. ka qenë mjaft i guximshëm, sa që në momentin kur Pejgamberi a.s. së bashku me Ebu Bekrin r.a. ka marrë rrugën e shpërnguljes për në Medine, ai ka rënë të flejë në shtratin e Pejgamberit a.s. edhe pse e ka ditur se mekasit atë natë do të vinin të vrasin Pejgamberit a.s.. Në vitin e dytë pas hixhretit Aliu r.a. është martuar me bijën e Pejgamberit a.s. Fatimen r.a.. Prej këtij çifti bashkëshortor

153 Muhsin el-Emin, A'janu'sh-Shia, 1\ 323-562; Ibën Shehrasub, Mendubu Al-i Ebi Talib, 1\ 287.

154 Ibën Sa'd, 2\350.

kanë lindur Hasani, Huseini, Zejnebeja dhe Ummu Kulthumi r.a.m.

Aliu r.a. pas shpërnguljes ka marrë pjesë në të gjitha betejat së bashku me Pejgamberin a.s.. Në periudhën e tre halifëve para tij ka respektuar pushtetin e tyre dhe u ka ndihmuar në udhëheqjen e shtetit Islam. Kur ka kaluar vetë në postin e halifit sjelljet e të tjerëve – si Muaviut, Amër b. As'it etj.- nuk kanë qenë si të Aliut r.a. në periudhat e halifëve tjerë. Muaviu nuk e ka respektuar udhëheqësinë e tij dhe falë intrigave të Amër. b. Asit ka arritur të formojë shtet paralel me qendër në Damask. Pas luftës së famshme kundër Muaviut në Siffinë Aliu r.a. në Nehrevan dhe Nuhajle ka luftuar kundër harixhinjve dhe ka vra një numër të madh të tyre. Ata harixhinj të cilët kanë shpëtuar prej këtyre betejave kanë vendosur që të vrasin Muaviun, Amër. b. Asin dhe Aliun r.a. si persona përgjegjës të përçarjes së muslimanëve. Muaviu dhe Amër b. Asi kanë shpëtuar prej atentatit, ndërsa Abdurrahman b. Mulxhem el-Muradi në namazin e sabahut të 15 Ramazanit të vitit 40 e ka plagosur rëndë Aliun r.a. me thikë dhe si rezultat i këtyre plagëve ai ka ndërruar jetë në 17 Ramazan të vitit 40 h. ( 24 Janar 661) dhe është varrosur në Nexhef të Irakut të sotshëm.[155]

155 Abdulbaki Golpinarli, Muminlerin Emiri, 296-99.

## 2. HASANI R.A.

Hasani r.a. është djali i madh i Ali b. Ebi Talibit dhe Fatimes, bijës së Pejgamberit a.s. Burimet thonë se ka lindur në vitin e 3 pas hixhretit (625) kah mesi i Ramazanit. Nofka e tij është Ebu Muhammed. Është martuar shumë herë, kurse familja e tij ka vazhduar me Hasan el Muthenna-në dhe Zejdin.

Hasani r.a. është bërë halif dy ditë pas rënies dëshmor të babait të vet. Pas vdekjes së Aliut r.a. Hasani r.a. ka shkuar në xhami. Njerëzit janë tubuar rreth tij dhe i janë zotuar. Pastaj Hasani r.a. i është drejtuar të pranishmëve: A e dini ç'jeni duke bërë? E vratë të parin e besimtarëve. Falënderimi i qoftë All-llahut që ai ndërroi jetë në natën kur ka zbritur Kur'ani, kur është ngritur Libri dhe kur është tha penda. Gjithashtu edhe Musa b. Imrani dhe Isa b. Merjemi kanë vdekur të njëjtën natë. Kur e kuptoi se është vrarë Aliu r.a., Muaviu përgatiti një ushtri të fortë nën udhëheqjen e Abdullah b. Amirit dhe e dërgoi drejt Kufës. Hasani r.a., me të dëgjuar lajmin për ardhjen e ushtrisë, edhe ai e përgatiti ushtrinë e vet dhe u nis të luftojë kundër Abdullah b. Amirit. Kur arriti deri në Sabat, vërrejti se ushtarët e tij nuk kanë guxim, prandaj u ndal aty dhe mbajti një fjalim : "O ju njerëz! Sot u zgjova me dashuri të plotë ndaj të gjithë besimtarëve. E shoh se edhe ju ndjeheni ashtu. Besoj se nuk do t'i kundërshtoni mendimet e mia. E shoh se shumica prej jush nuk ka dëshirë të luftojë dhe dëshironi t'i ikni luftës. Edhe unë nuk kam dëshirë që t'ju ngarkoj me diçka që nuk e dëshironi". Pas këtyre fjalëve një grup e ka kundërshtuar Hasanin r.a. dhe e kanë sulmuar atë. Ai i plagosur ka arritur deri në Medain dhe i ka filluar përgatitjet për t'u takuar me Abdullah b. Amirin.

Hasani r.a. përgatiti një letër kushtëzuese me të cilën do të pranonte që udhëheqësinë t'ia dorëzojë Muaviut. Kushtet ishin:

1. Muaviu të mos burgosë askend prej irakianëve.
2. Si arabët ashtu edhe joarabët të jenë të sigurtë.
3. Pa marrë parasysh fajin e tyre ushtarët e tij të lirohen.
4. Tatimet e krahinës së Ehvazit t'ia dërgojë Hasanit r.a.
5. Vëllaut të tij Huseinit t'i dërgojë dy milion dirhem në vit.
6. Të shtojë marrëdhëniet me familjen Hashimijje dhe Abdushshems.

Muaviu i ka pranuar këto kushte dhe me dorën e vet e ka nënshkruar marrëveshjen, kurse për dëshmitarë i ka marrë banorët e Damaskut. Pas kësaj Hasani r.a. ia ka dorëzuar fronin Muaviut dhe me familjen e tij është kthyer në Medine.[156]

Me një veprim të këtillë Hasani r.a. ka penguar që të bëhet edhe një gjakderdhje në mesin e muslimanëve, por Muaviu edhe pse e ka nënshkruar marrëveshjen nuk i është përmbajtur në përpikshmëri. Pas kthimit në Medine Hasani r.a. ka jetuar edhe dhjetë vjet dhe në fund (falë intrigave të Jezid b. Muaviut) është helmuar nga ana e gruas së tij Xha'de binti Esh'as b. Kajsit dhe ka vdekur në 28 Safer 49\ 6

156 Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq.191. Në burime tjera përmenden edhe disa kushte të tjera si p.sh. pas vdekjes së Muaviut udhëheqësia t'i kthehet Hasanit r.a. etj.

Prill 669. Ai është varrosur në Xhennetu'l Beki afër nënës së tij, Fatimes r.a.. [157]

## 3. HUSEINI R.A.

Huseini r.a. është nipi më i vogël i Muhammedit a.s. respektivisht djali i dytë i Aliut r.a. . Husein b. Ali b. Ebi Talibi ka lindur në 5 Shaban 4\ 30 Dhjetor 626 në Medine. Atë e kanë thirrur edhe me emrat Ebu Abdil-lah, esh-Shehid (dëshmori) dhe Rejhanetu'n-Nebi ( Buketi me lule i Pejgamberit a.s.). Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ai është zotëriu i fëmijëve të xhennetit". Pejgamberi a.s i ka dashur shumë nipat e tij. Në lidhje me Huseinin r.a. njëherë tjetër ka thënë: "Huseini është prej meje, kurse unë jam prej tij, All-llahu i do ata që e duan Huseinin.".

Dashuria e flaktë e Pejgamberit a.s. ka ndikuar që edhe besimtarët tjerë të ndiejnë dashuri të veçantë ndaj tij. Një ditë përderisa Omeri r.a. ishte duke ligjëruar në hutbe Huseini i vogël del pranë tij dhe i thotë: " Zbrit prej minberit të babait tim dhe shko te minberi i babait tënd". Ndërsa Omeri r.a. ia ka kthyer: "Babai im nuk ka pasur minber" dhe e ka mbajtur pranë vetes deri në fund të ligjëratrës.

Transmetimet flasin se Huseini r.a. ka qenë shumë njeri i ngritur, bujar, i devotshëm. Njëzet e pesë herë ka shkuar në haxh në këmbë prej Medines deri në Mekë.

Në ditët kur kryengritësit e kishin rrethuar shtëpinë e halifit të tretë, Othmanit r.a., Huseini së bashku me vëllaun e tij, Hasanin r.a. ishin caktuar nga ana e Aliut r.a. që të mbrojnë shtëpinë e halifit.

157 E.R. Figlali, Imamijje Shiasi, 84-89; R. Zelyut, po aty, fq. 108-110.

Huseini r.a. në periudhën e udhëheqjes së Aliut r.a. së bashku me familjen është shpërngulur në Kufe. Pas rënies dëshmorë të Aliut r.a.  është zotuar Hasanit r.a. se do ta respektojë udhëheqësinë e tij dhe e ka mbajtur fjalën e dhënë. Kur Hasani r.a. kishte vendosur t'ia dorëzojë udhëheqësinë Muaviut, Huseini r.a pati kundërshtuar, por nuk e ka zgjatur shumë. Në vitin 41\662 ka shkuar në Medine dhe aty ka qëndruar deri kur vdes  Muaviu, në vitin 60\680.[158]

Pas vdekjes së Muaviut ai ka kundërshtuar që t'i zotohet birit të tij Jezidit dhe me ftesën e irakianëve është nisur të luftojë kundër tij, por për fat të keq në 10 Muharrem 61 ( 10 tetor 680) ka rënë dëshmor në Qerbela. Vrasja e tij mizore nga ana e ushtarëve të Jezidit e ka tronditur botën islame dhe nuk është fshirë prej kujtimit të besimtarëve deri në ditët e sotme.

## 4. ALI ZEJNE'L ABIDIN

Ali b. Husein b. Aliu "Aliu i vogël" është biri i Huseinit dhe nipi i Aliut r.a.. Është emërtuar edhe si Ebu'l-Hasan, Zejne'l Abidin ( Stolia e të devotshmëve), Sejjidu's-Saxhidin ( Zotëriu i atyre që bëjnë sexhde). Nëna e tij është bija e mbretit të fundit iranian Jezduxherdit, Shehrubaneja. Ka lindur në Medine më 5 Shaban 38\ 6 Janar 659.

Nuk ka marrë pjesë në luftën e Qerbelasë pasi ka qenë i sëmurë. Guvernatori i Kufës Ubejdullah b. Zijadi i ka dërguar në Damask te Jezidi pesë personat që kanë mbetur gjallë prej familjes së Huseinit r.a.. Jezidi Ali Zejne'l

158 E.R. Figlali, po aty, fq. 90.

Abidinin dhe katër personat tjerë të familjes së tij i ka dërguar në Medine.

Ali Zejne'l Abidini nuk është përzier në tollovitë politike të asaj kohe dhe jetën e ka kaluar duke bërë ibadet dhe duke u ndihmuar të varfërve. Ai ka ndërruar jetë më 22 Muharrem 95\ 17 tetor 713 në Medine dhe është i varrosur në Xhennetu'l Beki.

## 5. MUHAMMED EL-BAKIR B. ALI ZEJNE'L ABIDIN

Muhammed b. Ali është imami i pestë. Ai ka lindur në 3 Safer 57\ 16 dhjetor 676 në Medine, kurse ka ndërruar jetë në 7 Dhilhixhxhe 114\ 28 janar 733. Është emërtuar edhe si Ebu Xha'fer, ndërsa për shkak të njohurive të thella shkencore ka marrë emrin Bakir ( i thelluar në shkencë).

Muhammed el Bakiri si edhe babai i tij Ali Zejne'l Abidini nuk është marrë me politikë dhe i është kushtuar shkencës. Ibni Sa'di në Tabakat'in e tij ka transmetuar një dialog në mes të Muhammed el Bakirit dhe njërit prej shokëve të Pejgamberit a.s., Xhabir b. Abdil-lah el- Ensariut. Xhabiri e ka pyetur Muhammed el Bakirin : A ka dikush në mesin e Ehl-i Bejtit që ka bërë politeizëm? Jo, ia ka kthyer, Imam Bakiri. A ka dikush prej Ehl-i Bejtit që është kthyer pas vdekjes (rixhat)? Jo, i thotë përsëri Imam Bakiri. A ka dikush prej Ehl-i Bejtit që e ka mallkuar Ebu Bekrin dhe Omerin? Jo - ka thënë Imam Bakiri, përkundrazi secili prej nesh i ka dashur ata, ka besuar dhe është lutur për ta.

Imam Bakiri është takuar me shumë autoritete të lëmive të ndryshme të kohës së tij dhe ka bashkëpunuar

me të. Ai ka kontaktuar me Sufjan eth-Theurin, Sufjan b. Ujejnen, Ebu Hanifen etj.[159]

## 6. XHA'FER ES-SADIK B. MUHAMMED EL BAKIR

Xha'fer es-Sadiku është njëri ndër autoritetet më të larta në mesin e dymbëdhjetë imamëve. Ai ka lindur në Medine më 17 Rebiul Evvel 80\ 23 maj 699. Babai i tij është Muhammed el Bakiri, ndërsa nëna është mbesa e Ebu Bekrit, Ummu Ferre Binti'l- Kasim b. Muhammed b. Ebi Bekër es Siddik.

Xha'fer es- Sadiku ka jetuar në epokën e disa halifëve, në epoka me trazira të shumta politike, ai e ka përjetuar transferimin e fronit prej emevitëve te abasidët, por aspak nuk është inkuadruar në to. Ai në kohën e vet i ka larguar të gjitha dilemat rreth personalitetit të Ebu Bekrit dhe Omerit r.a. dhe ka thënë: "Unë jam larg prej atyre që nuk e përmendin me fjalë të mira Ebu Bekrin dhe Omerin"[160]

Shehristani mes tjerash, për Xha'fer es-Sadikun thotë: "Ai ka qenë dijetar i madh në fe dhe filozofi. Nuk ka qenë i dhënë pas lakmive të kësaj bote, ishte asket. Në Medine ka qëndruar aq sa për t'i mësuar shokët dhe nxënësit e tij me sekretet e shkencës. Pastaj ka shkuar në Irak. Asnjëherë nuk ka dashur të bëhet udhëheqës e as që është marrë me çështje të këtilla…".

Shtëpinë e Xha'fer es-Sadikut në Medine e kanë vizituar njerëz nga të gjitha anët e botës islame. Në mesin e nxënësve të tij shquhen Ebu Hanifeja, Malik b. Enesi,

159 Muhammed Ebu Zehre, El-Imam es-Sadik, fq. 22-23.
160 Shehristani, el-Milel ve'n-Nihal, 1\166.

themeluesi i mutezilëve Vasil b. Atau, kimisti I njohur Xhabir b. Hajjani.

Në mesin e shiitëve, Imam Xha'feri konsiderohet si kodifikues i shkollës juridike xhaferite.

Xha'fer es-Sadiku ka ndërruar jetë në Medine më 25 Shevval 148\ 15 dhjetor 765 dhe është varrosur në Xhennetu'l Beki.

## 7. MUSA EL KAZIM B. XHA'FER ES-SADIK

Imami i shtatë Musa b. Xha'feri ka lindur në 7 Safer 128\ 8 nëntor 745 në vendin e quajtur Ebra në mes Mekës dhe Medinës.

Prej lindjes e deri në vdekjen e babait të tij ka qëndruar pranë babait në Medine. Musa el Kazimi ka jetuar në periudhën e katër halifëve abbasit, duke filluar prej el-Mensurit e deri në periudhën e Harun er-Reshidit. Edhe pas vdekjes së babait të vet nuk është inkuadruar në politikë, mirëpo halifi el-Mehdi ka dyshuar në të, e ka marrë prej Medinës dhe e ka burgosur në Bagdad. Pas el-Mehdiut atë e ka burgosur edhe Harun er-Reshidi. Ka ndërruar jetë në Bagdad më 1 shtator 799.

Imam Musa el Kazimi ka qenë dijetar, asket, i devotshëm, i butë, bujar dhe shpirtgjerë.

## 8. ALI ER-RIDA B. MUSA EL KAZIM

Imami i tetë Ali er-Rida ka lindur në 11 Dhilka'de 148\ 29 dhjetor 765. Ali er-Rida ka qenë person tepër i devotshëm; ka transmetuar shumë hadithe dhe ka

mbajtur ligjërata në xhaminë e Pejgamberit a.s.. Një pjesë të madhe të jetës e ka kaluar jashtë politikës, por në vitin 201\816 është inkuadruar në politikë. Në këtë vit halifi el-Me'muni e ka thirrë atë që të vijë në Merv dhe e ka caktuar për trashëgimtar të fronit të tij dhe prej këtij viti në monedhat është shkruar edhe emri i tij.

El-Me'muni i ka tubuar 33 mijë abasit në Merv dhe në praninë e tyre ka deklaruar se Ali er-Rida është personi më adekuat në mesin e popullatës për trashëgimtar të tij. El-Me'muni Ali er-Ridasë ia ka dhënë vajzën e tij, dhe në këtë kohë flamujt e zi të abasidëve janë zëvendësuar me të gjelbërt.

Ali er-Rida ka ndërruar jetë në 29 Safer 203\ 5 shtator 818 dhe është varrosur në katundin Senebad të Tusit. Ky vend sot është i njohur me emrin Meshhed.

## 9. MUHAMMED ET-TAKI (EL XHEVAD) B. ALI ER-RIDA

Imami i nëntë Muhammed b. Ali ka lindur në Ramazan 195\ qershor 811, në Medine. Halifi abasit i dëshpëruar tepër për vdekjen e Ali er-Ridasë, djalin e tij tetëvjeçar Muhammed et-Takiun e ka thirrë prej Medines dhe e ka martuar me të bijën e tij Zejneben në vitin 215\830.

Dy vjet pas martesës ata janë vendosur në Medine. Ai, si edhe gjyshërit e tij në Medine, është marrë me shkencë, devotshmëri dhe jetë askete. Pas vdekjes së el Me'munit atë e ka trashëguar el-Mu'tasimi, i cili Muhammed et-Takiun e ka thirrë në Bagdad, ku edhe ka ndërruar jetë në 30 Dhilka'de 220\ 25 nëntor 835.

## 10. ALI EN-NAKI (EL HADI) B. MUHAMMED ET-TAKI

Ali b. Muhammed et-Taki është imam i dhjetë. Ka lindur në 15 Dhilhixhxhe 212\ 7 mart 828 në Medine. Ai ka qenë i njohur edhe me nofkat Ebu'l Hasan el- Askeri, el Hadi dhe en-Naki.

Ali en-Naki është rritur në Medine dhe aty është marrë me shkencë. Tek ai në Medine kanë ardhur shumë njerëz nga të katër anët e botës për të dëgjuar ligjërata. Në periudhën e halifëve el-Mu'tasim dhe el-Vathik ai ka jetuar i qetë. Në kohën e halifit el Mutevekkil shtëpia e tij është bastisur nga policia dhe ai është detyruar të jetojë në Samarra. Ali en-Nakiu ka qëndruar 29 vjet në këtë qytet. Ai ka vdekur në 3 Rexheb 254\ 28 qershor 868 në Samarra dhe është varrosur në shtëpinë e tij.

## 11. HASAN EL ASKERI B. ALI EN-NAKI

Imami i njëmbëdhjetë Hasan el Askeri ka lindur në 8 Rebiu'l Ahir 232\ 2 dhjetor 846, në Medine. Ai është thirrur si Hadi, er-Refik, edh-Dheki, en-Naki por nofka më e famshme e tij është "el Askeri" për shkak se ka banuar në një lagje të banuar me ushtarë në Samarra.

Hasan el Askeriu në moshën dyvjeçare ka ardhur në Samarra dhe aty është rritur. Ai ka qenë shumë i ngritur dhe ka ditur shumë gjuhë të huaja.

Imam el Hasan el Askeriu ka ndërruar jetë në 8 Rebiu'l Evvel 260\ 2 janar 873, në Samarra.

## 12. MUHAMMED EL MEHDI B. HASAN EL ASKERI

Imami i dymbëdhjetë dhe i fundit Muhammed ibën Hasan ka lindur në 15 Shaban 255\ 30 korrik 869, në Samarra.

El- Mehdiu është emërtuar me shumë emra, si p.sh.: Ebu'l Kasim, Sahibu'z-Zaman (Pronar i Kohës), el Kaim (Qëndrues), El-Huxhxhet (Provë), el Muntadhar (i pritur). Pas përmendjes së Imamit të dymbëdhjetë thuhet "axh-xhelall-llahu ferexhehu" ( All-llahu e shpejtoftë paraqitjen e tij).

Nuk ka të dhëna në lidhje me jetën e el-Mehdiut, por në burime të ndryshme thuhet se pas vdekjes së babait të tij është humbur, ende është gjallë dhe para se të bëhet kijameti do të paraqitet dhe do ta rivendosë drejtësinë në fytyrë të tokës.

* * *

Në literaturën bektashiane përveç dymbëdhjetë imamëve përmenden edhe emrat e katërmbëdhjetë të pagabueshmëve (Masum). Këta persona janë fëmijë të imamëve të cilët kanë vdekur para se të hyjnë në moshën madhore. Emrat e tyre janë:

1. Muhammed Ekber b. Ali b. Ebi Talib
2. Abdullah b. Hasan b. Ali
3. Abdullah b. Husein b. Ali
4. Kasim b. Imam Husein
5. Husein b. Zejne'l Abidin
6. Kasim b. Zejne'l Abidin
7. Alijju'l Eftar b. Muhammed el Bakir

8. Abdullah el Asgar b. Xha'fer es-Sadik
9. Jahja el Hadi b. Xha'fer es- Sadik
10. Salih b. Musa el Kasim
11. Tajjib b. Musa el Kazim
12. Xha'fer et-Tahir b. Muhammed et-Taki
13. Xha'fer b. Hasan el Askeri
14. Kasim b. Alijji'n-Naki.[161]

## 4. KATËR DYERT E KATËRDHJETË MAKAMËT

Katër dyert e përmendura në "Makalat"- in e Haxhi Bektash Veliut janë komentuar në mënyra të ndryshme. Ja disa prej tyre:

"Sheriati i përmban vendimet e Muhammedit a.s., tarikati është punë e fesë, hakikati është sjellje në rrugën e drejtësisë dhe ma'rifeti është kusht i besimit të drejtë".[162]

"Sheriati i takon botës së dukshme, tarikati i takon botës shpirtërore, ma'rifeti botës së engjujve kurse hakikati botës së qenësisë absolute. Më saktë, sheriati është erë, tarikati zjarr, ma'rifeti ujë, ndërsa hakikati dhe".

Te bektashinjtë sheriati është lindje prej nënës, tarikati do të thotë zotim (besëlidhje), ma'rifeti njohje e un-it, hakikati shfaqje e të vërtetës në un-in njerëzor.[163]

Shkurt thënë, katër dyert prezentojnë shkallët e përsosshmërisë shpirtërore dhe secila prej tyre e plotëson njëra-tjetrin. Asnjëra prej tyre nuk mundet pa tjetrën.

Në "Makalat" krahas katër dyerve përmenden edhe katërdhjetë makamet. Ato janë :

Makamet e Sheriatit:

161 H. Kaja, Bektasi Ilmihali, fq. 30-31.
162 Tam ve Hakiki Buyruk, f. 105.
163 B. Nojan, Bektasilik Alevilik Nedir, fq. 218.

1. Besimi
2. Dituria
3. Ibadeti
4. Largimi prej haramit
5. Sjellje e mirë ndaj familjes
6. Mosdëmtimi i mjedisit jetësor
7. Ndjekja e urdhërave të Pejgamberit
8. Shpirtgjerësia
9. Pastërtia
10. Largim prej punëve të liga.

Makamet e Tarikatit:

1. Pendimi
2. Respekti ndaj dëshirës së udhërrëfyesit
3. Veshja e mirë
4. Përpjekja për të mirë
5. Shërbimi
6. Frika prej padrejtësisë
7. Mosrrënia në pesimizëm
8. Mësimi
9. Ndarja e begatisë
10. Njohja e pamundësisë së un-it.

Makamet e Ma'rifetit:

1. Edukata
2. Zhveshja prej masivasë (gjërave pos Zotit)
3. Ngrënia pak
4. Durimi dhe pëlqimi
5. Turpi
6. Bujaria
7. Dituria
8. Toleranca
9. Njohja e vetvetes

10. Njohja (Gnosa).

Makamet e Hakikatit:

1. Modestia
2. Mosshfaqja e gabimeve të huaja
3. Veprimi i tërë të mirave që i ke në duar
4. Dashuria ndaj krijesave të Zotit
5. Mosdallimi i njerëzve
6. Kahëzimi drejt unitetit
7. Mosfshehja e realitetit
8. Njohja e kuptimit
9. Mësimi i sekretit
10. Arritja në qenësinë e All-llahut.[164]

Bektashinjtë në jetën e tyre fetare kanë edhe "tre sunnetet dhe shtatë farzet". Ato janë:

Tre Sunnetet:

1. Gjithmonë të kihet parasysh fjala e All-llahut dhe pandërprerë të përsëritet kelime-i tevhidi.
2. Largimi i armiqësisë prej zemrës.
3. Të respektohet çdo urdhër i tarikatit.

Shtatë Farzet:

1. Ithtarët e tarikatit duhet të mbrojnë rrugën e tyre.
2. Moskthimi prej të vërtetës edhe me çmim të jetës.
3. Mospërfillja e jetës së kësaj bote.
4. Pendimi para halifes.
5. Zbatim i urdhërave të halifes.
6. Veshja e mantelit (hërkës) prej halifes
7. Vënia e kurorës (taxhit) prej halifes.

164 Xh. Ulusoj, Po aty, fq. 216-18.

Në literaturën bektashiane ekzistojnë edhe dymbëdhjetë farze në lidhje me jetën dhe veprën e ithtarëve bektashian:

1. Respekti i plotë ndaj urdhërave të Muhammedit a.s.
2. Mosnënçmimi i njerëzve pa të drejtë.
3. Sjellja me shpirtgjerësi dhe edukatë ndaj njerëzve.
4. Sjellja fisnike me të gjithë.
5. Nënshtrimi në pëlqimin e All-llahut.
6. Mbështetja e plotë në All-llahun.
7. Durimi në fatkeqësitë.
8. Kujdesi në marrëdhëniet ndërnjerëzore.
9. Pajtimi me furnizimin (rizkun) e All-llahut.
10. Mosbrengosja për furnizim.
11. Vetmia, largimi prej popullatës.
12. Talibi (kërkuesi) duhet të ketë kapital të drejtësisë.

## RITUALET (LUTJET) DHE FESTAT BEKTASHIANE

Tarikati bektashian është një rugë mistike e paraqitur dhe e zhvilluar në suaza të Fesë Islame dhe traditës sufite. S'ka dyshim se të gjitha festat e përgjithshme islame- si bajramet, nata e mi'raxhit, e kadrit etj.- njëkohësisht janë edhe festa bektashiane.

Krahas këtyre festave, tarikati bektashian ka edhe ditë të shënuara specifike - Matemi i Muharremit, Sulltan Nevruzi- me të cilat janë të ndërlidhura edhe shumë lutje dhe rituale bektashiane. Për të qenë më sistematik, ne krahas festave do të përmendim edhe lutjet dhe ritualet e posaçme që bektashinjtë i bëjnë gjatë tyre.

Matemi i Muharremit.- Siç përmendëm edhe më lartë në 10 Muharrem të vitit 61 të hixhretit në vendin e quajtur Qerbela ka rënë dëshmorë nipi i Pejgamberit a.s.dhe djalë i Hazreti Aliut, Huseini r.a..

Rasti i vrasjes mizore të Huseinit r.a. ka qenë ngjarje pikëllimi për të gjithë muslimanët gjatë historisë, por në veçanti është manifestuar nga ana e tarikateve të ndryshme dhe shiitëve.

Edhe pjesëtarët e tarikatit bektashian në muajin Muharrem mbanë zi (matem) për dëshmorët e Qerbelasë dhe gjatë kësaj periudhe lexohet kryesisht vepra "Hadikatu's-Suada" ( Kopshti i të Lumturve ) e shkruar nga Fuzuliu. Përveç këtij libri në bisedat e tyre lexohen edhe elegji të shkruara për vrasjen e Huseinit r.a. nga ana e poetëve të ndryshëm të botës islame.

20 ditë pas Kurban Bajramit (10 Dhilhixhxhe) fillohet me agjërimin e Muharremit. Vendosja për këtë agjërim bëhet kështu: "Bism-i Shah!... All-llah, All-llah! Për hirë të të ngriturve. Për hirë të Muhammedit dhe Aliut. Për hirë të etjes së Imam Huseinit, për hirë të shpirtave të pastër të dëshmorëve të Qerbelasë, për shefaat të Fatime-i Zehrasë, për nderë të dymbëdhjetë imamëve. Katërmbëdhjetë të pagabueshmëve dhe shtatëmbëdhjetë kemerbestëve vendosa të agjëroj. Ndihma e të ngriturve që janë dhe nuk janë prezentë le të jetë me ne. Të ligat qofshin larg nesh, mallkim mbi Jezidin, mëshira për besimtarin All-llah, ejvAll-llah, Huuu."

Ky agjërim vazhdon dhjetë ditë dhe paraqet një solidarizim me të shtypurit kundër shtypësve. Gjatë matemit bektashinjtë kur e takojnë njëri tjetrin përshëndeten me "Ja Imam", kurse përgjigjeja është "Ja Husein". Në dhjetë ditët

e Muharremit nuk pritet kurban. Bektashinjtë gjatë matemit nuk rruhen, nuk kanë marrëdhënie intime me gratë, nuk zbaviten dhe nuk bëjnë dasma.

Në ditën e dhjetë të Muharremit, respektivisht ditën e ashures, përgaditet një ëmbëlsirë e posaçme që quhet " ashure". Ashureja në shumë vise të botës i ka tejkaluar kufijtë e tarikatit dhe përgaditet nga të gjithë besimtarët muslimanë, qofshin në tarikat ose jo. Ashureja e përgatitur u ndahet të varfërve dhe fëmijëve. Ashureja e cila përgatitet në teqetë bektashiane i ndahet popullatës së gjerë. Në disa teqe ditën e dhjetë të Muharremit mbahet edhe "Rituali i Xhem'it".

Gjatë ditëve të para të Muharremit, para dhe pas ngrënies së ashures lexohen tekste mllefi, bëhen lutje të posaçme dhe lexohen salavate. Për shkak të karakterit të librit ne do të përmendim nga një prej tyre:

"Bismi Shah, All-llah All-llah! Bismi Shah, ismi Shah... Esselam alejk ja Eba Abdullah... Esselam alejk ja ibëni resulullah... Esselam alejk ja ibëni Alijjel Murtada... Esselam alejk ja ibëni Hadixhedul Kubra. Esselam alejk ja ibëni Fatimetez-Zehra... Esselam alejk ja ehi Hasan hulku'r - Rida-Selamullah ala ehle'l Husein ve ala etbai Husein.

"Munaxhat"

"All-llahume'lan alel Jezid ve ala kavmi Jezid ve etbai Jezid... Lanet el an lanet. Ta ki enxham –i zaman lanet. Ubejdullah ibën Zijadit lanet. Lanet ibën Mulxhemit, lanet Sa'd dhe Shimr Dhul Xhevshenit... Lanet ala ehli Sufjan ve ehli Mervan ila jevmil kijame. Lanetullahi ala kavmidh-dhalimin... Rahmetull-llahi ala kavmil mu'minin, ja Imam

Husein... All-llah EjvAll-llah. Tekabbel minna bi hakki Muhammedin ve Hajdar... Hu dost.[165]

"Salavat"

"Esselamu alejk ja shemsul kamer... esselamu alejk ja bedrud- duxha, esselamu alejk ja Muhammed ja Ali... Ja sejjid Musa er-Rida ve rahmetullahi ve berekatuhu... Esselamu alejk ja Sahibu'z-Zeman...esselam alejke ja Halifetu'r-Rahman... Ve rahmetull-llahi ve berekatuhu. Ejvall-llah.".

"Lutja e Matemit"

Kërkoj ndihmën e All-llahut prej shejtanit të mallkuar. Fillova me emrin e All-llahut, Bëmirësit, Mëshirëbërësit. Falënderimi qoftë mbi All-llahun i cili na urdhëroi të duam të Dërguarin e Tij Muhammedin dhe familjen e tij. O Zot, mbushi zemrat tona me dashuri ndaj Muhammedit dhe pjesëtarëve të familjes së tij. Stolisi shpirtat tonë me këtë dashuri. O Zot, na bën të tillë që prej neve të jenë të kënaqur Muhammedi a.s., familja e tij dhe dëshmorët e rënë në këtë rrugë. O Zot, na mundëso që zotëriu dëshmorëve, Hazreti Huseini, të bëjë shefaat për ne. Ve Sal-l-all-llahu ala sejjidina Muhammedin ve lihi ve sahbihi exhmein. Vesselamun alel murselinë , ve'l hamdulillahi rabbil aleminë".

"Evradi ( Përkujtimi) i muajit Muharrem"

Ditën e parë 60 herë Ja All-llah

Ditën e dytë 989 herë Ja Hafidh

Ditën e tretë 110 herë Ja Ali

Ditën e katërt 111 herë Ja Kafi

Ditën e pestë 132 herë Salavat

Ditën e gjashtë 72 herë Ja Basit

165 Më gjërësisht shih: Bedri Nojan, Po aty. f. 160.

Ditën e shtatë 308 herë Ja rezzak
Ditën e tetë 131 herë Ja Selam
Ditën e nëntë 20 herë Ja Vedud
Ditën e dhjetë 94 herë Ja Aziz.

Nevruzi

Nevruzi është festë e madhe e bektashinjve. Ditën e Nevruzit në mëngjes bëhet "Rituali i Nevruzit" dhe gjatë kësaj dite lexohen nefese, poezi të cilat quhen "nevruzije". Mbrëmjen e ditës së Nevruzit hapet "mejdani" dhe ata që dëshirojnë të inkuadrohen në tarikatin bektashian marrin dorë (nasib).

Nevruzi festohet për çdo vit më 21-22 mars dhe ka disa shkaqe për festimin e tij:

1. Është ditëlindje e Hazreti Aliut.
2. Është ditë e kurorëzimit të Hazreti Aliut me Fatime Zehranë.
3. Është dita e dërgueshmërisë së Muhammedit a.s..
4. Është dita e mbarimit të dimrit dhe fillimit të verës.

Ritualet e Nevruzit

Një natë para Nevruzit 366 herë thuhet "Ja Mukal-libel kulub vel ebsar ve ja Mudebbirel-lejli ven-nehar. Ja muhavvilel havli vel ahval havvil halena ila ahsenil hal". Pas kësaj bëhet lutja që vijon: O Zot, m'i plotëso dëshirat! Për hirë të të Dërguarit tënd Muhammed Mustafasë, për hirë të zotëriut të evlijave Hazreti Alijjul Murtadasë… O Ali guximtar besimi dhe fuqia e jonë është në rrugën tënde. .. Na i mbulo të metat, na i fal mëkatet, o Zot. O bëmirës dhe mëshirues pranoji lutjet e mia për hirë të Pejgamberit dhe të afërmëve të tij".

Në mëngjes të ditës së Nevruzit hyhet në dhomën e Mejdanit. Secili ulet në vendin e vet. Myrshidi (udhërëfyesi) i ulur në vendin e vet thotë:

"Bismi Shah All-llah All-llah. Ja Muhavvilel havli vel ahval havvil halena ila ahsenil hal. Ja Mukallibel kulubu vel ebsar! Ja Mudebbirel-lejli ven-nehar! Ilahi bi hakki Hajdari Kerrar… Nevruzu Sulltan, zuhuru ehli iman, bi hakki Shahi Merdan … Ja Muin, All-llah . Dost… Hu…".

Pas kësaj lutjeje myrshidi (babai ) dhe të pranishmit ngrihen në këmbë. Babai qëndron në postin e vet kurse dy dervishët përreth mbanë nga një kandil në dorë. Babai thotë: Bismi Shah All-llah All-llah! Bel-legani muradi bi hakki Muhammedil Mustafa nebijjike ve bi hakki Alijjil Murtada velijjikel ahjar. Ja Ali Duldulsuvar, alejke i'timadi ve minkel i'tikadi vel iktidari. Ustur ujubena, vagfir dhunubena, Ja Settar, Ja Gaffar… Bi hurmetil Ahjar ve as'habikel muhtar . Salavatull-llahi alejhim exhmein".

Pas këtyre fjalëve të babait, duke qëndruar në këmbë, lexohet një "nevruzije" . Sa për ilustrim do të përmendi një tekst të një nevruzijeje së bashku me përkthimin në shqip:

I

Bugün Sultan-ý Nevruz-ý Alýdýr
Fuyuzat-ý eyel hep muncelidir
Esen bad-ý heva cennet yelidir
Erýþtik subh-ý fýruz-i safaya
Selam verdýk Alýyyel Murtadaya.

Sot është Sulltan Nevruzi Ali
Pandërprerë përfaqësohen inspirimet eterne
Era e lehtë që frynë është e Xhennetit
Arritëm në natën e ngadhnjimit dhe pastërtisë

Selam i dhamë Ali Murtadasë

II

Harem-i Kabede Þah-ý Vilayet
Bugün piraye bahþ oldu výlayet
Bugün idi þeref buldu hilafet
Isabet etti sadalari fezaya
Selam verdik Alýjjel Murtazaya.

Në Haremin e Qabes Mbreti i Evlijave
Sot të ngriturve iu dhurua miqësia
Sot nderë gjeti hilafeti
Zëri i tyre arriti deri në gjithësi
Selam i dhamë Ali Murtadasë.

III

Bugündür aþýkana hacc-ý ekber
Salat-u savma kafi zikr-i Hayder
Peyapey badeden saki zekat ver
Namazý meyle uðrattýk kazaya
Selam verdik Aliyyel Murtazaya.

Sot për të dashuruarit është haxhxhi më i madh
Për namazin dhe agjërimin mjafton përkujtimi
i Hajdarit
O shërbyes, ndaj pandërprerë prej verës së dashurisë
Për shkak të verës (së dashurisë hyjnore) namazi
na mbeti kaza
Selam i dhamë Alijjul Murtadasë.

Pas këndimit të "nevruzijes" me shenjën e Baba efendiut shërbyesi, duke filluar prej babait, fillon të ndajë

qumësht. Gjatë shërbimit me qumësht të pranishmit një-zërit thonë:

"Inne fil Xhenneti nehrun min lebenin
Li Alijjin ve Huseinin ve Hasanin"
"Në Xhennet ka një lumë prej qumshti
Për Aliun, Huseinin dhe Hasanin".

Pas kësaj babai dhe muhibët ulen. Babai fillon të këndojë një gylbank.[166] Sa për ilustrim të përmendim një tekst të gylbankut:

"Bismi Shah, All-llah All-llah! Nevruz-u Sulltan, mevlud-u Shah-i merdan… Sipas-u shukru Jezdan. Tulu-i afitab-i xhihan, burak-i nar-u asuman, ijdel ejjam-i nishan. Surur-u ihvan ve ehli iman hurremu shadu handan… Bezmi xhemi ehlullah kushade i mejdan, ixhraji erkan. Kul-lu jevmin Huve fi she'n.

All-llah All-llah. Motet le të jenë të mira, le të mbretërojnë të mirat, le të shmangen të ligat. Të ngriturit le të bekojnë vitin tonë të ardhshëm. Mejdani ynë le të jetë plot hare, zemrat të lumtura. Hakk Muhammed Aliu le të jetë gjithmonë në Mejdanin tonë. Bëni të mbara punët tona dhe sendërtoji shpresat tona. Shpata dykrerëshe e Ali Hajdarit le të jetë mbi kokën e dyftyrëshve dhe armiqve të dervishëve. Mallkim për Jezidin, mëshirë për besimtarët. Hu për hirë të dervishëve që janë dhe që nuk janë prezentë."

Në fund të gylbankut të gjithë thonë "Hu" dhe me këtë mbaron rituali. Pas ritualit të gjithë ia urojnë njëri tjetrit Nevruzin.

166 Gylbanku është lutje bektashiane e cila nga ana e babait lexohet me zë të lartë, kurse muhibët duke e ndjekur thonë " amin" . Në fund të lutjes babai thotë " Të thuam Huuuuu", kurse muhibët njëzërit të gjithë thonë "Huuuuu".

## RITUALI I INKUADRIMIT NË TARIKATIN BEKTASHIAN (AJNU'L-XHEM', ERKAN-I IKRAR)

Personi i cili ka dëshirë të inkuadrohet në tarikatin bektashian (talib) piksëpari nëse nuk është musliman bëhet musliman, duhet të jetë në moshën madhore, të ketë ardhur me vetëdëshirë , të jetë i mençur dhe i shëndoshë, pa të meta fizike. Pasi që të hyjë në tarikatin bektashian personi duhet të ndjekë urdhërat dhe rekomandimet e udhërrëfyesit.

Personat që marrin dorë (nasib) në të njëjtin ritual emërtohen si musahib (vëllezër të rrugës). Ata bëhen të afërt me njëri tjetrin ashtu si ishte Hazreti Muhammedi me Aliun r.a.. Talibi gjatë hyrjes në dhomën e Mejdanit i hjek stolitë e arta dhe gurët e çmueshëm.

Gjatë ritualit (ajnul xhem') në tryezën e dashurisë (muhabbet sofrasi) ka dymbëdhjetë shërbime: 1. Rehberi (babai) udhëheqësi i ritualit nëse nuk është prezent gjyshi (dede). 2. Berberi 3. Ferrashi, ndihmës i babait 4. Dhakiri , personi që i lexon nefeset. 5. Sofraxhiu, merret me çështjet e ushqimit. 6. Ibrikdari, shërbyesi I ujit. 7. Saki, shërbyes me qumsht. 8. Mejdanxhiu 9. Mbajtësi i rendit 10. Pervane, pjesëmarrësit e vallëzimit mistik. 11. Çeragxhi, ndriçuesi i mejdanit. 12. Portieri, qëndron në derën e dhomës së mejdanit.

Një ditë para ritualit mejdanxhiu e pastron dhomën, i shtrinë postaqitë. Sakiu i përgatit gotat e sherbetit. Përgatiten qirinjtë. Pastrohen enët e miskut. Në të njëjtën kohë përgatitet edhe kurbani. Personi i cili do të merr dorë ( nasib) pastrohet, vesh teshat e pastra dhe merr abdest me rekomandimin e udhërrëfyesit.

Marrja e abdestit bëhet me kontrollin e udhërrëfyesit dhe gjatë larjes së çdo pjese të trupit talibit i rekomandohet nga një lutje e posaçme.

Rituali i inkuadrimit, gjegjësisht zotimit për hyrje në tarikatin bektashian, përmban dymbëdhjetë pjesë që quhen erkane, edhe atë:

1. Erkani i parë - hyrja në dhomën e mejdanit.
2. Erkani i dytë - aromatizimi i dhomës.
3. Erkani i tretë- pyetjet e udhërrëfyesit (myrshidit) ndaj talibit (kandidatit).
4. Erkani i katërt - zgjimi (ndezja) e kandilëve (qirinjve).
5. Erkani i pestë- falja e namazit nga ana e talibit.
6. Erkani i gjashtë- afrimi i talibit nga ana e rehberit te myrshidi.
7. Erkani i shtatë- rehberi talibin ia dorëzon myrshidit.
8. Erkani i tetë- sugjerimi i myrshidit që talibi të pendohet.
9. Erkani i nëntë- myrshidi e kthen talibin te rehberi.
10. Erkani i dhjetë – rehberi talibit ia tregon makamet (gradat).
11. Erkani i njëmbëdhjetë- ndarja e sherbetit
12. Erkani i dymbëdhejtë- pastrimi i Mejdanit dhe përfundimi i erkanit.

Në fund udhëheqësi i ritualit e lexon një gylbank të gjatë dhe me të përfundon rituali në tërësi.[167]

---

167 Secili prej erkaneve ka kushtet, lutjet, poezitë e posaçme që në detaje janë të prezentuara në librat klasike bektashiane si dhe në shumë prej fletoreve të baballarëve të ndryshëm të cilat i kam hasur në teqe të ndryshme në Turqi dhe me gjerë.
Tekstet e mësipërme kryesisht janë të marra prej shënimeve të baballarëve të ndryshëm, por ata në detaje janë prezente edhe në librin " Bektasilik Alevilik Nedir" të Bedri Nojanit.

## ETIKA- MORALI NË TARIKATIN BEKTASHIAN

Tesavvufi si sistem i jetës në suazat e veta ka të parapara rregulla me të cilat sistematizohet jeta e pjesëtarëve të tij. Tarikati bektashian, si një prej hallkave të zinxhirit të tesavvufit, në veçanti është marrë me problemin e etikës a moralit të muhibëve të vet. Si rezultat i këtij kujdesi të madh është prezentuar motoja " kujdes në dorën, belin dhe gjuhën" ( eline,dilin, beline sahip olmak). D.t.th. kujdes që duart të mos prekin në çështje të ndaluara, epshi të mos orientohet kah e ndaluara dhe gjuha të mos flasë gjëra të ndaluara.

Gjatë ritualit të zotimit kur talibi ulet pranë myrshidit, ai ia sugjeron këto fjalë:

Myrshidin ta konsiderosh si baba të vërtetë , kurse rehberin si nënë. Mos gënje. Mos ha haram. Mos përgojo. Mos u bën tepër i dhënë pas epshit. Bëhu pronar i duarve, belit dhe gjuhës. Mos kij zili ndaj askujt. Mos u bën kryelartë dhe mos urrej. Mos u hidhëro dhe mos u inatos. Mbuloje atë që e sheh, mos e fol atë që nuk e sheh. Mos u ngjit për atë që nuk është e ytja. Mos e zgjat dorën ku nuk të mbërrinë. Mos ço fjalë aty ku nuk të ecë fjala. Shiko për shembull, fol me butësi. Bëhu shpirtgjerë ndaj të vegjëlve, kurse ndaj të rriturve sillu me respekt. Zotimin ta kesh të sinqertë. Të vërtetën kërkoje në esencën tënde. Ki njohuri për sekretet e të ngriturve".[168]

Çdo bektashi duhet t'u përmbahet kushteve të lartë-përmendura me dëshirë të lirë dhe pa dhunë. Nëse nuk i përmbahet zotimit dhe del prej rruge atëherë ai proklamohet si "i rënë" (dyshkyn) prej rruge. Para se të

168 E.R. Figlali, Turkiyede Alevilik Bektasilik, fq.373.

largohet prej rruge fajtorit i tërhiqet vërejtja disa herë, nëse përsëri vazhdon atëherë dënohet.

Në mesin e gjërave që janë të ndaluara sipas etikës bektashiane, mund të përmenden: padrejtësia, përgojimi, veprimi pa dije, moskryerja e obligimeve, spiunimi, falli, avantura, fajësimi i njerëzve të mirë, tradhëtia, dallimi në mes të të ngriturve, rrena, bixhozi, hajnia, alkooli etj.

Për secilin prej mëkateve që e dëmtojnë jetën brenda tarikatit bektashian janë të parapara dënime adekuate p.sh. Në vjedhje paguhet dyfish sasia e vjedhur dhe personi tre muaj largohet prej tarikatit.

## ORGANIZIMI NË TARIKATIN BEKTASHIAN

Institucionalizimi i tarikatit bektashian ka filluar me themelimin e Teqesë së Haxhi Bektash Veliut në Suluxha Karahojuk (Haxhi Bektashi i sotshëm) dhe me lidhjen e teqeve tjera të themeluara për të.

Teqeja e Haxhi Bektash Veliut është një kompleks i përbërë prej disa ndërtesave me funkcione sakrale dhe sociale, edhe atë: gjelltore (ashevi), dhoma e bukëpjekjes, dhoma e mysafirëve (mihman evi), shtalla (at evi), mejdani, dhoma për pastrimin e teshave. Në këtë kompleks ekzistojnë edhe ndërtesat e Ballëm Sulltanit, kopshti i hanit dhe kopshti i gjyshit. Në krye të secilës prej këtyre ka qëndruar një baba.

Përveç teqesë së Haxhi Bektashit ka pasur edhe katër teqe të mëdha, respektivisht katër qendra të rëndësishme ( asitane), edhe atë:

1. Teqeja e Sejjid Ali Sulltanit në Dimetokë.
2. Teqeja në Qerbela

3. Teqeja e Abdall Musës në Tekkekoj dhe
4. Teqeja e Kajgusuz Abdallit në Kairo.

Bektashinjtë brenda tarikatit të tyre janë të organizuar në grada të posaçme (makame) të cilat caktohen sipas ngritjes shpirtërore dhe shërbimit në teqe të ithtarit bektashian. Ata janë:

1. Ashik
2. Muhib
3. Dervish
4. Baba
5. Myxherred
6. Halife
7. Dede (Gjysh)

Grada e parë e personit i cili e viziton teqenë bektashiane siç u pa më lartë është ashik (talib), që d.t.th. person i cili interesohet, ndien simpati për këtë tarikat por ende nuk ka marrë dorë (nasib, nuk është zotuar).

Grada e dytë është muhib. Personi i cili ka marrë dorë prej një babai bektashian quhet muhib. Muhibi bektashian së pari obligohet me detyra në pjesët sociale të kompleksit të teqesë dhe më pas kalon në ato sakrale.

Grada e tretë është dervishllëku. Muhibi zotohet se do të shërbejë në një teqe të posaçme. Pasi të shërbejë një kohë të caktuar dhe të konstatohet se është i denjë për t'u bë dervish, organizohet rituali i xhem'it dhe muhibit i vehet kurora dhe i veshet manteli (taxhi dhe hërka) e dervishllëkut.

Grada e katërt është grada e babait. Dervishët për të cilët konstatohet se janë të diciplinuar dhe të ngritur shpirtërisht nga ana e Halifes ose Gjyshit lartësohen në gradën e babait. Babai i ri vendoset në krye të njërës prej ndërtesave të kompleksit të Haxhi Bektashit ose në ndonjë teqe në periferi. Babai obligohet të organizojë jetën fetare

në teqenë e tij dhe rrethinë si dhe të përgatitë muhibë dhe dervishë të rinj.

Grada e pestë është myxherredllëku. Dervishi ose babai i cili nuk është martuar fare, nëpërmjet të ritualit të zotimit (ikrar) lartësohet në gradën e myxherredit. Myxherredit i rruhen flokët me zhilet , mjekra, mustaqet dhe vetullat (xhihar-i darb) dhe në vesh i vehet një vëth. Këta persona jetën e tyre ia kushtojnë tarikatit.

Grada e gjashtë është halifellëku. Babai bektashian i cili edhe më përparon në shërbimin e tij materialo-kuptimor ngritet në gradën e halifes.

Grada e shtatë në mesin e ithtarëve bektashian është grada e Gjyshit (Dedeut). Kjo gradë paraqet gradën më të lartë e cila mund të arrihet me ngritje kuptimore në tarikatin bektashian.

Muhibët në tarikatin bektashian nuk kanë veshje të posaçme. Vetëm në momentet e zotimit në kokë u vehet një mbulesë e cila quhet "arrakijje" dhe në brez u vehet një pe i tjerur prej leshi me tre nyje që quhet "tig bend". Por muhibët të cilët ngriten në gradën e dervishllëkut kanë tesha të posaçme. Ata veshin tennure, hajarijje, hërka, kanberijje, brez, gurin e palhenkut, gurin e nënshtrimit, kurorë.

Përveç tyre dervishët udhëtues kanë mbajtur me vete edhe teber, nefir dhe keshkyl. Tash në pika të shkurta do të sqarojmë teshat e lartëpërmendura:

Kurora (taxh).- Është një kapuç i përbërë prej dymbëdhjetë pjesëve në pjesën e sipërme dhe katër pjesëve të bardha në pjesën e poshtme. Pjesët e sipërme quhen terk dhe i simbolizojnë dymbëdhjetë imamët. Katër pjesët e poshtme quhen dyer dhe simbolizojnë katër dyert (sheri-

atin, tarikatin, ma'rifetin,hakikatin). Kjo kurorë emërtohet si "Husejni taxh". Në pjesën e sipërme ku bashkohen dymbëdhjetë copat vendohet një copë e vogël që quhet "vulë" "ose "trëndafil" (gjyl).

Në kurorën e dervishëve mbi këto katër pjesë vehet edhe një pëlhurë e gjelbërt e cila rrotullohet dymbëdhjetë herë.

Arrakijje.- Arak në gjuhën arabe d.t.th. djersë. Ndër kurorën bektashijtë vendojnë një kapuç të lehtë dhe më të hollë me qëllim që kurora të mos ndotet prej djersëve. Ky kapuç quhet arrakijje. Arrakijeja u veshet edhe meshkujve edhe femrave. Këta kapuça janë të bardhë ose të kuq.

Kemeri .- Kemeri është një brez i leshtë i gjerë 12-14 cm, kurse i gjatë 275- 300 cm. Ngjyra e tij kryesisht është e kuqe. Në pjesën e parme ka toka të leshta nëpërmjet të cilave lidhet. Ngjeshja e brezit është simbol i përsosshmërisë dhe bëhet me ritual të posaçëm.

Xhild-Bend.- Xhild- bendi është një kuti në formë të katrorit e cila lidhet me toka të posaçme për brezin . Në pjesën e jashtme të kapakut të tij është shkruar emri Hazreti Aliut. Në qoshet e sipërme janë shkruar emrat e Hasanit dhe Huseinit r.a. Njëkohësisht në të janë të paraqitura edhe motive tjera me simbolika të ndryshme.

Hërka.- Hërka është një mantel pa jaka, i gjatë deri në thembra dhe i gjerë. Rreth qafës dhe duarve ka pjesë të stolisura, është pa xhepa dhe pa toka. Ngjyra e hërkës duhet të jetë e zezë, por ka mundësi të jetë edhe me ngjyra tjera. Hërka është simbol i mbulimit të mëkateve dhe të metave.

Tennure.- Tennureja është këmishë e hollë, pa jaka. Pjesa e përparme e saj është e hapur dhe ka ngjyrë të

bardhë. Tennureja veshet edhe në tarikatet e tjera. Tennureja është simbol i njëshmërisë së All-llahut. xh.sh.

Teslim Tashi (Guri i nënshtrimit).- Është një gurrë i trashë afro 1-1,5 cm. Skajet e gurit janë të gdhendura në formë të harkut.Guri është i madh prej 5-15 cm. Dhe me ndihmën e një perit varret në qafë. Pjesa e jashtme simbolizon Hatixhen r.a., kurse pjesa e brendshme është simbol i Fatimes r.a.

Guri i palhenkut.- Palhenk në persisht do të thotë dizgjina dhe ky gur simbolizon lidhshmërinë e dervishit me Zotin. Ky gur vehet mbi brezin dhe është pak më i madh se guri i nënshtrimit.

Hajdarijje.- Është një xhamadan i shkurtë dhe pa karahë. Nuk ka jaka e as toka. Ka ngjyrë të bardhë ose ngjyrë qumshti. Veshet mbi tennuren dhe ndër hërkën.

Kanberijje.- Është një gur në formë të vezës i marrët prej gurit të Haxhi Bektashit ose Nexhefit. Është i shpuar në pjesën mesme dhe lidhet në pjesën e mesme të brezit.

Tig bend.- Secili prej kandidatëve për bektashi në momentin kur zotohet në brez nga ana e udhërrëfyesit i lidhet një pe i tjerur prej leshit të kurbanit të prerë. Ky pe quhet tig bend dhe simbolizon litarin me të cilin është varrur Hallaxhi Mensuri.

Mengush.- Mengush do të thotë vathë. Mengush quhet vathi që u vehet në vesh dervishëve të pamartuar ( myxherred).

Nefir.- Nefiri është një bri të cilën dervishët udhëtues e kanë varrur në qafë që në rajonet malore t'i largojnë kafshët e egra duke i fryrë atij.

Teber.- Teberi është një armë në formë të sëpatës. Edhe teberi është përdorur nga na e dervishëve udhëtues për mbrojtje prej kafshëve të egra.

Keshkyl.- Është një enë e bërë prej gjysmës së kokosit dhe varret me pe për qafe. Ka shërbyer si enë për haje të dervishëve udhëtues.

## DHOMA E MEJDANIT

Dhoma e Mejdanit është dhoma në të cilën mbahen ritualet bektashiane. Pjesa e brendshme e derës së dhomës emërtohet si "Pragu i Derës". Në disa dhoma të Mejdanit kjo pjesë është ndërtuar veçmas. Pjesa e mesme e dhomës quhet "Dar" ose "Dar-i Mensur". Përballë derës së hymjes ka një koftor. Ky vend quhet "Makami i Koftorit" ose "Koftori i Fatimes". Në vendet ku nuk ka koftor në këtë vend vehet një kandil ose qiri.

Në pjesën e djathtë prej hyrjes së dhomës gjendet vendi i udhërrëfyesit (myrshid postu) ose posti i Ahmed-i Muhtarit. Në anën e majtë të myrshidit gjendet " Fhroni i Qiriut" (Çerag Tahti) ose froni i Muhammedit. Në këtë vend gjendet një vend prej katër shkallëve dhe në secilën prej tyre ka nga një qiri. Këtu ka 12 qirinj që simbolizojnë dymbëdhjetë imamët.

Në pjesën e përparme të fronit në një pëlhurë të bardhë vendoset një gurë i cili quhet "Guri i mejdanit", "Guri i pajtimit" etj.

Në anën e majtë të fronit të qiriut është posti i Rehberit. Ky post quhet edhe " Posti i Alijju'l Murtadasë".

Në murin e majtë të derës hyrëse janë të rradhitura postaqitë, ku ka 12 poste:

1. Posti i Horasanit (Posti i Pirit).
2. Posti i Ahmed-i Muhtarit ( Posti i Myrshidit)
3. Posti i Aliut ( Makami i Rehberit).
4. Posti i Gjellbërësit ( Makami i Sejjid Ali Sulltanit).
5. Posti i bukëpjekësit ( Makami i Ballëm Sulltanit)
6. Posti i zëvendësit ( Makami i Kajgusuz Abdallit)
7. Posti i Ataxhiut ( Makami i Kanber Aliut)
8. Posti i Mejdanxhiut (Makami i Sari Ismail Sulltanit)
9. Posti i Turbedarit (Makami i Karadonli Xhan Babës)
10. Posti i Kurbanxhiut (Makami i Hazreti Ibrahimit)
11. Posti iGostitësit (Makami i Abdall Musa Sulltanit)
12. Posti i Mihmandarit (Makami i Hëzër a.s.)

Në dhomën e Mejdanit, në Teqenë e Haxhi Bektashit, në këto poste janë ulur baballarët , kurse në teqetë tjera dervishët dhe muhibët. Në dhomën e Mejdanit së pari hyn myrshidi. Pas tij me rend së pari muhibët meshkuj e pastaj muhibet femra. Femrat ulen në një anë veçmas.

# PJESA E TRETË

## BESIMI DHE PRAKTIKA E BEKTASHINJVE TË MAQEDONISË SIPAS ANKETAVE DHE INTERVISTAVE

### 1. Vlerësimi i Anketave

Anketat janë bërë në tri teqetë bektashiane që funksionojnë në Maqedoni: në Tetovë, në Kërçovë dhe në katundin Kanatllar. Këto tre teqe sot janë në funkcion por kanë edhe traditë të bujshme në historinë e këtij tarikati në Maqedoni, veçanërisht Teqeja Harabati Baba ose Sersem Ali Dede në Tetovë.

Në fillim menduam se do të kemi punë të rëndë pasi anketat ishin të huaja për grupin anketues si dhe për shkak të paragjykimeve të cilat ekzistojnë në këtë drejtim. Por këmbëngulja jonë dhe dijalogu i pandërprerë dhe i sinqertë me baballarët e këtyre teqeve kontribuoi që ata të ndihmojnë në shpërndarjen e pjesës dërmuese të fletëanketave. Me ndihmën e baballarëve ithtarët bektashian kuptuan se bëhet fjalë për një punë shkencore e cila nuk ka asfarë prapavije doktrinale. Falë kësaj në Tetovë anketës i janë përgjigjur 90 %, në Kërçovë 70%, kurse në Kanatllar 45%.

Gjatë shpërndarjes së fletëanketave kujdes i posaçëm i është kushtuar faktit që ata të ndahen në mënyrë përpjestimore në bazë të gjinisë, moshës dhe arsimimit. Shpërndarja e të anketuarve në bazë të vendbanimit, gjinisë, moshës, gjendjes ekonomike, nivelit të arsmimit shkurtimisht është siç vijon:

1a) Shpërndarja e të anketuarve sipas vendbanimit

| Vendi | Numri | % |
|---|---|---|
| Tetova | 100 | 50 |
| Kërçova | 50 | 25 |
| Kanatllar | 50 | 25 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

1b) Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë

| Gjinia | Numri | % |
|---|---|---|
| Meshkuj | 150 | 75 |
| Femra | 50 | 25 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

1c) Shpërndarja sipas moshës

| Mosha | Numri | % |
|---|---|---|
| 18-20 | 60 | 30 |
| 30-50 | 90 | 45 |
| Mbi 50 | 50 | 25 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

1d) Shpërndarja sipas gjendjes ekonomike

| Gjendja ekonomike | Numri | % |
|---|---|---|
| Mesatare | 139 | 69,5 |
| Ndër mesataren | 48 | 24 |
| E lartë | 13 | 6,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

1e) Shpërndarja sipas nivelit arsimor

| Niveli arsimor | Numri | % |
|---|---|---|
| Me shkollë fillore | 127 | 63,5 |
| Me gjimnaz | 58 | 29 |
| Me fakultet | 15 | 7,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

1f) Shpërndarja sipas gradave në tarikat

| Grada | Numri | % |
|---|---|---|
| Baba | 0 | 0 |
| Ashik | 122 | 61 |
| Muhib | 78 | 39 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

1g) Teksti i anketës

A N K E T Ë

UDHËZIM

Jemi duke bërë një hulumtim shkencor në lidhje me besimin dhe jetën e Bektashinjëve në Maqedoni.

Anketa të cilën e keni pranë jush është e përgatitur si ndihmëse e hulumtimit shkencor të lartëpërmendur. Nisur nga kjo për mendimet e dhëna asnjëherë nuk do të shfaqen emrat e personave të anketuar, andaj edhe nuk ka nevojë të shkruhet emri.

Që ky hulumtim shkencor të jetë objektiv dhe frytëdhënës eshtë shumë me rëndësi që përgjigjet të jenë të sakta dhe pa paragjykime. Prandaj ju lutemi çdo pyetje të anketës ta lexoni me vëmendje dhe para versionit i cili është më i saktë sipas mendimit tuaj të veni shenjën ( X) .Nëse asnjëri prej versioneve të dhëna nuk pajtohet me

mendimin tuaj atëherë në pjesën e zbrazët shkruani mendimin tuaj.

Ju faleminderojmë për ndihmën e dhënë.

Metin IZETI

Instituti i Shkencave Shoqërore
i Univerzitetit 9 Ejlul
Izmir – Turqi

Vendi i anketimit _______ Data e anketimit _________
Gjinia ( ) Mashkull ( ) Femër
Mosha _________ vjet
Ku e keni kaluar pjesën më të madhe të jetës?
( ) Qytet______ ( ) Fshat ______ ( ) Jashtë______
(Ju lutemi ta shkruani edhe emrin e vendit)
Jeni ( ) beqar ( ) i martuar ( ) vejan ( ) i shkurorëzuar
Shkolla e kryer ( ) S'kam të kryer asnjë vit shkollor
( ) Kam kryer tetëvjeçaren
( ) Kam kryer shkollën e mesme
( ) Kam kryer shkollën e lartë
( ) Diçka tjetër
Puna, ose veprimtaria me të cilën merreni______
Gjendja ekonomike ( ) e lartë ( ) e mesme ( ) e ulët
Çfarë grade keni në bektashizëm ( ) Baba ( ) Muhib ( ) Ashik

1. Ç'është sipas jush, bektashizmi?
( ) Ndjekja e rrugës së Muhammedit a.s.
( ) Ndjekja e rrugës së Hz. Aliut dhe Imamëve
( ) Është një tarikat që e ka themeluar Hz. Aliu

( ) Është pranimi i Hz. Muhammedit si udhërëfyes, Hz. Aliut si rehber dhe Haxhi Bektash Veliut si Pir.

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi shkruani

______________________________________________

2. Me cilin emër do të kishit dëshiruar të thireni?

( ) Alevi

( ) Këzëlbash

( ) Rafizi

( ) Bektashi.

3. A ka dallim në mes alevizmit dhe bektashizmit?

( ) Nuk ka, që të dy emrat kanë kuptim të njëjtë

( ) Alevizmi trashëgohet kurse në bektashizëm çdokush mund të hyjë

( ) Alevizmi ka baza shiite kurse bektashizmi është tarikat sunnit.

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani.

4.Çka mendoni për Sunnizmin?

( ) Është emri i atyre që e ndjekin rrugën e Hz. Muhammedit dhe shokëve të tij

( ) Është emri i atyre që ndjekin rrugën e Jezidit

( ) Është grup armik i Hz. Aliut dhe bijëve të tij

( ) Është një rrugë që nuk ka lidhje me bektashizmën

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani.

5. A do të ishit martuar me një sunit?

( ) Po

( ) Jo

( ) Nuk jam i vendosur

( ) Ju lutemi  shkruani edhe shkakun, pse?

6. Sipas jush a ka armiqësi në mes sunizmit dhe bektashizmit?

( ) Po ( ) Jo

7. Kjo armiqësi është e dëmshme?

( ) Po ( ) Jo

8. Shkaku i armiqësisë është mostoleranca e Sunitëve?

( ) Po ( ) Jo

9.Shkaku është mosinteresimi i Bektashinjëve?

( ) Po ( ) Jo

10. A keni lexuar ndonjë libër në lidhje me Bektashizmin?

( ) Po ( ) Jo

( Ju lutemi shkruani cilat libra)

11.Cili prej mendimeve të dhëna poshtë është i saktë për Kur'anin?

( ) Një pjesë e Kur'anit është e ngritur prej përdorimit nga ana e tre halifëve tjerë

( ) Ajetet e Kur'anit që kanë të bëjnë me Hz. Aliun janë të ngritura nga ana e halifëve

( ) Kur'ani prej Hz. Muhammedit e deri më sot ka ardhur pa asnjë mëngësi dhe pa asnjë shtojca

( ) Nëse mendoni ndryshe ju lutemi shkruani.

---

12. Cili prej mendimeve të dhëna poshtë është i saktë për Muhammedin a.s.?

( ) Hz. Muhammedi është i dërguar nga ana e All-llahut si udhërëfyes e Imam për tërë njerëzimin

( ) Hz. Muhammedi e ka shkruar Kur'anin

( ) Ai është një njeri që ka punuar për interes dhe gabim i ka orientuar njerëzit rreth vehtes.

( ) Nëse mendoni ndryshe ju lutemi shkruani.

13.Çka mendoni për Hynqar Haxhi Bektash Veliun?

( ) Është një person i dërguar për shpëtimin e njeriut

( ) Është një evlija që ka ndjekur rrugën e Hz. Muhammedit dhe Hz. Aliut

( ) Është një dijetar që ka ditur komentin e brendshëm ( Batin) të islamit dhe me te i ka orientuar muhibët e vet

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani.

14. A e parapëlqeni Gusulin ?

( ) Po ( ) Jo

(Ju lutemi shkruani edhe shkakun, pse?)

15. A e parapëlqeni namazin?

( ) Po ( ) Jo

(Ju lutemi shkruani edhe shkakun, pse?)

16. A e preferoni agjërimin e Ramazanit?

( ) Po ( ) Jo

(Ju lutemi shkruani edhe shkakun, pse?)

17. A keni tubime të posaçme tuajat?

( ) Po, cilat janë ______________________________

( ) Jo

18. A keni musahib?

( ) Po ( ) Jo

( ) Nuk di se ç'është musahibi

19. A bëni ashure?

( ) Po ( ) Jo

( Ju lutemi, tregoni edhe mënyrën si e bëni)

20.Çka është, sipas mendimit tuaj, babai bektashinj?

( ) Është një Pir larg prej mëkatëve

( ) Është një kryetar i xhemaatit i cili ua trason rrugën dhe udhëheq ritualet fetare të ithtarëve të vet.

( ) Është një njeri në moshë i cili ka fituar besimin e bektashinjëve, por që nuk ka shumë dituri

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani.

21. Çka, sipas jush, kahëzon punët e personit në Islam?

( ) Kur'ani, Sunneti, mendimet e dijetarëve

( ) Direktivat e Hynqar Haxhi Bektash Veliut.

( ) Direktivat e Kryegjyshit bektashi.

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani.

22.Si Bektashinjët mund të ndihmojnë në zhvillimin e jetës fetare në Maqedoni?

( ) Duhet të punohet bashkë me Meshihatin

( ) Duhet të punohet jashtë institucionit duke u bazuar në dashuri dhe tolerancë

( ) Duhet të themelohet Bashkësia Bektashiane.

( ) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani.

Ju faleminderit!

1h) VLERËSIMI I PYETJEVE TË ANKETËS

1. "Ç'është sipas jush Bektashizmi"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Ndjekja e rrugës së Muhammedit a.s. | 0 | 0 |
| b) Ndjekja e rrugës së Hazreti Aliut dhe imamëve | 15 | 7,5 |
| c) Është një tarikat që e ka themeluar Haxhi Bektash Veliu | 117 | 58,5 |
| d) Është pranimi i Hazreti Muhammedit si udhërëfyes, Hazreti Aliut si rehber dhe Haxhi Bektash Veliut si pir | 58 | 29 |
| e) Nëse mendoni ndryshe ju lutemi shkruani | 0 | 0 |
| f) Pa përgjigje | 10 | 5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Siç shihet një numër i madh i të anketuarve (58,5%) ka thënë se bektashizmi është një tarikat i themeluar nga ana e Haxhi Bektash Veliut. Edhe pse teksti i kësaj pyetjeje nuk e definon në tërësi tarikatin bektashian.Shihet se ithtarët e këtij tarikati më së tepërmi janë të informuar me këtë emër dhe atë e kanë rrethuar.

Një pjesë e të anketuarve (afro 29%), kryesisht personat të cilët marrin pjesë në bisedat dhe ceremonitë në teqetë, e kanë rrethuar tekstin e përgjigjes së plotë, ku thuhet se Bektashizma është pranimi i Hazreti Muhammedit si udhërrëfyes, Hazreti Aliut si rehber dhe Haxhi Bektash Veliut si pir. Një numër i ashikëve ( simpatizuesve) bektashian të anketuar (7,5%) kanë pohuar se

bektashizma është ndjekje e rrugës së Hazreti Aliut dhe imamëve.

2. Me cilin emër do të kishit dëshiruar të thirreni"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Alevi | - | - |
| b) Këzëllbash | - | - |
| c) Rafizi | - | - |
| d) Bektashi | 200 | 100 |
| e) Pa përgjigje | - | - |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Siç shihet kësaj pyetje i janë përgjigjur të gjithë të anketuarit dhe kanë shprehur se dëshirojnë të thirren me emrin bektashi. Bektashinjtë e Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë veten e konsiderojnë vetëm si bektashi dhe nuk kanë dëshirë që të emërtohen me emra tjerë. Në bisedat tona me baballarët na është thënë se alevizmi nuk ka gjë të përbashkët me bektashizmin, pasi kjo e dyta ka pir, libër dhe zinxhir të shejhëve kurse alevijtë nuk kanë.

Bektashinjtë e Maqedonisë tarikatin e tyre e konsiderojnë si rrugë mistike në të cilin mund të hyjë çdokush që i plotëson kushtet dhe nuk është e domosdoshme të rrjedhë prej familjes bektashiane, siç është rasti me alevijtë.

3. .A ka dallim në mes alevizmit dhe bektashizmit"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Nuk ka, që të dy emrat kanë kuptim të njëjtë | 20 | 10 |
| b) Alevizmi trashëgohet kurse në bektashizëm çdokush mund të hyjë | 27 | 13,5 |
| c) Alevizmi ka baza shiite, kurse Bektashizmi është tarikat sunit | 46 | 23 |
| d) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi shkruani | 95 | 47,5 |
| e) Pa përgjigje | 12 | 0,6 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Afro 47,5 % e bektashinjëve në pjesën e ndarë për përgjigje të ndryshme kanë shkruar se bektashizmi dallohet prej alevizmit. Prej përgjigjeve shihet se ithtarët bektashinj nuk i kanë të njohura detajet e dallimit në mes të bektashizmit dhe alevizmit, pikërisht për këtë edhe vetëm 13,5 % e tyre i janë përgjigjur pyetjes se alevizmi trashëgohet kurse bektashizmi jo, por secili mund të hyjë në të. Një grup më i vogël i bektashinjëve i është përgjigjur pyetjes se Bektashizmi është tarikat sunnit i cili e simpatizon Ehli Bejtin.

4. "Çka mendoni për Sunnizmin"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Është emri i atyre që e ndjekin rrugën e Hazretit Muhammedit dhe shokëve të tij | 6 | 0,3 |
| b) Është emri i atyre që e ndjekin rrugën e Jezidit | 65 | 32,5 |
| c) Është grup armik i Hazreti Aliut dhe bijve të tij | 78 | 43,5 |
| d) Është një rrugë që nuk ka lidhje me Bektashizmin | 41 | 20,5 |
| e) Nëse mendoni ndryshe, ju lutem shkruani | - | 0 |
| f) Pa përgjigje | 10 | 0,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

43,5 % e të anketuarve është përgjigjur se Sunnizmi është grup armik i Hazreti Aliut dhe bijve të tij. Pas suspendimit të rendit jeniçer dhe mbylljes së teqeve bektashiane në vitin 1826 nga ana e Sulltan Mahmudit II bektashinjtë kanë përjetuar ditë të rënda. Problemet e njëjta bile edhe më të kobshme për bektashinjtë e Maqedonisë kanë vazhduar edhe në periudhën e Mbretërisë Jugosllave. Pikërisht për këtë bektashinjtë kanë mendim negativ ndaj sunnitëve me të cilët kanë jetuar bashkë 32,5. % kanë thënë se sunnizmi është emër i grupit i cili rrjedh prej familjes së Jezidit. Në mesin e muslimanëve shqiptarë, qofshin ata sunni ose bektashi, emri Jezid është simbol i padrejtësisë. Një periudhë të gjatë në mesin e bektashinjve hoxhallarët janë konsideruar si Jezid për shkak se ata nuk u kanë njohur të drejtën e aplikimit të riteve bektashiane. Sjellja arrogante e disa hoxhallarëve kundër

bektashinjve në mjedise të ndryshme është inicuar nga jeta tepër liberale dhe heterodokse e ithtarëve bektashian.

Gjatë observimeve tona hasëm edhe në informatorë të atillë që pohonin se ata janë elitë dhe nuk kanë nevojë për sheriat, kurse sheriati është i nevojshëm vetëm për ata që merren me egzoterinë (dhahir) e çështjeve.

5. " A do të ishit martuar me një sunnit"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 126 | 63 |
| b) Jo | 53 | 26,5 |
| c) Nuk jam i vendosur | - | - |
| d) Pa përgjigje | 21 | 10,5 |
| e) Ju lutemi shkruani edhe shkakun pse | | |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Pyetja "A do të ishit martuar me një sunnit" paraqet anën dinamike të studimit dhe e shpreh pjesëmarrjen e bektashinjve në jetën shoqërore dhe relacionet e tyre me sunnitët në jetën e përditshme.

Edhe pse në të kaluarën e afërme ka pasur një distancim në martesat mes sunnitëve dhe bektashinjve, kohëve të fundit- siç shihet edhe nga të anketuarit ku 63 % e tyre janë përgjigjur se do të ishin martuar me sunnit- kjo barierë është tejkaluar. Hidhërimi i bektashinjve, siç thonë ata, nuk ka të bëjë me popullatën, por me hoxhallarët të cilët dhjetra vite me rradhë kanë mbjellë urrejtje ndaj tyre. Përgjigja pozitive në këtë pyetje është inicuar edhe nga

sistemi i ri i jetës moderne, ku dallimet ideologjike fillojnë të distancohen nga jeta shoqërore.

Sipas disa bektashinjve një i ri beqar bektashi nuk mund të martohet me vajzë sunnite, por një bektashi vejan mund të martohet me grua sunnite. Vajza e re bektashiane nuk mund të martohet me djalë sunnit por gruaja vejushë mundet, për arsye se të vejat janë të pjekura dhe nuk largohen prej bektashizmit.

6. "A ka, sipas jush, armiqësi në mes të Sunnizmit dhe Bektashizmit"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 151 | 75,5 |
| b) Jo | 49 | 24,5 |
| c) Pa përgjigje | 0 | 0 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Siç shihet, një numër i madh i të anketuarve ( 75,5%) ka pohuar se ka armiqësi në mes bektashizmit dhe sunnizmit. Në periudhën komuniste, pasi teqetë bektashiane kanë qenë të mbyllura, kjo armiqësi nuk është vërejtur. Por, pas risocializimit të bektashinjve, pas viteve 90 dhe paraqitjes së idesë për formimin e Bashkësisë Bektashiane në Maqedoni, janë paraqitur mosmarrëveshje evidente në mes të bektashive dhe Bashkësisë Islame në Maqedoni. Pjesa e bektashinjve të anketuar në Kërçovë kanë pohuar se armiqësia në mes tyre nuk është aq evidente. Është normale që kjo pjesë ku janë prezente edhe tarikatet tjera si – rifaijtë, halvetijtë, melamijtë- të jetë më tolerante.

7. "Kjo armiqësi është e dëmshme"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 151 | 75,5 |
| b) Jo | 0 | 0 |
| c) Pa përgjigje | 49 | 24,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Të gjithë ata që në pyetjen e mëparshme janë përgjigjur se ka armiqësi në këtë pyetje kanë thënë se kjo armiqësi është e dëmshme. Bektashinjtë janë të mendimit se mosmarrëveshjet janë të dëmshme edhe për sunnitët edhe për bektashinjtë. Të gjithë kanë pohuar se ngadhnjyes në këto armiqësi dalin jomuslimanët.

Armiqësia dhe mosmarrëveshjet janë nxitur edhe nga ana e shumë "udhëpërshkruesve "të huaj që para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore kanë qëndruar me muaj nëpër teqetë bektashiane.[169]

Një numër i madh i analitikëve, duke u bazuar në heterodoksinë dhe tolerancën bektashiane, mundohen që ata t'i largojnë prej Islamit. Mirëpo një vlerësim i këtillë nuk është aspak objektiv për bekrashinjtë që shekuj me rradhë kanë bartur bajrakun e Islamit. Shkas kryesor për këtë është afrimi me paragjykime dhe mosthellimi në esncën e çështjeve.

8. "Shkaku i armiqësisë është mostoleranca e sunnitëve"

169 Në periudhën kur postnishin i teqesë bektashiane Harabati Baba ishte Baba Hamzai prej Shtipi (1911-1914) teqeja është vizituar nga ana e Max Choublier-it, i cili ka shkruar edhe një trajtesë në lidhje me vizitën e tij, " Les Bektachies et la Rumelie"

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 151 | 75,5 |
| b) Jo | 0 | 0 |
| c) Pa përgjigje | 49 | 24,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

9. "Shkaku është mosinteresimi i bektashinjve"

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 0 | 0 |
| b) Jo | 151 | 75,5 |
| c) Pa përgjigje | 49 | 24,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Siç shihet prej përgjigjeve të pyetjes 8 dhe 9 një numër i madh i bektashinjve pohojnë se mosmarrëveshjet janë prodhim i mostolerancës sunnite. Nga aspekti shoqëror kjo ka mundësi të jetë e vërtetë por në aspektin ideologjik sunnitët kanë prova reale. Por është evidente se ashtu siç ka mostolerancë në mjediset sunnite ka edhe në ato bektashiane e posaçërisht kur janë në pyetje Ebu Bekri, Omeri dhe Othmani r.a.m.

10. "A keni lexuar ndonjë libër në lidhje me Bektashizmin?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 172 | 86 |
| b) Jo | 17 | 8,5 |
| Ju lutemi, shkruani cilat vepra? | | |
| c) Pa përgjigje | 11 | 5,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Një numër i madh i të anketuarve kanë thënë se kanë lexuar libra me tematikë bektashiane. Shumica e librave të lexuara janë në gjuhën shqipe. Librat më të lexuara janë: "Mistiçizma Islame dhe Bektashizma" e Baba Rexhepit, "Qerbelaja" dhe "Fletore e Bektashinjët" e Naim Frashërit, përkthimi i "Hadikatu's-Suadasë" nga ana e Dalip Frashërit. Në teqetë bektashiane hasëm edhe në literaturë të ndryshme bektashiane të botuar në Turqi dhe gjetiu.

11. "Cili prej mendimeve të dhëna poshtë është i saktë për Kur'anin"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Një pjesë e Kur'anit është e ngritur prej përdorimit nga ana e tre halifëve tjerë | 73 | 36,5 |
| b) Ajetet e Kur'anit që kanë të bëjnë me Hazreti Aliun janë të ngritura nga ana e tre halifëve | 89 | 44,5 |
| c) Kur'ani prej Hazreti Muhammedit e deri më sot ka ardhur pa asnjë mëngësi dhe shtojca | 0 | 0 |
| d) Nëse mendoni ndryshe, ju lutemi, shkruani | 31 | 15,5 |
| e) Pa përgjigje | 7 | 3,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Edhe pse një numër i madh i bektashinjve nuk ka njohuri më të hollësishme për Kur'anin te shumica e tyre

është prezent mendimi se Kur'ani i sotshëm është i mëngët dhe se Kur'ani i vërtetë është ai që ka qenë në duart e Aliut r.a. Afro 15,5 % kanë pohuar se ajetet që mungojnë kanë të bëjnë me ezoterinë (batin). Mllefi ndaj tre halifëve tjerë është prezentuar ehe në këtë pyetje. Edhe pse urdhërat e Kur'anit nuk praktikohen në përpikshmëri nga ana e bektashive ata nuk i mohojnë.

12. "Cili prej mendimeve të dhëna është i saktë për Muhammedin a.s."?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Hazreti Muhammedi është i dërguar nga ana e All-llahut si udhërrëfyes e imam për tërë njërëzimin | 178 | 89 |
| b) Hazreti Muhammedi e ka shkruar Kur'anin | - | - |
| c) Ai është njeri që ka punuar për interes dhe gabim i ka orientuar njerëzit rreth vetes | - | - |
| d) Nëse mendon ndryshe, ju lutem shkruani | 17 | 8,5 |
| e) Pa përgjigje | 5 | 2,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Një numër i madh i të anketuarëve 89 % kanë pohuar se Muhammedi a.s. është i dërguar nga na e All-llahut si udhërrëfyes dhe imam për tërë njerëzimin. Të gjithë bektashinjtë në Maqedoni Muhammedin a.s. e pranojnë për pejgamber dhe për vete thonë se janë ndjekës të rrugës së Muhammed-Aliut. Hazreti Aliun e konsiderojnë si

hallkë e parë e zinxhirit të imametit dhe velajetit. Shumica e ideve joislame, të cilat në disa vise të botës futen nën ombrelën e alevizmit dhe bektashizmit, nuk janë prezente te bektashinjtë e Maqedonisë. Edhe pse bektashinjtë në praktikë ndoshta nuk i zbatojnë në përpikshmëri principet islame ata gjithnjë pohojnë se janë ndjekës të Muhammedit a.s. dhe Hazreti Aliut.

13. "Çka mendoni për Hynqar Haxhi Bektash Veliun"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Është një person i dërguar për shpëtimin e njerëzimit | 57 | 28.5 |
| b) Është një evlija që e ka ndjekur rrugën e Hazreti Muhamedit dhe Hazreti Aliut | 21 | 10.5 |
| c) Është një dijetar që ka ditur komentin e brendshëm (batin) e Islamit dhe me të i ka orientuar muhibët e vet | 112 | 56 |
| d) Nëse mendoni ndryshe, ju lutem, shkruani | 3 | 1.5 |
| e) Pa përgjigje | 7 | 3.5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Siç u pa edhe prej përgjigjeve të mëparme, bektashinjtë e Maqedonisë Haxhi Bektash Veliun nuk e konsiderojnë si themelues të një feje të re.Një përqindje e madhe e të anketuarëve 56% kanë pohuar se Haxhi Bektash Veliu është një pir që e ka ditur komentin e brendshëm të Kur'anit. 28,5 % e të anketuarëve kanë

konstatuar se ai është një person i cili ka ardhur ta shpëtojë njerëzimin.

Edhe në bisedat tona me bektashinjtë është prezentuar fakti se Haxhi Bektash Veliu ka vepruar në një periudhë mjaftë me turbulenca në Anadoli dhe mjaftë ka kontribuar për qetësimin shpirtëror të popullatës, pa marrë parasysh gjuhën, kombin dhe racën e tyre.

10,5 % e të anketuarëve për Haxhi Bektash Veliun kanë thënë se është një pir që e ka ndjekur rrugën e Muhammed Aliut. Treshi Muhammed-Ali- Haxhi Bektash është mjaftë i potencuar në mesin e bektashinjve.

14. "A e preferoni Gusulin"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 189 | 94,5 |
| b) Jo | - | - |
| Ju lutemi shkruani edhe pse? | | |
| c) Pa përgjigje | 11 | 5,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Pothuajse të gjithë të anketuarit (94,5 %) kësaj pyetjeje janë përgjigjur me "Po". Në pjesën ku është lënë vendi i zbrazët, për të sqaruar shkakun, shumica kanë thënë: "Një tarikat i cili preferon pastërtinë dhe ngritjen shpirtërore gjithësesi duhet të ketë parasysh edhe pastrimin fizik. Në problematikën e pastërtisë bektashinjtë janë mjaftë të kujdesshëm. Madje disa kanë thënë se nuk është në rregull që kjo pyetje t'i parashtrohet një muslimani dhe shqiptari.

15. "A e parapëlqeni namazin"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 47 | 23,5 |
| b) Jo | 139 | 69,5 |
| Ju lutemi shkruani edhe shkakun pse? | | |
| c) Pa përgjigje | 14 | 7 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Një numër i madh i të anketuarëve kësaj pyetjeje i janë përgjigjur në mënyrë negative. Në observimet tona kemi vërejtur se bektashinjtë nuk e falin namazin, por bëjnë lutje të posaçme të tyre në mëngjes dhe mbrëmje që quhen "nijaz". Disa kanë pohuar se namazi është për njerëzit e thjeshtë që nuk i kanë tejkaluar kufijtë e sheriatit. Në kompleksin Harabati Baba në Tetovë ka mesxhid, por momentalisht nuk është funkcional.

16. "A e parapëlqeni agjërimin e Ramazanit"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po | 81 | 40,5 |
| b) Jo | 117 | 58,5 |
| Ju lutemi shkruani edhe shkakun pse? | | |
| c) Pa përgjigje | 2 | 1 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

Më tepër se gjysma e të anketuarëve kanë pohuar se nuk e agjërojnë ramazanin. Shumica e kanë arsyetuar me atë se agjërimi i vërtetë është largimi i zemrës prej të ligave e jo qëndrimi pa ngrënë e pa pirë prej mëngjesi e deri në

mbrëmje. Ndërsa 40,5 % kanë thënë se agjërimi i Ramazanit është farz për bektashinjtë, por farz është edhe agjërimi i dhjetë ditëve të para të muajit Muharrem.

17. "A keni tubime të posaçme tuajat"?

| Teksti | Numri | % |
|---|---|---|
| a) Po, cilat janë | 191 | 95,5 |
| b) Jo | 0 | 0 |
| c) Pa përgjigje | 9 | 4,5 |
| Gjithësej | 200 | 100 |

95,5 % të të anketuarëve kanë thënë se kanë tubime të posaçme,siç janë: Sulltan Nevruzi, Ashureja, Bisedat e natës së premte. Bektashinjtë dy herë në ditë tubohen për të bërë lutje. Këto tubime janë vullnetare. Bisedat dhe ceremonitë bektashiane janë të fshehta për ata që nuk kanë marrë dorë. Çdo natë të premte në teqe bëhen biseda ku marrin pjesë vetëm bektashinjtë.

Për personat të cilët dëshirojnë të hyjnë në këtë tarikat përgatitet rituali i zotimit ( Ikrar), të cilin e sqaruam më lartë.

Bektashinjtë e Maqedonisë dy herë në vjet përgadisin ceremoni të veçanta.

